



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR
AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS



RAPORT PËR GJENDJEN E NATYRËS

2010 - 2014



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR
AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS



RAPORT PËR GJENDJEN E NATYRËS

2010 - 2014

Prishtinë, 2015

Të nderuar lexues,



Trashëgimia natyrore e një vendi është një ndër pasuritë më të rëndësishme të tij. Parqet Kombëtare, ekosistemet pyjore, monumentet e natyrës dhe burimet ujore, përveç që janë vendbanime të shumë llojeve të rralla bimore e shtazore dhe që bartin në vete shumë fenomene e dukuri të rralla e interesante gjeologjike, morfologjike, hidrologjike e peizazhore janë edhe burime të rëndësishme për zhvillim ekonomik, mirëqenie shoqërore, edukim dhe rekreacion.

Megjithkëtë, shfrytëzimi i pakontrolluar dhe i paplanifikuar i këtyre vlerave dhe burimeve natyrore, mund të sjellë dëme të pariparueshme të cilat do të kenë për pasojë edhe zhdukjen e llojeve të rralla bimore dhe shtazore dhe dëmtimin e fenomeneve të rralla natyrore.

Duke u nisur nga ky fakt, institucionet e Kosovës kanë vënë në kuadër të prioriteteve të tyre edhe mbrojtjen dhe konservimin e vlerave të rralla të trashëgimisë natyrore. Sot, Kosova ka rreth 11 % të territorit të saj të mbrojtur me ligj, në kuadër të së cilit përfshihen zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme si Parqe Kombëtare, rezervate të natyrës, parqe të natyrës, monumente të mbrojtura si dhe zona tjera natyrore më rëndësi të veçantë.

Gjithashtu, me qëllim të menaxhimit më efikas dhe të qëndrueshëm të këtyre vlerave përveç hartimit të legjislacionit përkatës në sektorin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit janë hartuar edhe strategji, plane të veprimit, plane hapësinore si dhe programe qoftë për natyrën e Kosovës në përgjithësi ose për zona të caktuara në veçanti.

Me qëllim të promovimit të vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës dhe sensibilizimit të opinionit të gjerë për rëndësinë e tyre, ato janë bërë pjesë jo vetëm e projekteve dhe iniciativave nacionale por edhe e projekteve regjionale dhe ndërkombëtare.

Përkundër kësaj, nevojitet edhe më tej angazhim i vazhdueshëm i të gjitha institucioneve dhe organizatave të tjera por edhe i gjithë shoqërisë sonë për te mbrojtur dhe konservuar këto vlera natyrore dhe shfrytëzimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme për të mirën e gjeneratave të sotme dhe të atyre që do të vijnë.

Njeriu është pjesë e natyrës dhe jo zotërues i saj, andaj edhe kërkesat dhe interesat e tij duhet të jenë në harmoni me ligjet e natyrës dhe me balancën ekologjike të saj.

Dr.sc. Ilir Morina
Kryeshef ekzekutiv i AMMK-së

PËRMBAJTJA

1. PJESA HYRËSE	13
1.1. HYRJE	13
1.2. PROFILI I KOSOVËS	13
1.2.1. Pozita gjeografike	13
1.2.2. Relievi	13
1.2.3. Klima	14
1.2.4. Hidrografia.....	14
1.3. Historiku i mbrojtjes së natyrës në Kosovë	15
2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	17
2.1. KORNIZA LIGJORE DHE STRATEGJIKE	17
2.1.1. Ligjet	17
2.1.2. Aktet nënligjore.....	18
2.1.2.1. Rregulloret.....	18
2.1.2.2. Udhëzimet Administrative.....	18
2.1.2.3. Vendimet	19
2.1.3. Strategjitë, Planet Hapësinore, Planet Menaxhuese dhe Dokumentet tjera.....	19
2.1.3.1. Dokumente në procedurë të miratimit.....	20
2.1.3.2. Strategjitë sektoriale	20
2.1.4. Marrëveshjet regjionale.....	21
2.1.5. Harmonizimi me Direktivat e BE-së në sektorin e mbrojtjes së natyrës	22
2.1.6. Konventat ndërkombëtare	23
2.2. KORNIZA INSTITUCIONALE	25
2.2.1. Organet vendimarrëse	25
2.2.1.1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor –MMPH.....	25
2.2.1.2. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – MBPZHR.....	26
2.2.1.3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- MKRS.....	26
2.2.1.4. Pushteti lokal – Komunat	26
2.2.1.5. Institucionet Shkencore	27
2.2.1.6. Organizatat e Shoqërisë Civile Mjedisore	27
3. KLASIFIKIMI I ZONAVE TE MBROJTURA	28
3.1. REZERVATI STRIKT I NATYRËS	28
3.2. PARKU KOMBËTAR	28
3.3. ZONA E VEÇANTË E MBROJTUR	28
3.4. PARKU I NATYRËS	29
3.5. MONUMENTI I NATYRËS	29
3.6. PEIZAZHI I MBROJTUR	30
3.7. MONUMENTI I ARKITEKTURËS SË PARKUT	30

4. KRONOLOGJIA E ZONAVE TË MBROJTURA	31
5. ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS	33
5.1. REZERVATET STRIKTE	35
5.1.1. Maja e Arnenit.....	36
5.1.2. Rusenica	36
5.1.3. Pisha e Madhe.....	37
5.1.4. Oshlaku	38
5.1.5. Kozhnjeri dhe Maja e Ropsit	39
5.1.6. Gubavci.....	40
5.1.7. Malet e Prilepit	40
5.1.8. Bifurkacioni i lumit Nerodime.....	41
5.1.9. Kamilja	41
5.1.10. Gazimestani.....	41
5.2. ZONAT E PROPOZUARA PËR REZERVATE	42
5.3. PARQET KOMBËTARE	44
5.3.1. Parku Kombëtar “Sharri”	44
5.3.2. Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”	54
5.4. ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA	59
5.4.1. Ligatina e Hencit/ Radeves	59
5.5. MONUMENTET E NATYRËS	64
5.5.1. Shpella e Gadimes	64
5.5.2. Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë “Ujëvarat e Mirushës”	67
5.5.3. Gryka e Rugovës.....	69
5.5.4. Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit	70
5.5.5. Muzeu i kristaleve	71
5.6. PEIZAZHET E MBROJTURA	72
5.6.1. Parku i Shkugzës	72
5.6.2. Parku Regjional Gërmia.....	75
5.7. NDËRHYRJET NË ZONAT E MBROJTURA 2010-2014	77
6. ZONAT TJERA TË MBROJTURA	79
6.1. ZONAT E NATURA 2000	79
6.2. REZERVATET E GJUETISË ME RËNDËSI TË VEÇANTË	81
6.2.1. Vendgjuetia me Rëndësi të Veçantë “Blinaja”.....	81
6.2.2. Vendgjuetia me Rëndësi të Veçantë “Dubočaku”	83

7. BIODIVERSITETI.....	85
7.1. GJENDJA E BIODIVERSITETIT	87
7.1.1. Gjendja e florës dhe vegetacionit	87
7.1.2. Gjendja e faunës	87
7.2. LLOJET INVAZIVE DHE ALIENE.....	88
7.3. EKSPONATET E NATYRËS NË MUZEUN E KOSOVËS	93
8. PYJET E KOSOVËS	94
8.1. GJENDJA E EKOSISTEMEVE PYJORE	94
8.2. INVENTARIZIMI I PYJEVE.....	95
8.3. SIPËRFAQET E PYLLËZUARA.....	96
8.4. ZJARRET	96
9. EKOTURIZMI	99
9.1. EKOTURIZMI I ZONAVE TË MBROJTURA.....	99
10. MASAT E NDERMARRA PER MBROJTJEN E NATYRES.....	101
10.1. PROJEKTET NACIONALE DHE ATO TË FINANCUARA NGA DONATORËT	102
10.1.1. Libri i Kuq i florës vaskulare.....	103
10.1.2. Pylli i arinjve.....	105
10.1.3. Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës dhe Konservimi i Biodiversitetit në Komunën e Dragashit.....	106
10.1.4. Projekti i Gërmisë.....	107
10.2. PROJEKTET REGJIONALE DHE NDËRKUFITARE.....	108
10.2.1. Parqet e Harkut Dinarik.....	108
10.2.2. Projekti e zonës së pyjeve të ahut.....	110
10.2.3. Zonat e Mbrojtura Ndërkufitare	111
10.3. PROMOVIMI I SHENJËS SË MBROJTJES SË NATYRËS NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË BIODIVERSITETIT 22 MAJ 2013.....	111
11. KONKLuzionet dhe Rekomandimet	112
12. REFERENCAT.....	114
13. SHTOJCA I: Harta e Zonave të Mbrojtura.....	118
14. SHTOJCA II: Tabela e Zonave të Mbrojtura.....	119

Treguesi i shkurtesave

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencioni Pyjor i Kosovës
BE	Bashkësia Evropiane
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
CITES	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara
DMM	Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit
DPK	Drejtoria e Parkut Kombëtar
ENVSEC	Nisma për Sigurinë dhe Mjedisin
FAO	Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (Food and Agriculture Organisation)
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
IUCN	Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
OJQ	Organizata Joqeveritare
PK	Park Kombëtar
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit
SKM	Strategjia e Kosovës për Mjedis
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
UNSECO	Programi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
PPJD	Produktet Pyjore jo Drusore

Treguesi i tabelave

Tabela 1.	Direktivat dhe Konventat e Bashkimit Evropian në sektorin e mbrojtjes së natyrës	22
Tabela 2.	Konventat ndërkombëtare	23
Tabela 3.	Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive	35
Tabela 4.	Ndërhyrjet në zonat e mbrojtura	77
Tabela 5.	Llojet e faunës në Blinajë	82
Tabela 6.	Lista preliminare e llojeve aliene invazive në Kosovë	92
Tabela 7.	Vëllimi në këmbë në pyje specie druri kryesore (dbh ≥ 7 cm) (1000 m ³)	95
Tabela 8.	Zjarret pyjore për periudhën 2010 – 2014	97
Tabela 9.	Lista e projektet nacionale dhe ato të financuara nga donatorët	101

Treguesi i figurave

Fig. 1.	Hidrografia e Kosovës	15
Fig. 2.	Numri i Zonave të Mbrojtura të natyrës nëpër vite (1950 - 2014)	31
Fig. 3.	Harta e Rezervateve të Natyrës	42
Fig. 4.	Harta e zonimit të PK "Sharri"	46
Fig. 5.	Sipërfaqja e PK Bjeshkët e Nemuna sipas komunave- pjesëmarrja	55
Fig. 6.	Ligatina e Hencit	60
Fig. 7.	Harta e Shkugzës	73
Fig. 8.	Skema e funksionimit të Rrjetit ekologjik	79
Fig. 9.	Sipërfaqet e pyllëzuar	96
Fig. 10. dhe 11.	Performanca e përgjithshme e shteteve (Maj 2013-Prill 2014)	91
Fig.12.	Paraqitja grafike e numrit të llojeve bimore të cilat iu takojnë kategorive të kërcnueshmërisë	103
Fig.13.	Shenja e Mbrojtjes së Natyrës	111
Fig 14.	Harta e Brezit të Gjelbër Evropian	114

Treguesi i fotove

Foto 1. Maja e Arnenit: bashkësitë pyjore të rrobullit dhe ahut	36
Foto 2. Gryka e Rusenicës	37
Foto 3. Pisha e Madhe: Ekosistemet pyjore te rrobullit, dredhakut,	38
Foto 4. Oshlaku (ekspozicioni jugor) habitat i rrobullit dhe dhive të egra	39
Foto 5 dhe 6. Kozhnjeri dhe Maja e Ropsit	39
Foto 7. Malet e Prilepit	41
Foto 8 dhe 9. Intervenimet në Bifurkacionin e lumit Nerodime	43
Foto 10. Gurëthyesi në Grykën e Rusenices	44
Foto 11. Rezervati i Arnenit 2011	44
Foto 12. Peizazh nga Malet e Sharrit	45
Foto 13. Pasojat e nënlevorësve në trung	47
Foto 14. Koritniku: Pasojat e zjarrit në pyjet e rrobullit	47
Foto 15 dhe 16. Shkatërrimi i pyjeve nga faktorët natyror (Lubinje)	48
Foto 17. Prerjet ilegale te pyjeve në Park	48
Foto 18. Tumori i lëvores (Nectria ditissima)	49
Foto 19. Kërpudha e kalbjes (Fomes fomentarius)	49
Foto 20. Pyjet e arnenit- Ujërat e Humbur	49
Foto 21 dhe 22. Zjarret në PK "Sharri"	50
Foto 23. Sharr (Vraca), vegjetacioni barishtor (kullosat) në vjeshtë	51
Foto 24. Lumi i Brezovicës	52
Foto 25. Liqeni i Livadhishtës	52
Foto 26 dhe 27. Prevalla: Zona e kampingut veror para rrënimit (2011) dhe pas rrënimit (2013)	53
Foto.28. Peizazh nga PK "Bjeshkët e Nemuna"	54
Foto 29. Kaprolli (Capreolus capreolus)	56
Foto 30. Ariu i murrmë (Ursus arctos) (Foto APK)	56
Foto 31 dhe 32. Prerjet ilegale të pyjeve dhe zjarret në Park	57
Foto 33 dhe 34. Ndërtimet në Grykën e Junikut dhe shfrytëzimi i inerteve në Lumëbardhin e Deçanit	57
Foto 35. Peizazh nga Ligatina e Hencit - Radeves	61
Foto 36. Adonis aestivalis	61
Foto 37. Equisetum palestine	61
Foto 38. Podiceps cristatus	62
Foto 39. Ardea cinerea	62
Foto 40. Himantopus himantopus	62
Foto 41. Acrocephalus scirpaceus	62
Foto 42. Ardea purpurata	62
Foto 43. Ixobrychus minutus	62
Foto 44. Ekosisteme të thara dhe të djegura	63
Foto 45. Kristalet e aragonitet në Shpellën e Gadimes	64
Foto 46. Kristalet në Shpellën e Gadimes	65
Foto 47 dhe 48. Gjendja ne brendësi te Shpellës (2010 – 2013)	66
Foto 49 dhe 50. Thyerja e kristaleve	66
Foto 51 dhe 52. Ndërtimi i rezervarit të ujit mbi shpellën e Gadimes dhe gurthyesi në afërsi të shpellës	66
Foto 53. Gjendja e përmirësuar më 2014	67
Foto 54. Nga vizita e Ministrit dhe Ambasadores	67
Foto 55. Ujëvara e Mirushes	68
Foto 56 dhe 57. Ndërtimet ilegale ne zonën e mbrojtur të Mirushës dhe rrëshqitjet e dheut	68
Foto 58. Gryka e Rugovës (foto F. Katallozi)	69

Foto 59 dhe 60. Ndërhyrjet në Grykën e Rugovës	70
Foto 61. Burimi i Drinit të Bardhë	71
Foto 62 dhe 63. Muzeu i kristaleve	72
Foto 64. Pamje nga Parku i Shkugzës	73
Foto 65. Brumbulli i rrezikuar (<i>Lucanus cervus</i>)	74
Foto 66. Breshka (<i>Testudo hermanni</i>)	74
Foto 67. <i>Lacerta muralis</i> (Hardhuca e mureve)	74
Foto 68. <i>Bombina variegata</i> (Bretkoca barkverdhë)	74
Foto 69. Restorantet dhe objektet përcjellëse shërbyese	74
Foto 70. Menaxhimi jo adekuat i mbeturinave	74
Foto 71. Pamje nga zona rekreative	75
Foto 72. Picërraku (<i>Salamandra salamandra</i>)	75
Foto 73 dhe 74. Pamjen e shtigjeve të rregulluara në Park	76
Foto 75. Skema e funksionimit të Rrjetit ekologjik	79
Foto 76 dhe 77. Peizazhe nga Blinaja	81
Foto 78 dhe 79. Kapronjtë në Blinajë	82
Foto 80. Peizazhe nga Dubočaku	83
Foto 81. <i>Lilium albanicum</i>	87
Foto 82. <i>Plantago gentianoides</i>	87
Foto 83. <i>Polygala doerfleri</i>	87
Foto 84. Shfrytëzimi pa kriter i florës shkakton dëme të mëdha	88
Foto 85. <i>Lacerta viridis</i> (Hardhuca e gjelbër)	89
Foto 86. <i>Vipera ammodytes</i> (Nëpërka)	89
Foto 87. <i>Picus viridis</i> (Pikthi i gjelbërt)	89
Foto 88. <i>Vulpes vulpes</i> (Dhëlpër)	89
Foto 89 dhe 90. Vendosja e barit dhe kripës për bimëngrënësit në PK "Sharri"	89
Foto 91. <i>Buteo buteo</i> (Petriri minjngrënës)	90
Foto 92. <i>Merops apiaster</i> (Babilja)	90
Foto 93. Vendosja e kamerave kurth në PK "Sharri"	91
Foto 94. Rrëqebulli i fotografuar në Shqipëri	91
Foto 95. <i>Ambrosia artemisiifolia</i>	93
Foto 96. <i>Pseudorasbora parva</i>	93
Foto 97. Ekspozitat e vendosura në bodrumin e Muzeut të Kosovës	93
Foto 98. Pejzazh pyjor- PK "Bjeshkët e Nemuna".	94
Foto 99. Pyjet halore në Malet e Sharrit	94
Foto 100. Zjarrë në pyjet e Sharrit	97
Foto 101. Vullnetarë gjatë shuarjes së zjarrit	98
Foto 102. Ekturizmi në PK. "Sharri"	100
Foto 103. Ekturizmi në PK. Bjeshkët e Nemuna"	100
Foto 104. <i>Achillea alexandri-regis</i>	103
Foto 105. <i>Dianthus barbatus</i>	103
Foto 106. <i>Helleborus purpurascens</i>	103
Foto 107. <i>Leontopodium alpinum</i>	103
Foto 108. <i>Micromeria cristata</i>	104
Foto 109. <i>Linaria alpine</i>	104
Foto 110. <i>Adonis microcarpa</i>	104
Foto 111. <i>Fritillaria graeca</i>	104
Foto 112. <i>Laburnum alpinum</i>	104
Foto 113 dhe 114. Pjese e parkut dhe vizitës edukativo-arsimore të një grupi nxënësish	105

Foto 115 dhe 116. Çaste nga promovimi i Strehimorës së arinjëve	105
Foto 117 dhe 118. Treni ekologjik që mendohet të vendoset në park dhe shtegu i poshtëm për këmbësorë	107
Foto 119. Pjesë nga faqja e internetit të projektit ku janë prezentuar Parqet e Kosovës	108
Foto 120 dhe 121. Pamje nga aktivitetet në kuadër të realizimit të projektit	109
Foto 122. Vizitë në rajonin e Bjeshkëve të Nemuna	109
Foto 123. Takim i GP të projektit	109
Foto 125. Pjesëmarresit e Konferencës	110
Foto 126 dhe 127. Deltari Ilir dhe Gjeli Këndimgjatë.	112

1 PJESA HYRËSE

1.1. HYRJE

Hartimi i Raportit për gjendjen e natyrës në Kosovë, është përgjegjësi dhe detyrë e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës e rregulluar sipas nenit 142 të Ligjit për Mbrojtje e Natyrës¹.

Qëllimi kryesor i Raportit është informimi i publikut për gjendjen e natyrës, zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit të Kosovës, mirëpo përmes këtij Raporti, synohet që duke informuar politikbërësit të ndikohet në përmirësimin e politikave për menaxhimin dhe konservimin e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit. Ky Raport mund të shërbejë edhe si një udhëzues i mirë për orientimin e projekteve dhe mbështetjes së donatorëve në sektorin e mbrojtjes së natyrës.

Raporti përmban të dhëna për kornizën ligjore, strategjike dhe institucionale në sektorin e natyrës, gjendjen e zonave të mbrojtura të natyrës, biodiversitetin, llojet e rralla bimore e shtazore, ekosistemet pyjore dhe ekoturizmin. Pjesë e rëndësishme e raportit janë edhe masat e ndërmarra për mbrojtjen e natyrës, konkluzionet dhe rekomandimet.

Të dhënat e prezantuara në këtë Raport janë mbledhur gjatë vizitave në terren nga IKMN, të dhëna që janë siguruar nga organet menaxhuese të zonave të mbrojtura, si dhe institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare. Pjesë e Raportit janë edhe informatat nga ligjet, strategjitë, publikimet, raportet dhe dokumentet tjera relevante për sektorin e mbrojtjes së natyrës.

Të dhënat e Raportit i referohen kryesisht periudhës 2010-2014, mirëpo në disa raste në mungesë të dhënave dhe për aspekte të krahasimit janë prezantuara të dhëna edhe për një periudhë të mëhershme.

1.2. PROFILI I KOSOVËS

1.2.1. Pozita gjeografike

Kosova ka pozitë gjeografike qendrore në Gadishullin Ballkanik. Shtrihet në mes të 41°50'58" dhe 43°51'42" të gjerësisë gjeografike veriore dhe 20°01'30" dhe 21°48'02" të gjatësisë gjeografike lindore. Pozita gjeografike e Kosovës konsiderohet me rëndësi të veçantë nga aspekti ekonomik, kulturor dhe politik, me rajonin dhe botën. Kosova ka sipërfaqe 10.908 km², me rreth 1.8 milion banorë (regjistrimi 2011) dhe me dendësi mesatare prej 165 banorë në km². Kufizohet me Shqipërinë (në jugperëndim), me Maqedoninë (në juglindje), me Serbinë (në lindje, veri dhe verilindje) dhe me Malin e Zi (në perëndim). Gjatësia e përgjithshme e kufirit të Kosovës me vendet fqinje është rreth 700.7 km.

1.2.2. Relievi

Kosova është vend malor dhe me ultësira të përbëra nga Fusha e Kosovës (me lartësi mbidetare 510-570 m) dhe Rrafshi i Dukagjinit (lartësia mbidetare 350-450 m).

Nga aspekti morfologjik, paraqet një mozaik të vërtetë të fushëgropave me dimensione të ndryshme, të përkufizuar me male të mesme e të larta. Në morfologjinë e relievit veçohen zonat malore, në ndërtimin e të cilës marrin pjesë shkëmbinjtë e moshave të ndryshme

¹ Ligji Nr.03/L-233 - Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

gjeologjike. Më prezent janë paleozoiku (Pz) dhe mezozoikut (Mz), ndërsa në zonën e ulët të fushës mbizotërojnë sedimentet e reja të pliocenit (Pl), të përbëra kryesisht nga shkëmbinjtë terigjen, përkatësisht argjilorë, ranorë e konglomerat dhe më pak gëlqerorë.

Lartësia mesatare mbidetare e Kosovës është 810m, kurse pika me e ulët është 270m e ajo me e larta 2656m (Gjeravica). Në aspektin hipsometrik sipërfaqe nën 300m lartësi mbidetare përfshinë vetëm 16.4 km² (0.2%) deri 1000 m shtrihen 8754 km² (80.7%), prej 1000 deri 2000 m 1872.3 km² (17%) dhe mbi 2000m deri 250.6 km² (2.3%). Format kryesore në relievin e Kosovës janë: Malet me (63%) dhe fushëgropat (37%).

1.2.3. Klima

Kosova karakterizohet me klimë të mesme-kontinentale, me ndikim edhe të klimës mesdhetare në Rrafshin e Dukagjinit, përmes luginës së Drinit të Bardhë. Të reshurat mesatare vjetore janë 596 mm ndërsa temperaturat mesatare vjetore 10 °C, (temperatura minimale -27 °C dhe maksimale 39 °C)².

Makrofaktorët kryesorë klimatik, të cilët ndikojnë në klimën e Kosovës janë: pozita e saj ndaj masave tokësore (Evroazia dhe Afrika), masat ujore (Oqeani Atlantik dhe Deti Mesdhe), masat e ajrit (tropike dhe arktike-maritime apo kontinentale), pozita e sistemeve barike (maksimumi i azoreve dhe minimumi i Islandës). Faktorët lokal kryesorë që ndikojnë në klimën e Kosovës janë: relievi, ujërat, trualli dhe bimësia.

1.2.4. Hidrografia

Kosova ka rezerva të pamjaftueshme ujore, që në të ardhmen do të jenë një faktorë kufizues për zhvillimin ekonomik të vendit. Vlerësohet se Kosova ka vetëm 1600 m³/ujë/vit për kokë banori. Në aspektin hidrografik Kosova ndahet në 4 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepenci. Nga territori i Kosovës në vitin me lagështi mesatare rrjedhin përafërsisht 3.8 x 10⁹ ujë përkatësisht 121.2 m³/sek.

Karakteristikë kryesore hidrologjike në Kosovë është shpërndarja jo e barabartë dhe jo adekuate e resurseve ujore në krahasim me nevojat. Potenciali për energji ujore në Kosovë është i vogël dhe deri më tani shfrytëzimi i saj është mjaft modest.

Rezervat e ujërave nëntokësore janë të kufizuara dhe gjenden kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës, ku edhe rezervat e ujërave sipërfaqësore janë më të mëdha, në krahasim me pjesën lindore me rezerva të pakta dhe pjesën jug-lindore ku nevojat për ujë janë shumë të mëdha.

Kosova ka numër të vogël të liqeneve natyrore, ndërsa liqene artificiale janë: Batllava, Gazivoda, Radoniqi, Përlepnica dhe Badovci, uji i të cilëve shfrytëzohet për furnizim të popullsisë me ujë, industri, bujqësi etj. Kosova ka burime të rëndësishme të ujërave termale të cilat shfrytëzohen për qëllime shërimi dhe rekreacioni. Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i resurseve ujore është shumë i rëndësishëm dhe një ndër sfidat më të mëdha mjedisore të Kosovës.

² Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, 2008




Fig. 1. Hidrografia e Kosovës

1.3. HISTORIKU I MBROJTJES SË NATYRËS NË KOSOVË

Hapat e parë të mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit në Kosovë fillojnë në fund të viteve të '60. Në vitin 1968 formohet njësia për mbrojtjen e natyrës në kuadër të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës. Në vitin 1974 me Vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës themelohet Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës³, i cili vazhdoi punën me të njëjtin emër sipas Ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës⁴. Ndërsa, në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut⁵, ku në nenin 78 paragrafi 2 të këtij ligji është përcaktuar veprimtaria e Entit. Në bazë të këtij ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit⁶.

Pas luftës në Kosovë, krijohen rrethana të reja të qeverisjes. Në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së me emërtim "Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës", me seli në Prishtinë.⁷ Në Maj të vitit 2000 themelohet Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe në kuadër të tij përfshihen dhe veprojnë edhe institucionet ekzistuese: Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe Drejtoria e Parkut Kombëtar "Mali Sharr".

Pas formimit të organeve qeverisëse të Kosovës (2001) formohet edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor⁸.

Në vitin 2002 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.2002/8 (Rreg.2003/22) ku sipas këtij Ligji është paraparë që të themelohet Agjencioni i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe në kuadër të tij të përfshihet Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Instituti Hidrometeorologjik. Në vitin 2006, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Rreg. 2006/22), me të cilin u shfuqizua Ligji i vitit 1988 dhe sipas këtij Ligji, Instituti kryen vetëm punët e mbrojtjes së natyrës (neni 9 paragrafi 2). Në vitin 2010 Kuvendi i Republikës së Kosovës miraton Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.

Me themelimi e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, pjesa dërmuese e stafi të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës sistemohet në pozita e reja të AMMK-së. Nga viti 2006 në kuadër të AMMK ka vepruar sektori për mbrojtjen e natyrës, ndërsa në Maj të vitit 2013 zgjidhet Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Aktualisht, detyrat dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e natyrës realizohet përmes Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës i cili vepron në kuadër të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

3 Vendimi për ndarjen e seksionit për mbrojtjen e natyrës ("GZK". 42/74)

4 Ligji për themelimin e Entit Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës ("GZK". 15/81)

5 Ligji për Mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut ("GZK" 39/88)

6 Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit ("GZK"nr. 38/89)

7 Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës: nr. i regjistrimit të përkohshëm të subjektit Afarist 80156359, data 14.08.00)

8 Formimi i MMPH-se (Rreg. 2001/19 dhe 2002/5)

2 KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

2.1. KORNIZA LIGJORE

Për mbrojtjen e natyrës parimet themelore janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Neni 52 i sajë definon përgjegjësitë për mjedisin me paragrafët në vijim:

1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin;
2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton;
3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve;

Kuadri ligjor për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në Republikën e Kosovës përbëhet nga:

2.1.1. Ligjet

- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës GZRK Nr. 85/09 (Nëntor 2010);
- Ligji Nr. 04/L-086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” GZRK Nr. 2/21 (Janar 2013);
- Ligji Nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar “Sharri” GZRK Nr. 2/21 (Janar 2013);
- Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit GZRK Nr.50/09 (Prill 2009)
- Ligji Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës me ndryshimet dhe plotësime 2004/29;
- Ligji Nr. 02/L-53 për Gjuetinë, (11 Gusht 2006);
- Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, (23 Shtator 2010);
- Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, (30 Shtator 2010);
- Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, (31 Korrik 2013);
- Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë, (10 Tetor 2006);
- Ligji Nr. 02/L-122 për Bujqësi organike, (08 Janar 20008);
- Ligji Nr. 02/L-95 për Mbrojtjen e Bimëve, (31 Janar 2007);
- Ligji Nr. 02/L – 41 për mbrojtjen nga zjarri etj.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082 në Kapitullin XXVIII gjegjësisht nga neni 347 deri 364 përfshin veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore.

Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës GZRK Nr. 85/09 Nëntor 2010

Ky ligj rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht:

- mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore;
- përtëritjen e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës;
- pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos

i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimeve të tyre;

- sigurimin e të drejtës së publikut për informim për gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës;
- sigurimin e ushtrimit e të drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë;
- parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridik dhe fizik në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike;
- mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Kosovën sipas standardeve të BE-së;
- ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve te cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).

2.1.2. Aktet nënligjore:

Në kuadër të obligimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, janë nxjerrë tri lloje të akteve nënligjore: Rregullore, Udhëzime Administrative dhe Vendime:

2.1.2.1. Rregulloret:

- Rregullorja Nr. 21-2013 e MMPH-së e shpallur në GZRK Nr. 46/08.11.2013 për rendin e brendshëm të Parqeve Kombëtare;
- Rregullorja Nr. 23-2014 e MMPH-së për rendin e brendshëm të Monumentit të Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Shpella e Gadimes”.

2.1.2.2. Udhëzimet Administrative:

- Udhëzim Administrativ për grumbullimin e llojeve të bimëve të egra të mbrojtura, me qëllim të përpunimit dhe tregtimit Nr. 08/2011/ (13.07.2011),
- Udhëzim Administrativ për llojet e vendbanimeve natyrore, hartat e vendbanimeve natyrore, tipat e vendbanimeve natyrore të rralla dhe të kërcënuara si dhe masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e tipave të vendbanimeve natyrore Nr. 12/2011/ (18.08.2011),
- Udhëzim Administrativ për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shenjëzimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim Nr. 01/2012/ (28.02.2012),
- Udhëzim Administrativ për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të regjistrit të vlerave të mbrojtura të natyrës Nr. 07/2012/ (18.06.2012),
- Udhëzim Administrativ për vendkalimet shtazëve të egra Nr. 16/2012 / (01.08.2012),
- Udhëzim Administrativ për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura Nr. 18/2012/ (01.08.2012),
- Udhëzim Administrativ për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e lëshimit të kartës identifikuese si dhe dukjen e uniformës të mbikëqyrësit dhe rojtarit të natyrës Nr. 24/2012/ (05.12.2012),
- Udhëzim Administrativ për qarkullimin dhe tregtinë ndërkufitare me llojet e egra të mbrojtura Nr. 26/2012/ (10.12.2012),
- Udhëzim Administrativ për formën dhe mënyrën e dhënies së kartës dhe shenjëz zyrtare për inspektorin për mbrojtjen e natyrës Nr. 27/2012/ (20.12.2012),
- Udhëzim Administrativ për llojin, dukjen, procedurën dhe mënyrën e ndarjes së mirënjohjeve dhe shpërblimeve për të arriturat në lëmin e mbrojtjes së natyrës Nr. 06/2013/ (20.05.2013),

- Udhëzimi Administrativ për shenjen e mbrojtjes së natyrës Nr. 07/2013/ (20.05.2013),
- Udhëzimi Administrativ për mënyrën e hartimit dhe zbatimit të studimit për vlerësimin e rrezikut nga futja, ri-futja dhe kultivimi i llojeve të egra Nr. 14/2013/ (01.07.2013),
- Udhëzimi Administrativ për vlerësimin e pranueshmërisë së planit, programit ose ndërhyrjes në rrjetën ekologjike Nr. 19/2013/ (26.08.2013),
- Udhëzimi Administrativ për mënyrën dhe kushtet e kryerjes së punëve të rojtarëve të natyrës Nr. 23/2013/ (12.11.2013),
- Udhëzimi Administrativ i QRK për Shpalljen e Rrjetit ekologjik Nr. 03/156/ (13.11.2013),
- Udhëzimi Administrativ për parandalimin dhe kompensimin e dëmeve që shkaktohen nga llojet e egra të shtazëve strikt të mbrojtura Nr. 15/2014/ (02.06.2014),
- Udhëzimi Administrativ për klasifikimin e vlerave të mbrojtura të natyrës sipas rëndësisë Nr. 24/2014/ (27.11.2014),

2.1.2.3 Vendimet:

- Vendimi i Kuvendit të Kosovës Nr. 04 – V - 772 dt. 11.02. 2014 për miratimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”.
- Vendimi i Kuvendit të Kosovës Nr. 3023/3 – 2013 dt. 18.03. 2014 për miratimin e Planit Hapësinor të MNRV “Ujëvarat e Mirushës”.
- Vendimi i Qeverisë Nr. 04/57 dt. 13. 03.2009 për vënien nën mbrojtje të Monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë “Shpella e Gadimes”, Gadime e ultë KK Lypjan.
- Vendimi i Qeverisë Nr. 06/75 dt. 23. 05. 2012 për Shpalljen e Monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë “Ujëvarat e Mirushes”.
- Vendimi i Qeverisë Nr. 03/156 dt. 13. 11. 2013 për aprovimin e UA për shpalljen e Rrjetit ekologjik.
- Vendimi i Qeverisë Nr. 01/178 dt. 18. 03. 2014 për shpalljen e Ligatinës së Hencit - Radeves Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve.
- Vendimi i Ministrit Nr. 03/2013 dt. 11. 02. 2013 mbi themelimin e Drejtorisë për administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” me seli në Prizren.
- Vendimi i Ministrit Nr. 04/2013 dt. 11. 02. 2013 mbi themelimin e Drejtorisë për administrimin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” me seli në Pejë.
- Vendimi i Ministrit Nr. 5034/14 dt. 15. 10. 2014 për shpalljen nën mbrojtje të racës së Gjelit Kosovar Këndimgjatë lloj vendor i zbutur.
- Vendimi i Ministrit Nr. 5035/14 dt. 15. 10. 2014 për shpalljen nën mbrojtje të racës së qenit Deltari Ilir lloj vendor i zbutur.

2.1.3. Strategjitë, Planet Hapësinore, Planet Menaxhuese dhe Dokumentet tjera

- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011 - 2020, miratuar nga Kuvendi i Kosovës, dt. 07. Tetor. 2011;
- Strategjia kombëtare për sektorin e produkteve pyjore jo drunore (PPJ) 2014-2020;
- Strategjia e Mbrojtjes së Klimës në Sektorin e Pylltarisë në Kosovë (Dhjetor 2012);
- Strategjia e Pyjeve 2010-2020;
- Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”;

- Plani Hapësinor për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e Mirushes”;
- Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet për Komunën e Dragashit.
- Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet për Komunën e Prizrenit.
- Plani i punës për përzgjedhjen e zonave Natura 2000 me tregues për të dhënat e nevojshme, përgjegjësitë, afatet kohore dhe buxhetin.
- Udhëzuesi për Planet e Menaxhimit të Parqeve Kombëtare në Kosovë, 02. Maj. 2012.
- Udhëzuesi për Planet e Menaxhimit të Parqeve Kombëtare në Kosovë, (02. Maj. 2012);
- Raporti teknik Identifikimi paraprak i zonave Natura 2000 në Kosovë, 30. 06. 2008.

2.1.3.1 Dokumente në procedurë të miratimit:

- Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, (në procedurë të hartimit);
- Plani Menaxhues për Parkun Kombëtar “Sharri”;
- Propozimi Profesional për rikategorizimin e Parkut Regjional Natyror “Gërmia” në kategorinë Peizazh i Mbrojtur.
- Propozimi Profesional për shpalljen e Liqeneve të Vasilevës Peizazh i Mbrojtur.

2.1.3.2 Strategjitë sektoriale

Në legjislacionin mjedisorë të Kosovës përveç hartimit të Strategjisë së Kosovës për Mjedisin dhe Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis është paraparë edhe hartimi i strategjive sektoriale, planeve të veprimit dhe programeve për sektorët kryesorë të mjedisit si: biodiversitetin, ndryshimet klimatike, mbrojtjen e tokës, mbrojtjen e pyjeve, etj.

Gjatë vitit 2011 është miratuar në Kuvendin e Kosovës, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2010-2020, ndërsa janë në procedure për miratim edhe strategji tjera.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin është dokument bazë për mbrojtjen e natyrës, i cili i përcakton synimet afatgjata të ruajtjes së biodiversitetit dhe larmisë peizazhore, vlerave të mbrojtura të natyrës, si dhe mënyrën e zbatimit në harmoni me zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i kësaj strategjie nuk është të listoj të gjitha çështjet e hapura të cilat kanë të bëjnë me biodiversitetin në Kosovë, të krijoj një kornizë të synimeve dhe aktiviteteve si dhe një koordinim më të mirë, duke i dhenë prioritet programeve dhe duke ofruar qasje strategjike për zhvillimin e iniciativave në të ardhmen.

Përmes kësaj strategjie synohet:

- Ruajtja (konzervimi) i biodiversitetit;
- Zhvillimi i qëndrueshëm bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore;
- Krijimi i të hyrave dhe
- Ndarja e përfitimeve nga shfrytëzimi i biodiversitetit në mënyrë të barabartë.

Plani i Veprimit ka identifikuar listën e veprimeve dhe projekteve kryesore të cilat do të ndërmerren për periudhën e ardhshme 5 (pesë) vjeçare në pesë pilot zonat.

Strategjia e Pylltarisë 2010 – 2020

Strategjia është e hartuar me qëllim të formulimit të politikave dhe strategjive që do të qeverisin zhvillimin e ardhshëm të Sektorit Pyjor në Kosovë.

Mjedisi i ri ekonomik dhe gjendja në sektorin pyjor theksojnë nevojën urgjente për krijimin e sistemeve efikase për menaxhim shumëqëllimor të resurseve pyjore si dhe zhvillimin e një industrie pyjore e cila është në harmoni me resurset ekzistuese.

Politikat dhe strategjia janë në përputhje me legjislacionin pyjor ekzistues dhe rregullojnë të gjitha vendimet e mëdha të cilat kanë të bëjnë me pylltarinë për 10 vjetët e ardhshme.

Strategjia e menaxhimit të kafshëve të egra dhe gjuetisë (2012-2022)

Kjo Strategji është dokument afatgjatë për ruajtjen e tërësisë së ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike, mbrojtjen adekuate të kafshëve të egra, sigurimin e mirëqenies dhe kushteve për shfrytëzim ekonomik të tyre dhe resurseve natyrore.

Strategjia duhet të mundësojë mbrojtjen e resurseve natyrore të Kosovës, florën, faunën, mjediset e tyre dhe të përparojë relacionin në lidhje me llojet shtazore, në mënyrë që ato të mbijetojnë dhe të mbesin në numër optimal të popullatës. Strategjia gjithashtu jep rekomandime për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e gjendjes ekzistuese si dhe në kushtet e përgjegjësisë dhe bashkëpunimit me palët e interesit.

Qëllimi kryesor i strategjisë është: të respektohet tërësia e ekosistemit, të arrihet mbrojtja adekuate e llojeve të kafshëve të egra dhe llojeve të tjera, të sigurohet mirëqenia dhe kushtet për shfrytëzim ekonomik të resurseve, në atë mënyrë që ato të kontribuojnë në ekonominë e Kosovës.

Strategjia e Produkteve Pyjore jo Drusore (PPJD)

Strategjia kombëtare për sektorin e Produkteve Pyjore Jodrusore (PPJD-ve) është dokumenti bazë për mbrojtjen, kultivimin, grumbullimin, shfrytëzimin dhe tregtimin e PPJD-ve, që përcakton synime afatgjata për ruajtjen e kësaj pasurie kombëtare që është me interes për zhvillimin ekonomik të zonave rurale të Kosovës.

Qëllimi i kësaj Strategjie është zhvillimi i një kornize normative dhe institucionale, ku veprimtaritë në kuadër të strategjisë në sektorin e PPJD-ve do t'i kontribuonin menaxhimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve, duke lehtësuar në këtë mënyrë gjenerimin e të ardhurave në vendet rurale.

Strategjia përqendrohet në aspektet: socio-ekonomike, mjedisore dhe ligjore.

Përmes Strategjisë përcaktohen kahet e zhvillimit të këtij sektori, gjegjësisht identifikohen prioritetet, veprimtaritë, plani i veprimit dhe ndarja e përgjegjësisë tek institucionet përgjegjëse.

2.1.4. Marrëveshjet regjionale

Në lëmin mbrojtjes së natyrës, Kosova ka nënshkruar këto dokumente:

- Rezoluta për zhvillimin e qëndrueshëm të regjionit të Harkut Dinarik e nënshkruar në Brdo, Slloveni 09.03.2011.
- Marrëveshja për zhvillimin e ekoturizmit në zonën e mbrojtur ndërkufitare Sharr-Korab, Tetovë 07.11.2013.
- Marrëveshja e përbashkët (Big Win 2) mes shteteve të rajonit Dinarik për ruajtjen më të mirë të natyrës në kuadër të Regjionit të Harkut Dinarik, Budvë, Mali i Zi 02.10.2013.

- Memorandumi i bashkëpunimit në mes të AMMK/IKMN-së dhe Qendrës së Hulumtimeve të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Sllovenisë – Instituti për Hulumtime Karstike. 16.06.2014.
- Marrëveshja për bashkëpunim dhe ndihmën e ndërsjellë për mbajtjen dhe përkujdesjen e arrinjëve të murrëm në Strehimorën e lidhur në mes të MMPH-së dhe Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve “VIEF PFOTEN” – Austri 08.03.2013
- Nënshkrimi i marrëveshjes për Bashkëpunim në mes Universitetit të Konstanz-it në Gjermani, Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Universitetit të Prishtinës në kuadër të projektit për ngritjen e një Qendre për Edukim Mjedisor në Kosovë, 12.11.2014.

2.1.5. Harmonizimi me Direktivat e Bashkimit Evropian në sektorin e mbrojtjes së natyrës

Tabela 1. Direktivat dhe Konventat e Bashkimit Evropian në sektorin e mbrojtjes së natyrës

Nr.	Emri i direktivës	Viti i ratifikimit	Qëllimi	Harmonizimi në legjislacionin kombëtarë (%) ¹
1	Direktiva 2009/147/EC për ruajtjen e zogjve të egër	Së pari është miratuar nga Shtetet Anëtare në vitin 1979, është pjesa më e vjetër e legjislacionit të natyrës në Bashkimin Evropian	Direktiva ofron një kornizë të plotë për mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e të gjithë zogjve të egër që ndodhen në BE. Direktiva udhëzon shtetet anëtare të marrin masa për të mbajtur popullacionin e të gjitha llojeve të zogjve të egër që ndodhen në shtetin e BE-së (neni 2). Masa të tilla mund të përfshijnë mirëmbajtjen dhe / ose ri-krijimin e vendbanimeve në mënyrë që të mbajnë këto popullacione të zogjve (Neni 3)	95%
2	Direktiva 1999/22/EC ZOOs- kanë të bëjnë me mbajtjen e shtazëve të egra në kopshte zoologjike	29 Mars 1999	Objektivat e Direktivës janë që të mbrojnë faunën e egër dhe të ruajnë biodiversitetin duke siguruar miratimin e masave nga Shtetet Anëtare për licencimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike në komunitet, në mënyrë të forcimit të rolit të kopshteve zoologjike në ruajtjen e biodiversitetit.	80%

3	Direktiva 92/43/EEC për ruajtjen e vendbanimeve natyrore dhe florës dhe faunës së egër.	21 Maj 1992	Qëllimi kryesor i Direktivës së Vendbanimit është për të promovuar ruajtjen e biodiversitetit, kërkohet nga shtetet anëtare të marrin masa për të mbajtur ose rikthyer vendbanimet natyrore dhe llojet e egra të listuara në Shtojcat e Direktivës me një status të favorshëm të ruajtjes, duke futur mbrojtje të fuqishme për ato vendbanime dhe lloje të rëndësishme Evropiane. Në zbatimin e këtyre masave Shtetet Anëtare duhet të marrin parasysh kërkesat ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe karakteristikat rajonale dhe lokale.	96%
4	Direktiva kornizë për ujërat (2000/60/EC).	23 tetor 2000	Mirëmbajtjen e "statusit të lartë ekologjik" të ujit aty ku ekziston duke parandaluar çdo keqësim të gjendjes ekzistuese të ujërave dhe arritjen e së paku "statusit të mirë" në raport me të gjitha ujërat deri në 2015.	48.8%
5	Direktiva 2004/35/EC mbi përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe përmirësimin e dëmit mjedisor (Direktiva Përgjegjësia për Mjedisin).	Direktiva u miratua në prill 2004. Ajo trajton vetëm dëme dhe ngjarje të dëmshme të cilat ndodhin pas afatit të fundit për transpozimin në nivel të Shteteve Anëtare, 30 prill 2007.	Direktiva Përgjegjësia për Mjedisin ka për qëllim për t'i bërë ligjrisht dhe financiarisht përgjegjës të gjithë dëmtuesit për dëmtimin e mjedisit (ujit, tokës dhe të natyrës).	76%

2.1.6. Konventat ndërkombëtare

Tabela 2. Konventat ndërkombëtare

Nr.	Emri i Konventës	Viti i ratifikimit	Qëllimi
1	Konventa për Diverzitetin Biologjik (Konventa e RIO-s).	Rio, 5 Qershor 1992	Objektivat e kësaj Konvente janë: ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike, shfrytëzimi i qëndrueshëm i përbërësve të saj dhe ndarja e drejtë dhe e barabartë nga përfitimet që dalin nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike, duke përfshirë qasjen e përshtatshme të resurseve gjenetike dhe transferimin e teknologjive të përshtatshme përkatëse, duke marrë parasysh të gjitha të drejtat mbi ato burime dhe teknologji dhe duke bërë financimin e duhur.

2	Konventa për tregtinë e llojeve të egra të rrezikuara të florës dhe faunës- CITES.	Marrëveshja u bë në takimin e përfaqësuesve të 80 vendeve në Uashington, DC, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 3 mars 1973, dhe më 1 korrik 1975 CITES hyri në fuqi.	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër është një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet qeverive. Qëllimi i tij është që të sigurojë se tregtia ndërkombëtare e ekzemplarëve të shtazëve të egra dhe bimëve nuk kërcënojnë mbijetesën e tyre.
3	Konventa për Ligatinat me rëndësi të veçantë, (Konventa RAMSAR).	Traktati u miratua në qytetin iranian Ramsar në vitin 1971 dhe vendet anëtare të Konventës mbuluan të gjitha rajonet gjeografike të planetit.	Konventa për Ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, të quajtur Konventa Ramsar, është një traktat ndërqeveritar që ofron kornizën për veprim kombëtar dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për ruajtjen dhe shfrytëzimin e mençur të ligatinave dhe burimeve të tyre. Konventa Ramsar është i vetmi traktat global mjedisor që merret me një ekosistem të veçantë. Misioni i Konventës është "ruajtja dhe shfrytëzimi i mençur i të gjitha ligatinave përmes veprimeve lokale dhe kombëtare dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, si një kontribut drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë botën."
4	Konventa për Ruajtjen e Llojeve Migratore të Shtazëve të egra (Konventa e BON-it).	1 Nëntor 1983, Bon	Konventa për Ruajtjen e Llojeve Migratore të Shtazëve të egra (e njohur edhe si CMS ose Konventa e Bonit) ka për qëllim për të ruajtur llojet migratore tokësore, ujore dhe llojeve migratore kudo që gjenden në zonën e tyre. Kjo është një traktat ndërqeveritar, përfundon nën kujdesin e Programit të Mjedisit të Kombeve të Bashkuara, që ka të bëjë me ruajtjen e Shtazëve të Egra dhe Vendbanimeve në shkallë globale.
5	Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë kulturore dhe natyrore Botërore.	Konventa ka hyrë në fuqi me 17 Dhjetor 1975. Paris.	Qëllimi i konventës është për të ruajtur zonat natyrore dhe piktoreske në botë dhe vendet historike për të tashmen dhe të ardhmen e të gjithë qytetarëve të botës.

2.2. KORNIZA INSTITUCIONALE

2.2.1. Organet Vendimarrëse:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVES

- Bordi për Mbrojtjen e Mjedisit
- Komisioni funksional i Kuvendit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Organet përgjegjëse për administrimin e mbrojtjes së natyrës janë:

2.2.1.1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – MMPH

Koordinon aktivitetet në fushën e mbrojtjes mjedisore në mënyrë që të promovojë zhvillimin koherent të politikave për mbrojtje mjedisore, zhvillon norma dhe standarde si dhe nxjerr udhëzime në fushën e mbrojtjes mjedisore me respekt të veçantë në standardet ndërkombëtare, mbikëqyr zbatimin e standardeve të tilla, sipas rrethanave, duke kryer inspektime dhe shërbime të tjera, merr pjesë në zhvillimin dhe implementimin e fushatave të informimit publik si dhe skemat tjera promovuese për të ngritur vetëdijen e publikut dhe përputhshmërinë me standardet e mbrojtjes mjedisore.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës - IKMN:

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës⁹ në kuadër të veprimtarisë së vetë kryen punët profesionale në mbrojtjen e natyrës që kanë të bëjnë me:

- mbledhjen dhe përpunimin e shënimeve lidhur me mbrojtjen e natyrës;
- hartimin e bazave afatgjata profesionale të mbrojtjes për llojet e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve, tipave të vendbanimeve, ekosistemeve dhe peizazheve;
- monitorimin e gjendjes së larmisë biologjike dhe peizazhore dhe propozon masat për mbrojtjen e tyre;
- përgatitjen e bazave profesionale për mbrojtjen dhe ruajtjen e pjesëve të natyrës, përkatësisht vlerave të natyrës;
- hartimin e bazave profesionale për nevojat e përcaktimit të kushteve për mbrojtjen e natyrës, menaxhimin me zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimi i të mirave të natyrës;
- kryerjen e analizave statistikore dhe unifikimin e rezultateve si dhe hartimin e raportit për gjendjen dhe mbrojtjen e natyrës;
- pjesëmarrje në zbatimin e akteve ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës.

Drejtoria e Parkut Kombëtar “Sharri”

Kjo drejtori është institucion kompetent për të bërë qeverisjen e drejtpërdrejtë të Parkut Kombëtar “Sharri” sipas detyrave dhe përgjegjësi ligjore.

Parku menaxhohet në bazë të Ligjit për Parkun Kombëtar Sharri, Nr. 04/L – 087 (GZRK nr. 2/21 janar 2013). Menaxhimi i Parkut rregullohet edhe përmes Planit Hapësinor për Parkun dhe Planit Menaxhues.

⁹ Ligji për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233

Drejtoria e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Është institucion kompetent për të bërë qeverisjen e drejtpërdrejtë të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” sipas detyrave dhe përgjegjësi ligjore.

Parku menaxhohet në bazë të Ligjit për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, Nr. 04/L – 086 (GZRR nr. 2/21 janar 2013).

Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës

Funksionon në kuadër të Departamentit Mbrojtja e Mjedisit dhe kryen punë administrative dhe profesionale në lidhje me ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e vlerave të trashëguara të natyrës, mbrojtjen e dheut nga ndotja si dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore në Republikën e Kosovës.

Instituti i Planifikimit Hapësinor

Është institucion kompetent për hartimin e Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta të mbrojtura, sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.

2.2.1.2. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural¹⁰ - MBPZHR

Departamenti i Pylltarisë

Është përgjegjës për: hartimin dhe zhvillimin e politikave pyjore, Ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë lëmin e pylltarisë, kafshëve të egra dhe ekoturizmit në Republikën e Kosovës¹¹.

Agjencioni Pyjor i Kosovës

Është përgjegjës për çështjet e ndërlidhura me rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, zbatimin e legjislacionit pyjor, lëshimin e lejeve për shfrytëzimin e prodhimeve pyjore drusore dhe jo drusore në Republikën e Kosovës.

Instituti Pyjor i Kosovës

Ofron mbështetjen teknike dhe shkencore për Departamentin e Pylltarisë dhe Agjencionin Pyjor të Kosovës.

2.2.1.3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- MKRS

Muzeu i Kosovës

Seksioni i Natyrës në kuadër të tij, ruan një pjesë të trashëgimisë natyrore të Kosovës që dokumentojnë shumëllojshmërinë e formave jetësore nga botanika dhe zoologjia në aspektin ekologjik dhe biogeografik të këtyre hapësirave.

2.2.1.4. Pushteti lokal - Komunat

Komunat në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor janë të detyruara që të kujdesen për

¹⁰ www.mbpzhr-rks.net

¹¹ www.mbpzhr-rks.net

ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e tyre. Komunitetet detyrohen që të nxjerrin programet për mbrojtjen e natyrës për territorin e vet.

2.2.1.5. Institucionet Shkencore

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Universiteti i Prishtinës merren me kërkime dhe hulumtime shkencore në lëmin e natyrës dhe biodiversitetit.

Banka e Gjeneve

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës në bankat e gjeneve ruhet materiali gjenetik, popullacioni i mbikëqyrur ose i kultivuar ose pjesë të shtazëve, kërpudhave ose bimëve, veçanërisht farat, sporet, qelizat gjinore dhe materiali tjetër gjenetik, i cili administrohet me qëllim të ruajtjes së llojeve, përkatësisht të bagëtive të tyre gjenetike.

Një Institucion i tillë funksionon në kuadër të Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.

2.2.1.6. Organizatat e Shoqërisë Civile Mjedisore

Edhe përkundër ekzistimit të një numri të konsideruar të OJQ-ve mjedisore, asnjë prej tyre nuk e ka programin e vet të orientuar vetëm për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit.

3 KLASIFIKIMI I ZONAVE TË MBROJTURA

Klasifikimi i Zonave të Mbrojtura në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës është pjesërisht në harmoni me Unionin Botëror për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Zonat e mbrojtura të natyrës sipas këtij Ligji klasifikohen në 7 kategori:

3.1. REZERVATI STRIKT I NATYRËS

Rezervati strikt i natyrës është zonë e tokës dhe/ose ujit e pandryshuar ose shumë pak e ndryshuar dhe është i dedikuar ekskluzivisht për ruajtjen e natyrës së paprekur, hulumtime shkencore të larmisë biologjike, përcjelljen e gjendjes së natyrës si dhe arsimimit nëse nuk rrezikojnë zhvillimin e lirshëm të proceseve natyrore.

Për hulumtime dhe vizita arsimore në rezervatin strikt duhet të merret leja nga Ministria. Në rezervatin strikt ndalohet kryerja e veprimtarive ekonomike dhe veprimtarive të tjera. Për rezervatet strikte të natyrës vlen shkalla e I-rë e mbrojtjes dhe ato shpallën nga Qeveria.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura, rezervatet natyrore përfshijnë 847 ha. Në Kosovë deri më tash kemi 3 lloje të rezervateve të mbrojtura: rezervate bimore (7), rezervate shtazore (2) dhe rezervate speciale (2).

3.2. PARKU KOMBËTAR

Parku kombëtar është zonë e gjerë e tokës dhe/ose ujit, me vlera të jashtëzakonshme dhe të shumëllojshme natyrore, përfshin një ose më shumë ekosisteme natyrore të ruajtura ose pak të ndryshuara dhe kryesisht dedikohet për ruajtjen e vlerave burimore të natyrës.

Parku kombëtar ka rëndësi shkencore, kulturore, edukativo arsimore dhe rekreative.

Në parkun kombëtar lejohen punët dhe veprimtaritë me të cilat nuk rrezikohet natyra burimore. Në parkun kombëtar ndalohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës.

Në parkun kombëtar lejohen veprimtaritë hoteliere – turistike dhe rekreative të cilat janë në funksion të vizitave, arsimimit, të nevojave shëndetësore – rekreative dhe turistike, bujqësia ekstensive tradicionale, peshkataria nëse nuk rrezikohet ekzistenca e llojeve dhe baraspesha natyrore në pajtim me Ligjin e natyrës dhe planin e menaxhimit.

Në Kosovë ekzistojnë dy Parqe Kombëtare të shpallura nga Kuvendi i Kosovës: PK “Sharri” me sipërfaqe 53 469 ha dhe PK “Bjeshkët e Nemuna” me 62.488 ha. Parqet kombëtare përfshijnë gjithsej 115.957 ha.

3.3. ZONA E VEÇANTË E MBROJTUR

Zona e veçantë e mbrojtur është zonë e tokës dhe/ose ujit me rëndësi të veçantë për shkak se është unike, e rrallë - reprezentative, ose është vendbanim i llojeve të egra dhe veçanërisht është i rëndësishëm për hulumtime shkencore.

Zona e veçantë mundet me qenë: bimore, mikologjike, e vegjetacionit pyjor, zoologjike - ornitologjike, ihtiologjike, gjeologjike, paleontologjike, hidrogeologjike, hidrologjike etj.

Në zonën e veçantë nuk lejohen ndërhyrjet, punët dhe veprimtaritë të cilat mundin me ia prishë veçoritë për shkak të cilave është shpallë zonë e veçantë - grumbullimi dhe shkatërrimi i bimëve, shqetësimi, kapja dhe vrasja e shtazëve, futja e llojeve të reja biologjike, ndërhyrjet melioruse, llojet e ndryshme të ekonomizimit dhe shfrytëzimi tjetër e të ngjashme.

Në zonën e veçantë janë të lejuara ndërhyrjet, punët dhe veprimtaritë me të cilat mbahen ose përmirësohen kushtet të rëndësishme për ruajtjen e veçorive për shkak të cilave është shpallë zona.

Në Kosovë ekziston një Zonë e Veçantë e Mbrojtur e zogjve – Ligatina e Hencit - Radeves me sipërfaqe 109 ha.

3.4. PARKU I NATYRËS

Parku i natyrës paraqet zonë të madhe natyrore ose pjesërisht artificiale të tokës dhe ose ujit me karakteristika ekologjik të rëndësisë kombëtare e ndërkombëtare me vlera të theksuara të larmisë peizazhore, edukative-arsimore, kulturo – historike dhe turistike – rekreative.

Në parkun e natyrës lejohen veprimtarit ekonomike dhe aktivitetet tjera me të cilat nuk rrezikohet roli dhe karakteristikat e rëndësishme të tij.

Mënyra e kryerjes së aktiviteteve ekonomike dhe shfrytëzimi i të mirave të natyrës në parkun e natyrës përcaktohen me kushtet për mbrojtjen e natyrës.

Në kuadër të kësaj kategorie të mbrojtjes ende nuk është klasifikuar asnjë zonë e mbrojtur.

3.5. MONUMENTI I NATYRËS

Monumenti i natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike.

Monumenti i natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik, strukturë gjeologjike, sediment etj, geomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik - burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore.

Në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij që është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk lejohen veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij.

Në Kosovë janë të mbrojtura 99 Monumente të Natyrës, me sipërfaqe prej 5.972 ha. Prej tyre 66 me karakter botanik, 17 hidrologjik, 7 geomorfologjik dhe 9 speleologjik.

3.6. PEIZAZHI I MBROJTUR

Peizazhi i mbrojtur është zonë natyrore ose artificiale me vlerë të madhe peizazhore dhe larmi biologjike ose me vlerë kulturo-historike, ose peizazh me veçori të ruajtura unikale karakteristike për zonën e caktuar i dedikuar për pushim dhe rekreacion.

Në peizazhin e mbrojtur nuk lejohen ndërhyrjet dhe punët të cilat prishin karakteristikat për shkak të cilit është shpallë i mbrojtur.

Në kuadër të kësaj kategorie hyjnë Parku Regjional Gërmia me sipërfaqe prej 1.126 ha, Parku i Shkugëzes me sipërfaqen prej 70 ha dhe Pishat e Deçanit me 15 ha. Gjithsej 1.211 ha.

3.7. MONUMENT I ARKITEKTURËS SË PARKUT

Monumenti i arkitekturës së parkut është hapësirë e krijuar artificialisht - kopshti botanik, arboretumi, parku i qytetit, dru radhitjet, si dhe format tjera të kopshteve dhe parqeve, përkatësisht trungje individuale ose grupe trungjesh që kanë vlerë të madhe estetike, kulturo-historike, ekologjike ose shkencore.

Në monumentin e arkitekturës së parkut dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij e cila është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk janë të lejuara veprimtaritë ose punët të cilat mund të ndryshojnë ose të prishin vlerat për shkak të cilave është mbrojtur.

Në kuadër të kësaj kategorie të mbrojtjes ende nuk është klasifikuar asnjë zonë e mbrojtur.

4 KRONOLOGJIA E SHPALLJES SE ZONAVE TË MBROJTURA

Në kronologjinë e shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë mund të veçohen tri periudha kohore të cilat lidhen me zhvillimet e përgjithshme në Kosovë.

Periudha 1950 – 1970, paraqet fazën initiale të mbrojtjes së natyrës dhe shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë e cila fillon me shpalljen e zonës së parë në vitin 1950, që ishte “Gazimestani”. Deri në fillimin e viteve të ‘70 numri i zonave të mbrojtura arrinte në 19. Në këtë periudhë nën mbrojtje vihen: Shpella e Gadimes dhe disa monumente të tjera me rëndësi botanike si: Rrapi në Marash, Trungjet në Isniq, etj.

Periudha 1970 – 1988, paraqet periudhë e cila karakterizohet me shpalljen e numrit të konsiderueshëm të zonave të natyrës. Arsyeja e këtij sukseesi është e lidhur me themelimin e Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në vitin 1974, nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë periudhë, nën mbrojtje janë vënë gjithsej 32 zona të natyrës prej të cilave duhet veçuar: rezervati “Bifurkacioni i Lumit Nerodime”, Parku i parë Kombëtar “Mali Sharr”(1986), Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc (1983) si dhe disa monumente të tjera të natyrës.

Periudha pas vitit 2000, karakterizon rithemelimi dhe rifunksionimi i institucioneve të Kosovës, duke përfshirë edhe institucionet për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit respektivisht Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Gjatë kësaj periudhe nën mbrojtje ligjore janë marrë rreth 80 zona të natyrës dhe janë propozuar për mbrojtje mbi 100 të tjera. Në mesin e zonave të mbrojtura duhet veçuar: Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”(2013), PK “Sharri” (i zgjeruar), Ligatina e Hencit – Radevës etj., ndërsa shumicën e përbëjnë monumentet e natyrës me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik, etj.




Fig. 2. Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 - 2014



ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS

5 ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS

Aktualisht numri i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2014) është 116 dhe përfshijnë sipërfaqe prej 118.913,95 ha (10.9% e sipërfaqes të Kosovës). Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 11 Rezervate Strikte të Natyrës (“Bifurkacioni i lumit Nerodime”, “Rezervati i Arnenit”, “Maja e Ropsit”, “Rusenica”, “Kamilja”, etj), 2 Parqe Kombëtare (PK “Sharri”, PK “Bjeshkët e Nemuna”), 99 Monumente të Natyrës (“Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit”, “Shpella e Gadimës”, “Ujvarat e Mirushës”, “Gryka e Rugovës”, “Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë”, “Trungu i Rrapit në Marash” etj), 1 Park Regjional i Natyrës (“Gërmia”), 2 peizazhe të Mbrojtura (“Shkugëza” dhe “Pishat e Deçanit”) dhe 1 Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve (“Ligatina e Hencit-Radeves”).

Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Sharri”.

Tabela 3. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive

Kat. e IUCN-së	Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja/ha	Pjesëmarrja e ZM në %
I	Rezervatet Strikte të Natyrës	11	847	0.08
	RN. Bimore	7		
	RN. Shtazore	2		
	RN. Hidrologjik	1		
	RN. Gjeologjikë	1		
II	Parqet Kombëtar	2	115957	10.6
III	Monumentet Natyre	99	5972	0.5
	MN. Spelologjike	9		
	MN. Hidrologjike	17		
	MN. Gjeomorfologjike	7		
	MN. Botanike	66		
V	Park Regjional i Natyrës	1	1126	0.1
V	Peizazh i Mbrojtur	2	85	0.007
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve	1	109	0.009
	Totali	116	118913.95 ²	10.90 %

5.1. REZERVATET STRIKTE

Në Kosovë ekzistojnë 11 rezervate të natyrës me sipërfaqe të përgjithshme prej 847 ha ose 0.68 % e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës. Prej tyre 4 rezervateve gjenden në brendësi të Parkut Kombëtar “Sharri” (Maja e Arnenit, Rusenica, Pisha e Madhe dhe Oshlaku), 4 gjenden në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” (Kozhnjeri, Gubavci, Malet e Prilepit dhe Maja e Ropsit) si dhe 3 rezervate tjera (Bifurkacioni i lumit Nerodime, kodrina e Kamiljes dhe Gazimestani).

Sqarim: kjo sipërfaqe e zonave të mbrojtura nuk përfshinë zonat e mbrojtura që gjenden në kuadër të Parqeve Kombëtare “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”

5.1.1. Maja e Arnenit

Zona e Rrobullit është e pasur me pyje të llojit endemo - relikto të rrobullit (*Pinus heldreichii*), i cili në shpatinat jugore gëlqerore të Oshlakut formon bashkësinë *Seslerio-Pinetum heldreichii*, ndërsa në shpatijet jug-lindore, që kanë më shumë lagështi, formon bashkësinë *Luzulo maximae - Pinetum heldreichii*. Këto bashkësi shtrihen deri në lartësinë mbidetare prej 1.946 m. Një pjesë e këtyre pyjeve me sipërfaqe prej 30 ha, në vitin 1960 është shpallur si rezervat strikt i natyrës. Në pjesën lindore të zonës, nën pyjet e rrobullit, gjendet bashkësia pyjore e ahut *Fagetum montanum*.

Zona e pyjeve të rrobullit e propozuar si zonë e I e mbrojtjes (rezervat strikt të natyrës) është e pasur me bimë endemike, nga të cilat veçohen: bar peshku i sharrit (*Vrbascum scardicum - st. end.*), Gencianëza bullgare (*Gentianella bulgarica var. Albanica*), Karafil i kartusianve (*Dianthus cartusianarum*), Karafil shkëmbinjsht (*Dianthus integer*), Lulekambane shqiptare (*Campanula albanica*), Lisra shqiptare (*Thymus albanus*) etj.



Foto 1. Maja e Arnenit, bashkësitë pyjore të rrobullit dhe ahut

5.1.2. Rusenica

Rusenica është vendbanim i rrëqebullit ballkanik (*Lynx lynx balcanicus*), i cili është lloj i rrallë dhe i rrezikuar. Gjendet në brendi të Parkut Kombëtar “Sharri”, në Komunën e Suharekës, dhe është Rezervat i Mbrojtur i Natyrës me sipërfaqe të mbrojtur 300 ha. Rezervati është shpallë në vitin 1955, me qëllim të mbrojtjes së vendbanimit të rrëqebullit.

Rusenica karakterizohet me shkëmbinjtë gëlqerore dhe dy bashkësi pyjore: pyjet e ahut dhe bredhit (*Abieti-Fagetum*) dhe pyjet e ulëta të mëllezës dhe frashrit të zi (*Orno-Ostryio carpinetum*). Ky lokacion është i rëndësishëm edhe nga aspekti floristik, ku nga llojet e tjera bimore duhet veçuar praninë e llojeve endemike: burnumullera (*Burnmullera dieckii*), panja e maleve (*Acer heldreichii*), etj.




Foto 2. Gryka e Rusenicës

5.1.3. Pisha e Madhe

Pisha e Madhe karakterizohet me pyjet e vjetra të rrobullit të bashkësisë *Seslerio-Pinetum heldreichii*, të cilat paraqesin kompleksin më të bukur dhe më interesant të pyjeve të rrobullit në Ballkan. Një pjesë e këtyre pyjeve në sipërfaqe prej 35 ha, në vitin 1960 është shpallur si rezervat strikt i natyrës.

Zona është e pasur me lloje të shumta të florës të cilat kryesisht janë kozmopolite (kanë përhapje të gjerë në PK). Vlerë të veçantë kanë lloji endemik *Sedum flexiosum* si dhe llojet me karakter mjekues, siç janë: Badhra e bardhë (*Asphodelus albus*), Ushojza pa kërcell (*Carlina acaulis*), Genciana e kryqëzuar (*Gentiana cruciata*), Bari i ethes (*Centaurium erytrea*) etj.

Pisha e Madhe paraqet habitat edhe për lloje të shumta të kafshëve të egra, ndërsa më të rëndësishme janë: Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Macja e egër (*Felis sylvestris*), Vjedulla (*Meles meles*), Fishnjari (*Martes foina*), Skifteri malor (*Falco biarmicus*), Shqiponja minjngrënëse (*Buteo buteo*), etj.



Foto 3. Pisha e Madhe: Ekosistemet pyjore te rrobullit

5.1.4. Oshlaku

Ky rezervat karakterizohet me vlera të veçanta floristike, faunistike, fitocenologjike dhe gjeomorfologjike. Në kuadër të biodiversitetit të pasur të florës veçohen lloje të shumta endemo - relikte dhe fitocenoza të rralla të tyre.

Nga llojet drunore, përveç rrobullit, dredhakut dhe hormoqit të pranishme janë: bredhi (*Abies alba*), arneni (*Pinus peuce*), shelgu i egër (*Salix caprea*), etj. Simboli i veçantë i Oshlakut është lloji lokal endemik i vjetërsisë glaciale *Achillea alexandri regis*, ku me llojin tjetër endemik të Ballkanit qendror *Onobrychis scardica*, formon bashkësinë specifike *Achilleo alexandri regis - Onobrychis scardica*.

Nga llojet e tjera të shumta endemike, më të cilët është e pasur zona e Oshlakut veçohen: Heliantema e thinjur (*Helianthemum canum*), Karafili i sharrit (*Dianthus scardicus*), Karafili i gurit (*Dianthus integer*), Zambaku shqiptar (*Lilium albanicum*) etj. Zona është e pasur me lloje të shumta të shpendëve dhe gjitarëve: Pulegra e madhe (*Tetrao urogallus*), Thëllëza e gurit (*Alectoris graeca*), Pula e pyjeve (*Tetrastes bonasia*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), Ariu i murrme (*Ursus arctos*), etj.



Foto 4. Oshlaku (ekspozicioni jugor), habitat i rrobullit dhe dhive të egra

5.1.5. Kozhnjeri dhe Maja e Ropsit

Bjeshka e Kozhnjerit dhe Maja e Ropsit gjenden në perëndim të Deçanit. Sipërfaqja e Bjeshkës së Kozhnjerit është 150 ha ndërsa Maja e Ropsit është 20 ha. Këto zona janë shpallur si rezervate stritke të natyrës në vitin 1955. Lartësia mbidetare është prej 1.708 (Kozhnjeri) m deri 2501 m (Ropsi).





Foto 5 dhe 6. Kozhnjeri dhe Maja e Ropsit

Këto rezervate janë zona të maleve të larta në gëlqeror dhe serpentini që veçohet me ekosisteme të rralla barishtore dhe pyjore.

Bashkësitë bimë më të rëndësishme të zonës janë: Bashkësia e hormoqit (*Picea excelsa*), Bashkësia e hormoqit dhe arnenit (*Picea-Pinetum peucis*) dhe Bashkësia e arnenit (*Pinetum peucis*).

Pjesët më të larta të zonës janë të mbuluara me bashkësitë barishtore të pasura me bimë endemike. Llojet më të rëndësishme të kësaj zone janë: *Pinus peuce*, *Pinus heldreichii*, *Abies alba*, *Picea excelsa*, *Cerastium alpinum*, *Saxifraga stellaris*, *Saxifraga aizoides*, *Nartecium scardicum*, *Valeriana tripteris*, *Malva moschata*, *Cirsium candelabrum*, *Gnaphalium sylvaticum*, *Lychnis flos-cuculi*, *Lychnis coronaria*, *Tanacetum vulgare*, *Angelica pancicii*, *Acer intermedium*, *Achillea grandifolia*, *Saturea subspicata*, *Salix eleagnos* etj.

Pjesët më të larta shkëmbore të Maleve të Kozhnjerit paraqesin habitat të Dhisë së egër (*Rupicapra rupicapra*), ndërsa pyjet paraqesin habitat të ariut të murrmë (*Ursus arctos*), Kaprollit (*Capreolus capreolus*), Derrit të egër (*Sus scrofa*), Macës së egër (*Felis sylvestris*), Vjedullës (*Meles meles*), gjeli i egër (*Tetrao uragullus*), Thëllëza e malit (*Alectoris graeca*), Gjeraqina (*Accipiter gentilis*), Trofta e përrenjve (*Salmo trutta m. Fario*), Hardhuca (*Salamandra atra*) etj.

5.1.6. Gubavci

Gubavci gjendet në pjesën perëndimore të Pejës duke krijuar një pamje mjaft imponuese rrëzë Koprivnikut. Sipërfaqja e zonës është 38 ha e shpallur si rezervat strikt i natyrës në vitin 1959.

Vlerat më të rëndësishme të zonës paraqesin llojet disa endemike dhe endemorelikte me theks të veçantë lloji *Forsythia europaea*. Lloje tjera interesante janë edhe llojet: *Centaurea kosaninii*, *Fumana bonapartei* etj. Sipas literaturës përmendet edhe lloji stenoendemic *Rubus ipeccensis*.

5.1.7. Malet e Prilepit

Malet e Prilepit gjenden në veriperëndim të Deçanit. Sipërfaqja e zonës është 0.92 ha e shpallur si rezervat strikt i natyrës në vitin 1963.

Bjeshka e Prilepit është zonë e maleve të larta në gëlqeror me vlera të veçanta fitocenologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike dhe peizazhore. Karakteristika e zonës është biodiversiteti i theksuar i dendroflorës (llojeve drunore) midis të cilëve veçohen llojet endemike panja e heldrahit (*Acer heldreichii*) dhe arneni (*Pinus peuce*).

Zona është e dominuar me bashkësi pyjore dhe shkëmbinjtë gëlqerore në pjesët më të larta të zonës.

Nga llojet e tjera drunore veçohen: Pisha e bardhë (*Pinus silvestris*), Hormoqi (*Picea abies*), Bredhi (*Abies alba*), Panja malore (*Acer pseudoplatanus*), Panja gjetherrapi (*Acer platanoides*), Ahu (*Fagus moesiaca*), Mështekna (*Betula pendula*), Plepi i egër (*Populus tremula*), Shelgu i egër (*Salix caprea*) etj.

Llojet më të rëndësishme të faunës janë: Ariu i murrëm (*Ursus arctos*), Shqarshi (*Martes foina*), Vjedulla (*Meles meles*) etj. Nga llojet e ornitofaunës veçohen: Thëllëza e gurëve (*Alectoris graeca*), Pëllumbi i egër (*Columba oenas*), Korbi (*Corvus corax*), Qyqja (*Cuculus canorus*), Qukapiku i larmë malor (*Dryobates leucotos*), Lauresha e pyjeve (*Lullula arborea*) etj.



Foto 7. Malet e Prilepit

5.1.8. Bifurkacioni i lumit Nerodime

Bifurkacioni i lumit Nerodime paraqet një shembull të vetëm në Evropë të derdhjes së një lumi në dy dete. Lumi i Nerodimës buron në Bjeshkët e Jezercit; në afërsi të Ferizajt ndahet pakthyeshëm në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme. Dega veriore (dega e majtë) derdhet në lumin Sitnicë dhe vazhdon rrugëtimin në lumin Ibër, Moravë dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi, ndërsa dega jugore (dega e djathtë) përmes lumit Lepenc dhe Vardarit derdhet në Detin Egje. Ky kuriozitet natyror është mjaft tërheqës për shumë studiues (gjeograf, gjeolog, hidrolog, historian) etj., dhe ka rëndësi të madhe edukativo-arsimore, shkencore dhe turistike.

Bifurkacioni i lumit Nerodime nga viti 1979 është vënë nën mbrojtje ligjore si Rezervat special i natyrës. Sipërfaqja e mbrojtur është 12.78,71 ha. (vendimi nr: 633-1 datë 24 janar 1979, Ferizaj).

5.1.9. Kamilja

Është shpallur rezervat special i natyrës në vitin 1988 me sipërfaqe prej 228 ha. Kodra e gëlqerorëve të Kamilës, karakterizohet me vlera të veçanta natyrore të periudhës paleontologjike. Ky rezervat nuk është monitoruar nga Institucionet e Republikës së Kosovës.

5.1.10. Gazimestani

Zona e parë e shpallur e mbrojtur në vitin 1950, në kategorinë e Rezervatit bimor të bozhures (*Paonia decora Anders*). Sipas konstatimeve të viteve të fundit kjo zonë ka humbur vlerat natyrore për shkak të së cilave është shpallur e mbrojtur. Në procedurë është vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe shqyrtimi i masave për fshirjen e kësaj zone nga lista e objekteve të mbrojtura.

5.2. ZONAT E PROPOZUARA PËR REZERVATE

Me Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri” dhe të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” (në procedurë) janë propozuar edhe 25 zona të para të mbrojtjes që duhet të shpallen Rezervate Strikte të Natyrës. Prej tyre 11 në PK “Sharri” dhe 14 në PK “Bjeshkët e Nemuna”.

- Kopilicë, Dupnicë dhe Lumbardhë (komuna e Prizrenit);
- Bistra dhe Gryka (komuna e Shtërpçës);
- Pashallare dhe Lendina e Shenjtë (komuna e Suharekës);
- Luboteni (komuna e Kaçanikut);
- Shutmani, Bredhiku dhe Koritniku (komuna e Dragashit);
- Gjeravica dhe Rasa e Zogut (komuna e Junikut);
- Bjeshka e Kurvallës-Dervishkomit, , Bellaja-Bjeshka e Strelcit, Marjashi, Bjeshka e Prilepit dhe Bjeshkët e Lumbardhit (komuna e Deçanit);
- Gryka e Rugovës, Bjeshkët e Koprivnikut, Guri i Verdhë, Gryka e Sushicës, Burimi i Drinit të Bardhë, Rusolia dhe Zhlebi (komuna e Pejës);




Fig. 3. Harta e Rezervateve të Natyrës

Gjendja e rezervateve të natyrës

Ndikimet negative të faktorit antropogjen si: ndërtimet ilegale dhe ndërhyrjet pa kriter shkencor, prerjet e pakontrolluara por edhe faktorët tjerë jo antropogjen mbi rezervatet e natyrës në Kosovë si: sëmundjet, zjarret etj. janë ndesh direkt me qëllimet e mbrojtjes, legjisacionin në fuqi dhe normat ndërkombëtare. Ndikime të tilla dhe mungesa e përkujdesjes institucionale e shkencore janë duke bërë që këto rezervate t'i humbin përgjithmonë karakteristikat e tyre natyrore për të cilat janë vënë nën mbrojtje.

Një shembull i tillë është Bifurkacioni i lumit Nerodime i cili edhe më tutje nuk është funksional, si pasojë e pengesave të shumta në shtratin e lumit sidomos në degën e majtë e cila i shkarkon ujërat në rrjedhën e Sazlisë i cili derdhet në lumin e Sitnicës.

Gjatë vitit 2012 përmes një donacioni nga Bashkimi Evropian është investuar vetëm në një pjesë të vogël të shtratit të lumit në rregullimin e ujëndarësit të lumit Nerodime (në bifurkacion).

Po ashtu është konstatuar se në zonën mbrojtur pranë Bifurkacionit është ndërtuar një objekt hotelier. Ndërtimi i këtij objekti e ka ngulfatur hapësirën pranë ujëndarësit detar të Bifurkacionit.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës duke u bazuar në vizitat e vazhdueshme në terren, Ligjin për mbrojtjen e Natyrës (Neni 10 në të cilin përshkruhen kriteret për zonat strikte) dhe zhvillimet rreth Bifurkacionit të Lumit Nerodime ka konstatuar si në vijim :

- në rezervatin special të natyrës - Bifurkacioni i Lumit Nerodime ka ndërhyrje të shumta si në periferi ashtu edhe në vet fenomenin e bifurkacionit;
- intervenimi në Bifurkacionin e lumit Nerodime me projektin e financuar nga Bashkimi Evropian dhe komuna e Ferizajt i realizuar gjatë vitit 2012 nuk e ka zgjedhe problemin e funksionalizimit të bifurkacionit;



Foto 8 dhe 9. Intervenimet në Bifurkacionin e lumit Nerodime dhe në afërsi të tij

Vlerat natyrore në disa prej rezervateve janë të rrezikuara nga prania e shumtë e vizitorëve që e vizitojnë zonën (Prevalla, Bifurkacioni etj.). Gjendja më e vështirë paraqitet në pyjet e rrobullit në Majën e Arnenit dhe Oshlakut të cilët kanë pësuar dëme të konsiderueshme nga zjarret e viteve të mëhershme dhe zhvillimi i insekteve dëmtues nënlëvorësve (*Blastophagus sp.*, *Ips typographus*) që janë zhvilluar në mënyrë masive pas zjarreve. Nga ndikimi i këtyre faktorëve dëmtues janë tharë disa hektarë të këtyre pyjeve, ndërsa shumë trungje të tjera janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe imunitet dobësuar. Në drunjtë e bredhit janë identifikuar sëmundjet si tumori i lëvores (*Melampsorella caryophyllacearum*) që shfaqet në formë të

deformimeve të trungjeve dhe degëve dhe kërpudha e kalbjes (*Armilaria melea*). Në drurët e ahut paraqitet tumori i lëvores (*Necctria sp.*) dhe shkaktari i kalbjes (*Fomes fomentarius*).

Gjendja e përgjithshme e kafshëve të egra është e paqëndrueshme si pasojë e shqetësimeve të vazhdueshme nga ana e njeriut. Rrezik për kafshët paraqet edhe gjuetia ilegale, nga e cila, në veçanti, janë të rrezikuar kaprojtë dhe dhia e egër. Këto veprime ilegale shfaqen kryesisht gjatë ditëve të vikendit. Problemin më të madh e paraqet shfrytëzimi i gurit në rezervatin strikt të natyrës “Rusenica” që ka shkaktuar dëme të konsiderueshme ekologjike dhe peizazhore. Ndërhurjet e vazhdueshme në natyrën e mbrojtur të kësaj zone kanë sjellë si pasojë shqetësimin në masë të konsiderueshme të llojit të mbrojtur të rrëqebullit (*Lynx lynx*). Për të mbrojtur habitatin e këtij lloji të rrezikuar, nevojitet të ndërmerren masa për ndalimin e shfrytëzimit të gurit në këtë zonë dhe kthimin e ekosistemit në gjendjen e mëparshme.



Foto 10. Gurëthyesi në Grykën e Rusenices



Foto 11. Rezervati i Arnenit 2011

5.3. PARQET KOMBETARE

Parqet kombëtare janë tërësi hapësinore e cila veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera të ruajtura, me numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike dhe peizazhore që kanë rëndësi shkencore, edukativo - arsimore, kulturore – historike, rekreative - turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kriterëve mjedisore.

5.3.1. Parku Kombëtar “Sharri”

Sharri radhitet ndër malet më atraktive dhe më të rëndësishme në Ballkan dhe Evropë. Shumica e territorit të malit Sharr, që shtrihet në Republikën e Kosovës dhe maleve që e rrethojnë Sharrin në dhjetor të vitit 2012 janë përfshirë në kuadër të zgjerimit të Parkut Kombëtar (Ligji për PK “Sharri” nr 04/L-087) me sipërfaqe prej 53.469 ha. Një pjesë e këtij territori me sipërfaqe prej 39.000 ha nga viti 1986 e ka pasur statusin e Parkut Kombëtar në bazë të Ligjit për Parkun Nacional “Mali Sharr” nr. 11/86. PK “Sharri” gjendet në pjesën jugore të Republikës së Kosovës dhe shtrihet në territorin e pesë komunave: Dragash (45.1%), Shtërpçë (23.9%), Prizren (22.2%), Suharekë (4.7%) dhe Kaçanik (4.1%). Kufiri jugor i PK përputhet me kufirin shtetëror të Republikës së Kosovës me IRJ të Maqedonisë dhe Shqipërinë që kalon nëpër majat më të larta të Sharrit, shume prej të cilëve janë mbi 2500 m të lartësisë mbidetare: Çuka e Liqenit (2604 m), Bistra (2651 m), Maja e Zezë (2584 m), Kobilica (2526 m), Vrtopi (2555 m), Vraca e Madhe (2582 m), Rudoka (2658 m) etj.



Foto 12. Peizazh nga Malet e Sharrit

PK “Sharri” karakterizohet me bukuri dhe vlera të veçanta natyrore (biologjike, biogeografike, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, klimatike dhe peizazhore) që kanë rëndësi të posaçme shkencore, edukative-arsimore, kulturore-historike, rekreative-turistike dhe estetike.

Në strukturën e vegjetacionit dominojnë sipërfaqet barishtore (kullosat) që e mbulojnë rreth 58 % (30,904.85 ha) të territorit të PK “Sharri”, ndërsa vegjetacionit pyjor i mbulon afro 35 % (18,298.82 ha) të sipërfaqes. Pjesa më e madhe e kullosave shtrihet në komunën e Dragashit të cilët paraqesin sipërfaqen më të madhe të kullosave të maleve të larta në Evropë. Përveç vegjetacioneve barishtore dhe pyjore në strukturën e sipërfaqes së PK “Sharri” sipas përdorimit të tokave marrin pjesë: shkurret tranzitore - 2.65% (1,419.15 ha), sipërfaqet ujore - 2.74% (1,467.64 ha), sipërfaqet urbane - 0.04% (23.21 ha) dhe sipërfaqet e zhveshura – 2.53% (1,355.33 ha).¹²

Sharri radhitet ndër gjashtë zonat (qendrat) me biodiversitetit më të pasur në Evropë¹³. Pjesë e këtij biodiversiteti të pasur janë:

- mbi 2000 lloje të bimëve (afro 400 bimë endemike, 20 lloje stenoendemike, mbi 250 bimë mjekësore, afro 160 lloje drunore),
- mbi 180 bashkësi (asociacione) bimore,
- 32 lloje të gjitarëve (pa lakuriqët),
- 19 lloje të rrëshqitësve,
- 12 lloje të ujëtokësorëve,
- 200 lloje të shpendëve,
- 147 lloje të fluturave ditore etj.

¹² Draft Plani Menaxhues i PK “Sharri” 2015

¹³ WCMC, 1989

Rëndësi të veçantë ka biodiversiteti i pasur endemik i florës dhe faunës që Sharrin e bënë qendër specifike të endemizmit të maleve të larta në Ballkan dhe Evropë.

Gjendja e resurseve natyrore në Parkun Kombëtar “Sharri” është e paqëndrueshme si pasojë e ndikimeve negative të faktorëve biotik (njeriu, insektet, sëmundjet) dhe abiotik (zjarret, fatkeqësitë natyrore: era, bora etj.). Gjatë viteve të fundit në paqëndrueshmërinë e gjendjes së resurseve natyrore, në veçanti të ekosistemeve pyjore kanë ndikuar zvogëlimi i reshjeve vjetore, në veçanti të dëborës dhe temperaturat e larta gjatë verës.




Fig. 4. Harta e zonimit të PK “Sharri”

Gjendja e ekosistemeve pyjore

Gjendja e pyjeve në PK “Sharri” është e vështirësuar si pasojë e ndikimeve negative të faktorëve biotik dhe abiotik. Këta faktor kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të pyjeve dhe paraqitjen e dëmeve pyjore që rrezikojnë qëndrueshmërinë biologjike të ekosistemeve pyjore.

Më të rrezikuara janë pyjet e rrobullit (*Pinetum heldreichii*) të cilët kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme nga zjarret pyjore (2000, 2007 dhe 2012) dhe zhvillimi i madh i insekteve dëmtues, nënllivorëve (*Ips. sp.* dhe *Blatophagus sp.*) që është pasojë e dobësisit të imunitetit të drunjëve të dëmtuara. Dëmet më të mëdha janë paraqitur në pyjet e rrobullit në malin Koritnik ku në vitin 2012 janë djegur afro 600 ha të këtyre pyjeve që kanë qenë nën menaxhimin e APK-së. Pasojat e zjarreve në formë të tharjes së drunjëve janë të pranishme edhe në pyjet e rrobullit në zonat Pisha e Madhe dhe Prevalla.

Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të pyjeve të rrobullit gjatë viteve të fundit vërehet në rajonin e Prevallës si rezultat i ndërmarrjes së pastrimeve sanitare të drunjve të thara dhe infektuara nga sëmundjet dhe insektet në zonën e dytë të mbrojtjes. Në pjesët më të dëmtuara të pyjeve të rrobullit ka filluar zhvillimi i llojeve pionere drunore: shelgu i egër

(*Salix caprea*), mëshstekna (*Betula pendula*) dhe plepi i egër (*Populus tremula*). Nga llojet barishtore veçohet zhvillimi i madh i epilobit gjethengushtë (*Epilobium angustifolium*) i cili e pengon ripërtëritjen natyrore të rrobullit. Pyjet e rrobullit janë vazhdimisht të rrezikuara nga zjarret që shkaktohen 100% nga faktori antropogjen (njeriu).



Foto 13: Pasojat e nënlëvorsëve në trung



Foto 14. Koritniku: Pasojat e zjarrit në pyjet e rrobullit

Në pyjet e pastra të bredhit (*Abietum albae*) dhe hormoqit (*Picetum excelsae*) dëmet janë të intensitetit më të vogël dhe kanë kryesisht karakter sporadik. Dëmtuesit më të rëndësishëm që janë konstatuar në pyjet e bredhit janë:

- Kërpudha - shkaktar i tumorit të lëvres dhe deformimeve të degëve (*Melampsorella caryophyllacearum* Schröt.);
- Kërpudha - shkaktar i kalbjes së rrënjëve dhe trungut (*Heterobasidion annosum* Bref.);
- Kërpudha - shkaktar i kalbjes së rrënjëve, trungut dhe tharjes (*Armillaria mellea* Staude);
- Nënllivorësi i bredhit (*Ips curvidens* Germ.) etj.

Nga faktorët e dëmshëm biotik që paraqitën te hormoqi veçohen:

- Kërpudha - shkaktar i kalbjes së rrënjës dhe trungut (*Heterobasidion annosum* Bref.);
- Insekti dëmtues Hermes (*Cheremes Abietis* L.);
- Nënllivorësi i hormoqit (*Ips typographus* L.) etj.

Pyjet e ahut kanë përhapje më të madhe në PK "Sharri". Dëmet më të theksuara pyjore shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore (era dhe dëbora), që shfaqen në formë të thyerjeve dhe shkuljeve (rrëzimit) të trungjeve dhe prerjet ilegale të pyjeve. Kjo dukuri negative, në veçanti, është e pranishme në rajonet e fshatrave Delloc dhe Maçitevë të komunës së Suharekës, Manastiricë dhe Koritniku 1 të komunës së Prizrenit dhe në rajonet e ndryshme të komunës së Shtërpçës që kanë mbetur jashtë qeverisjes së MMPH-së (DAPK-së). Zonat e PK që shtrihen në komunën e Shtërpçës që nga pas lufta e vitit 1999, janë duke u menaxhuar nga institucionet ilegale paralele serbe ndërsa në komunën e Kaçanikut menaxhimi bëhet përmes Njesisë Pyjore Komunale, në kuadër të AKP-s. Shkaku kryesor i paraqitjes së prerjeve ilegale të pyjeve është gjendja e vështirë socio-ekonomike e popullatës rurale e cila drurin e ahut e përdor si burim kryesor për ngrohje dhe mosrealizimi i fletpadive të DAPK "Sharri" në gjykatat përkatëse.



Foto 15 dhe 16 Shkatërrimi i pyjeve nga faktorët natyrore (Lubinje)



Foto 17. Prerjet ilegale të pyjeve në Park

Dëmet pyjore në pyjet ahut nga insektet dëmtues dhe fitopatogjenet (sëmundjet) janë të intensitetit të vogël dhe nuk kanë rëndësi të veçantë ekologjike dhe ekonomike. Sëmundjet më të rëndësishme që shkaktohen nga kërpudhat në drunjtë e vjetërsuara dhe të dëmtuara janë:

- Kërpudha - shkaktar i tumorit të lëvores (*Nectria ditissima* Tul.) ;
- Kërpudha - shkaktar i kalbjes (*Fomes fomentarius* Gill.).

Gjendja shëndetësore e pyjeve të përziera të ahut me halorët (bredhin, hormoqin, rrobullin dhe arnenin) është e mirë dhe stabile. Këto pyje kanë zhvillim të qëndrueshëm dhe tregojnë rezistencë të mirë ndaj ndikimeve negative të faktorëve biotik dhe abiotik. Ndikimi i këtyre

faktorëve, në veçanti të insekteve dëmtues dhe sëmundjeve, është më i theksuar në pyjet e pastra pasi që ato zakonisht i atakojnë llojet e caktuara drunore, ndërsa në pyjet e përziera zhvillimi dhe përhapja e tyre është e kufizuar për shkak të shumëllojshmërisë e drunjve.



Foto 18. Tumori i lëvores (*Nectria ditissima*)



Foto 19. Kërpudha e kalbjes (*Fomes fomentarius*)

Pyjet e arnenit (*Pinetum peucis*), së bashku me pyjet e rrobullit, për shkak të karakterit endemorelikt paraqesin pyjet më të rëndësishme të PK “Sharri”. Këto pyje kanë përhapje të kufizuar, ndërsa sipërfaqet më të mëdha gjenden në zonat e Ujërave të Humbur dhe Përroska e Durlës. Pyjet e arnenit janë në gjendje të mirë dhe në masë të madhe e kanë të ruajtur vlerën natyrore burimore.



Foto 20. Pyjet e arnenit - Ujërat e humbur

Përveç dëmtuesve të lartcekur, në pyjet e PK “Sharri”, respektivisht në llojet e tjera drunore, janë identifikuar shumë dëmtues që kanë karakter sekondar dhe përhapje të kufizuar, siç janë:

- Insekti dëmtues i pishës (*Thaumatopoea pityocampa*);
- Kërpudha - shkaktar e tumorit të lëvores së shkozës (*Taphrina carpini* Rostr.);
- Kërpudha - shkaktar i deformimeve të gjetheve të vidhit (*Taphrina ulmi* Fck.);
- Kloroza virusale unazore dhe difuze në gjethet e panjës malore etj.

Ripërtëritja natyrore e pyjeve është relativisht e mirë. Ripërtëritja e pamjaftueshme paraqitet në disa zona të pyjeve të ahut për shkak të kurorodendësisë së madhe dhe shtresës së trashë të lëgushës (stelës) pyjore e cila e pengon mbirjen e farave të ahut dhe zhvillimin e filizërisë. Në pyjet e rrobullit ripërtëritja është e vështirësuar si pasojë e dëmtimit të pyjeve nga zjarret dhe zhvillimit të vegjetacionit të dendur barishtor. Ripërtëritje më të mirë kanë bredhi në zonat e Maleve të Mushtishtit dhe Koxha Ballkanit dhe arneni në zonat e Pashallarës dhe Ujërave të Humbur që ka ndikuar në përhapjen e pyjeve të këtyre llojeve në PK “Sharri”. Në zhvillimin e mirë të bredhit dhe arnenit kanë ndikuar kushtet e volitshme natyrore dhe mosshfrytëzimi i kullosave malore për shkak të zvogëlimit të bagëtive në zonat rurale.

Në PK “Sharri” nuk ka shfrytëzim ekonomik të pyjeve. Aplikohen vetëm masat (pastrimet) e kufizuara sanitare me qëllim të mbrojtjes, ruajtjes dhe mirëmbajtjes së ekosistemeve pyjore në bazë të planeve dhe legjislacionit përkatës për menaxhimin e parqeve kombëtare. Pastrimet sanitare janë aplikuar në pyjet e dëmtuara të ahut dhe rrobullit që ka ndikuar në evitimin e infektimit dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të pyjeve.

Gjatë vitit 2012 në Regjionin e Prizrenit, në Malin Koretnik ka pasur vatra të zjarreve me intensitet të ulët ku janë përfshirë 1.5 ha zjarr i cili është vënë nën kontroll dhe shuar nga zyrtarët e Pylltarisë.

Dukuria e shfaqjes së zjarreve ka ardhur duke u intensifikuar sidomos gjatë muajit Gusht saktësisht me datë 22.08.2012 dhe është lokalizuar dhe vënë nën kontroll me datë 28.08.2012 ku janë përfshirë sipërfaqe më të mëdha por edhe më kualitative të pyjeve me kulturë halorë.



Foto 21 dhe 22. Zjarret në PK “Sharri”

Gjendja e ekosistemeve të shkurreve dhe ekosistemeve barishtore

Vegjetacioni më i përhapur i shkurreve në PK “Sharri” është i dredhakut (*Pinus mugo*) që shtrihet në ekspozicionet veriore të maleve Oshlak, Koxha Ballkan dhe Pashallarë. Gjendja e këtij vegjetacioni në përgjithësi është e mirë, por rrezikun permanent e paraqesin zjarret gjatë verës, nga të cilët në vitet 2011 dhe 2012 janë dëmtuar afro 10 ha të vegjetacionit të dredhakut. Në zonat ku mungon dredhaku, zhvillohen vegjetacionet të shkurreve të dëllinjës siberike (*Juniperus nana*), boronicës (*Vaccinium myrtillus*) etj. Gjatë verës mblidhen frutat e boronicës në gjithë territorin e PK “Sharri” nga banorët lokal dhe vizitorët. Për shfrytëzimin e qëndrueshëm të frutave pyjore dhe bimëve janë duke u përgatitur aktet e nevojshme ligjore dhe planifikuese.

Vegjetacioni barishtor shtrihet kryesisht mbi vegjetacionin pyjor, ndërsa në komunën e Dragashit, duke filluar nga zona e Gurit të Zi deri të fshati Krushevë (përgjatë kufirit shtetëror me Maqedoninë dhe Shqipërinë) tërësisht e mbulon territorin e PK “Sharri”.

Gjendja e vegjetacionit barishtor është e mirë, ndërsa në disa zona, në veçanti në komunën e Dragashit, gjatë sezonës verore shfrytëzohet për kullotje të bagëtive të imëta (deleve) nga blegtorët lokal dhe të regjionit të Prizrenit. DAPK “Sharri” është e përkushtuar në vetëdijesimin e blegtorëve për shfrytëzimin e qëndrueshëm të kullosave pasi që paraqiten rastet e ndezjes së kullosave nga blegtorët e pandërgjegjshëm.

Vegjetacionet barishtore të maleve të larta janë të pasura me lloje të shumta endemike të cilët janë në gjendje të mirë. Për të siguruar qëndrueshmërinë e këtyre bimëve të rralla, lokacionet që janë më të pasura me bimët endemike, janë përcaktuar si zona të para të mbrojtjes në Planin Hapësinor të PK “Sharri”. Disa lloje të rralla të bimëve mjekuese janë objekt i shfrytëzimit ilegal. Bima më e rrezikuar është sanëza (*Gentiana lutea*) e cila mblidhet nga banorët lokal dhe vizitorët që e përdorin për tregti (përfitime personale) pa si që ajo ka vlera të veçanta mjekuese. Sanëza gjendet në pjesët më të larta (mbi 1800 m) të territorit të PK, ndërsa si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar në të kaluarën mbijetesa e saj është mjaftë e rrezikuar.



Foto 23. Sharr (Vraca), Vegjetacioni barishtor (kullosat) në vjeshtë

Gjendja e resurseve ujore

PK “Sharri” është i pasur me burime të shumta të ujit, prrocka, lumej dhe liqej që këtij Parku i japin vlerë të jashtëzakonshme natyrore. Prrocakt dhe lumejtë që karakterizohen me rrjedhje të rrëmbueshme dhe ujëvara të shumta, paraqesin habitat i troftës së prrockave. Lumenjtë më të rëndësishëm janë Lepenci, Lumbardhi, Lumi i Pllavës, Lumi i Brodit, Lumi i Restelicës dhe Radika që i takojnë dy pëlqjeve, Egjej dhe Adriatiku. Në PK veçohen liqenet e Livadhit, Jazhincës, Katundit të Epërm dhe Shutmanit që gjenden në lartësinë mbidetare mbi 2000 m. Shumë prej burimeve të ujit në të kaluarën janë dhënë në shfrytëzim fshatrave lokale për t'i plotësuar nevojat për ujë të pijshëm. Janë paraqitur edhe rastet e uzurpimit të burimeve të ujit në zonën e Prevallës (2012) nga disa pronarë të vikendshtëpizave dhe në Pashallare (2013) nga një banorë i Mushtishtit. Ndaj uzurpuesve janë inicuar masat ligjore në organet e drejtësisë. Ndotje të ujërave nuk ka, por në zonat e caktuara të ujërrjedhjeve të cilët vizitohen nga qytetarët paraqitën mbeturinat e llojeve të ndryshme. Kjo çështje mund të rregullohet me menaxhimin institucional të mbeturinave në territorin e PK. Gjatë vitit 2014 të gjitha tentimet për uzurpimin e burimeve ujore janë evituar nga DAPK “Sharri”, por parashtrohet nevoja e kthimit të gjendjes së mëparshme natyrore të burimeve të uzurpuara gjatë viteve të mëherëshme. Mungesa e të reshurave dhe temperaturat e larta gjatë disa viteve të fundit kanë ndikuar në zvoglimin e sasisë së burimeve të ujit.



Foto 24. Lumi i Brezovicës



Foto 25. Liqeni i Livadhishtës

Gjendja e zonave turistike

Në PK “Sharri” gjenden 9 zona turistike të propozuara në Planin Hapësinor të PK “Sharri” (2013): Brezovica, Prevalla, Guri i Zi (Zapluzhe), Ujërat e Gropuar, Gradanci, Guri i Delocit, Luboteni, Brodi dhe Restelica. Më të rëndësishme dhe më të frekuentuara nga vizitorët janë Brezovica dhe Prevalla. Turizmi deri më tani ka qenë i paorganizuar, por kjo çështje duhet të rregullohet me aprovimin e Planit Hapësinor të PK “Sharri” dhe hartimin e planeve rregulluese për zonat turistike.

Problemin më të madh në zonat turistike paraqesin ndërtimet ilegale. MMPH gjatë vitit 2013 dhe 2014 ka ndërmarrë masa të rëndësishme në parandalimin e ndërtimeve ilegale dhe rregullimin e zonës turistike të Prevallës. Janë rrënuar shtëpitë pa leje dhe kampingu veror dhe është kthyer gjendja e mëparshme e natyrës. Dukuri negative në zonat turistike paraqesin mbeturinat që krijohen nga vizitorët. Kjo çështje duhet të rregullohet me menaxhimin e mirëfilltë institucional të mbeturinave në gjitha zonat turistike.



Foto 26 dhe 27. Prevalla, zona e kampingut veror para rrënimit (2011) dhe pas rrënimit (2013)

Sfidat dhe problemet në menaxhimin e PK “Sharri”

PK “Sharri” është duke u ballafaquar me sfida dhe probleme të shumta, nga të cilët veçohen:

- Rreziku permanent për resurset natyrore nga ndikimet negative të faktorëve biotik (njeriu, insektet dëmtues dhe fitopatogjenet) dhe abiotik (zjarret, fatkeqësitë natyrore: era, bora etj.). Dëmet më të mëdha shkaktohen nga faktori antropogjen (njeriu) përmes veprimeve të ndryshme ilegale: prerjet e pyjeve, gjuetia, ndërtimet, ndezja e zjarreve etj.
- Mungesa e shenjëzimit të kufirit të jashtëm dhe të brendshëm (zonës së parë, të dytë dhe të tretë) të PK;
- Mungesa e punëtorëve të mjaftueshëm për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore. Në vitin 2013 me Ligjin e ri të PK “Sharri” nr. 04/L - 087 është dyfishuar sipërfaqe e territorit të PK nga 22 660 ha në 53 469 ha, por nuk është shtuar (punësuar) asnjë punëtorë në Drejtorin për Administrimin e PK “Sharri” në 3 komunat: Dragash, Shtërpçë dhe Kaçanik. Kjo gjendje e ka vështirësuar mbrojtjen dhe menaxhimin e resurseve natyrore në gjithë territorin e PK “Sharri”;
- Buxheti i pamjaftueshëm për menaxhimin e qëndrueshëm të PK “Sharri”. Kjo gjendje reflektohet në mungesën e investimeve në mbrojtjen dhe zhvillimin e PK “Sharri”. Përmirësimi i gjendjes financiare të PK “Sharri” është i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik të Kosovës;
- Mosrealizimi i fletëpadive penale dhe kundërvajtëse për vepra ilegale në Gjykatat përkatëse. Shqyrtimi fletëpadive vonohet dhe në shumë raste janë në favor të shkelësve të dispozitave ligjore. Në këtë mënyrë dëmtuesit të natyrës stimulohen, ndërsa PK “Sharri” është duke pësuar dëme të konsiderueshme ekologjike dhe ekonomike;
- Tentimet për zhvillimin e turizmit në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së vlerave natyrore;

Strategjia dhe masat zhvillimore të PK “Sharri”

Me aprovimin e Planit Hapësinor është krijuar baza strategjike planifikuese për menaxhimin e këtij Parku. Nga masat që duhet të ndërmerren për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm (mbrojtje dhe zhvillim) të PK “Sharri” veçohen:

- Kompletimi i infrastrukturës ligjore, organizative, financiare dhe planifikuese për menaxhimin e PK “Sharri” në përputhje me vendet e Bashkimit Evropian;

- Shtrirja e autoritetit menaxhues të Drejtorisë në tërë territorin e PK “Sharri” sipas Ligjit.
- Transformimi i pronave shoqërore të ish ndërmarrjeve shoqërore bujqësore (kooperativave) dhe pyjore (ekonomive pyjore) në pronësi të PK “Sharri”;
- Aplikimi i masave dhe teknikave bashkëkohore për mbrojtjen dhe zhvillimin e resurseve natyrore.
- Zhvillimi i turizmit në përputhje me mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore të Parkut Kombëtar;
- Transformimi i DAPK “Sharri” në Agjencion shtetëror ose Ndërmarrje publike;
- Anëtarësimi në Federatën e Parqeve Kombëtare të Evropës, UNESCO dhe në institucionet tjera ndërkombëtare.

5.3.2. Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

“Bjeshkët e Nemuna” për nga përbërja gjeologjike, gjeomorfologjike, floristike dhe faunistike paraqesin masivin më të rëndësishëm dhe më interesant jo vetëm të Kosovës, por edhe të tërë Gadishullit Ballkanik. Ashpërsia e terrenit dhe natyra e bukur ka zgjuar kureshtjen e shume hulumtuesve shkencor vendor dhe të huaj nga fushat e ndryshme. Bjeshkët e Nemuna përbën pjesën periferike perëndimore të Kosovës, zbret gati vertikalisht dhe përfundon në lindje dhe verilindje në fund të Rrafshit të Dukagjinit dhe në luginë të Ibrit, kurse në perëndim e mbyllin malet (kufiri) me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Bjeshkët e Nemuna në Kosovë kanë një shtrirje në drejtim veri-jug me gjatësinë afro 50 km, ndërsa gjerësia e tyre nuk e kalon 26 km. Ato prehen nga luginat e thella e tërthore, shpesh në formë kanionike si në rastin e Lumbardhit (Bistricës) të Pejës, Deçanit dhe Erenikut.




Foto.28. Peizazh nga PK. “Bjeshkët e Nemuna”

Ky masiv malor në janar të vitit 2013 është shpallur Park Kombëtarë (Ligji për Parkun Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna” Nr. 04/L – 086, GZRK / Nr. 2/21) dhe me të administron Drejtoria e PK “Bjeshkët e Nemuna” me seli në Pejë.

Parkut Kombëtar shtrihet në territorin 5 Komuna: Pejë me 32.311 ha ose 52 %, Deçan 16.881 ha ose 27 %, Istog 4973 ha ose 8 %, Juniku 5.300 ha ose 8% dhe Gjakovë 3032 ha ose 5 % dhe përfshinë sipërfaqen prej 62.488 ha ose 5.7 % të sipërfaqes së Kosovës.

Bjeshkët e Nemuna janë ndër masivet malore më karakteristike të Ballkanit për sa i përket llojllojshmërisë floristike dhe vegjetative. Në këtë aspekt Bjeshkët e Nemuna paraqesin masivin malor ndër më të begatshmit në Ballkan me prani të mbi 1.000 llojeve deri më tani të hulumtuara, edhe pse ky numër nuk është definitiv meqenëse hulumtimet duhet vazhduar edhe më tej. Pos kësaj, në këtë numër nuk janë të përfshira hulumtimet për myshqet, likenet dhe kërpudhat.




Fig. 5. Sipërfaqja e PK Bjeshkët e Nemuna sipas komunave- pjesëmarrja

Vegjetacioni i Bjeshkëve të Nemuna ka pësuar ndryshime gjatë procesit të gjatë të zhvillimit historik të tij. Të gjitha llojet bimore të cilat e mbijetuan periudhën e akullnajave së bashku me lloje të reja të krijuara pas diluviumit, sot ndërtojnë bashkësi bimore (fitocenoza) të ndryshme ku disa prej tyre janë karakteristike për Bjeshkët e Nemuna.

Në kuadër të Bjeshkëve të Nemuna deri më tani janë konstatuar këto asociacione:

1. Ass. *Abieti – Fagetum moesiaca*,
2. Ass. *Fagetum subalpinum scardo – pindicum*,
3. Ass. *Picetum abietis bertisicum montanum*,
4. Ass. *Picetum abietis bertisicum subalpinum*,
5. Ass. *Wulfenio – Pinetum peucis*,
6. Ass. *Pinetum peucis typicum*,
7. Ass. *Pinetum heldreichii bertisicum*,
8. Ass. *Wulfenio – Pinetum mugo*,
9. Ass. *Bruckenthalio – Juniperetum*,
10. Ass. *Nardetum subalpinum montenegrinum*,
11. Ass. *Salicetum herbaceae balcanicum*,
12. Ass. *Pinguiculo – Narthecium scardici*,
13. Ass. *Carici Crepidetum dinaricae*,
14. Ass. *Festucetum albanicae* dhe
15. Ass. *Senecio – Rumicetum alpini*.

Sipas të dhënave të deritanishme në Bjeshkët e Nemuna janë të pranishme 33 lloje endemike dhe 6 subendemike si dhe mjaft lloje relikte të cilat patjetër duhet të merren nën mbrojtje rigoroze duke pasur parasysh vlerat e tyre shkencore dhe ekonomike.

Në kuadër të llojeve endemike duhet të përmendet se në Bjeshkët e Nemuna vetëm në zonën alpike dhe subalpike janë prezentë 128 lloje endemike të Ballkanit. Ndër llojet endemike të Kosovës në Bjeshkët e Nemuna janë edhe *Sempervivum kosaninii* (burgulli i Koshaninit), *Cephalaria pastricensis* (Cefalaria e Pashtrikut), *Astragalus fialae* (Arrithja e Fialit), *Aconitum*

pentheri (Akoniti i Rusolisë), *Rubus ipecensis* (Manaferra e Pejës), *Saxifraga scardica* (Iriqëza e Sharrit), *Wulfenia bleicii* (Vulfenia e Bleçiqit); *Centaurea nervosa* (Kokoçeli), *Thlaspi cuneifolium* (Tlaspi), *Thymus rohlenae* (Listra e Rohleries) etj. Nga llojet relikte të përhapura në Bjeshkët e Nemuna karakteristike janë: *Carpinus orientalis* (shkoza e zezë) e përhapur në kuadër të pyjeve të dushkut dhe ahut. Në Grykën e Rugovës gjenden në ekspozicionin verior, ndërsa në Malin e Thatë, Bjeshkët e Sinajit dhe Lebeniq në ekspozicionin jugor. Në afërsi të Bistricës së Lloçanit së bashku me te paraqitet edhe *Carpinus betulus* (shkoza e bardhë) i cili po ashtu është relik i terciarit. Pos llojeve endemike autoktone në Bjeshkët e Nemuna janë të pranishme edhe shumë lloje endemike të Ballkanit ndër të cilat edhe *Crepis albanica* (Shmanga shqiptare), *Draba korabensis* (Draba e Korabit), *Cerastium dinaricum* (Cerasti dinarik), *Sempervivum macedonicum* (Burgulli maqedonas), *Euphorbia montenegrina* (Qumështorja malazeze) etj.

Masivi i Bjeshkëve të Nemuna karakterizohet me një faunë mjaftë të pasur, heterogjene, endemike dhe interesante. Kjo pasuri faunistike e Kosovës e me të edhe e Bjeshkëve të Nemuna, si masivi më i madh në Ballkan, është si rezultat i ndikimeve të shumta të regjionit mesdhetar, eurosiberian dhe atij nordiko-alpin, si dhe ndryshimeve të shpeshta të kushteve ekologjike në të kaluarën.

Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe në bazë të shënimeve të literaturës fauna e Bjeshkëve të Nemuna përbëhet prej: 8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtokësorësh, 10 lloje zvarranikësh, 178 lloje shpendësh, 37 lloje gjitarësh dhe 129 lloje flutura vetëm nga rendi Lepidoptera.

Llojet më reprezentative të faunës së Kosovës që jetojnë në territorin e Bjeshkëve të Nemuna janë: Rrëqebulli (*Lynx lynx*), Ariu i murrëm (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), Shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*), Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), Faikoi thonjëbardhë (*Falco naummani*), Pulëegra (*Tetrao urogallus*) etj, të cilat kanë status kombëtar dhe ndërkombëtar të mbrojtur.



Foto 29. Kaprolli (*Capreolus capreolus*)




Foto 30. Ariu i murrëm (*Ursus arctos*) (Foto APK)

Gjendja në Park

Një ndër problemet më të mëdha të evidentuara gjatë kësaj periudhe në territorin e “Bjeshkëve të Nemuna” janë prerja e pyjeve, zjarret, ndërtimet ilegale etj.

Prerjet ilegale janë duke u bërë pothuajse në të gjitha Komunitatet ku shtrihet territori i PK “Bjeshkët e Nemuna” me theks të veçantë në komunën e Deçanit dhe Pejës.

Prerjet e pakontrolluara të pyjeve kanë pasoja të pariparueshme që përveç humbjes së masës drunore, reflektojnë drejtpërdrejtë edhe në çrregullimin e ekosistemit, shqetësimin e botës shtazore, prishjen e peizazhit, paraqitjen e erozionit etj.

Dukuria e vënies së zjarreve ka qenë aktuale sidomos në periudhën 2010-2012, pra para shpalljes së kësaj zone Park Kombëtar me ç'rast janë djegë sipërfaqe të konsiderueshme të pyjeve dhe kullosave brenda territorit të parkut.

Gjendja në vitin 2013 dhe 2014 është më e mirë se sa ka qenë më herët, si në mbrojtjen e pyjeve, florës, faunës etj. Nuk ka pasur prerje zgjedhore të pyjeve përpos pastrimeve sanitare të cilat janë të lejuara me Rregulloren e Brendshme të Parqeve Kombëtare. Vlen të theksohet se prej rreth 30.000 m³ dru teknik sa kanë qenë të lejuara të priten në kohën para shpalljes së kësaj zone Park Kombëtar gjatë vitit 2014 janë lejuar diku rreth 3.000 m³ dru teknik, edhe atë në pyje private, ndërsa në pyjet shtetërore përpos në Deçan në asnjë lokalitet tjetër nuk janë lejuar prerjet.



Foto 31 dhe 32. Prerjet ilegale të pyjeve dhe zjarret në Park

Problem tjetër aktual mbeten aktivitetet e operatoreve të gurthyeshve dhe ndërtimi i shumë objekteve, kryesisht hoteliere, por edhe të banimit. Në mungesë të Planit Hapësinor, i cili është në procedurë të hartimit, ndërtimet bëhen pa kriterë mjedisore, hapësinore dhe urbanistike. Ndërtimi i objekteve shoqërohet më gërryerje të sipërfaqeve të cilat dëmtojnë peizazhin dhe biodiversitetin përreth.

Ndërtimet janë më të shprehura në zonat potenciale turistike, si në Grykën e Rugovës, Bogë, Leqinat, Gropa e Erenikut, Lugu i Butë, Burimi i Drinit të Bardhë etj.



Foto 33 dhe 34. Ndërtimet në Grykën e Junikut dhe shfrytëzimi i inerteve në Lumëbardhin e Deçanit

Në situatën e tanishme më rëndësia të veçantë është vendosja e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të ndërsjellë të të gjitha palëve të interesuara, e posaçërisht në mes të institucioneve lokale dhe

atyre qendrore në gjetjen e mënyrës së menaxhim sa më efikas, e gjithë kjo duke respektuar para së gjithash statusin ligjor, rëndësinë ekonomike, ekologjike, turistike etj.

Sigurimi i të dhëna të sakta nga inventarizimi i resurseve natyrore do të krijonte një bazë të të dhënave që siguron ndërtimin e një analize të përcaktimit të menaxhimit të ardhshëm të potencialit ekzistues të florës, faunës dhe resurseve tjera të zonës.

Zonimi i Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”¹⁴

Gjatë viti 2013 MMPH/AMMK në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës dhe shoqërinë civile ka realizuar projektin e Zonimit të PK “Bjeshkët e Nemuna”. Qëllimi i këtij aktiviteti ka qenë identifikimi dhe përcaktimi i zonave I, II dhe III të mbrojtjes sipas shkallës së mbrojtjes me qëllim të hartimit të Planit Hapësinor të PK “Bjeshkët e Nemuna”. Hulumtimet në terren me qëllim të identifikimit të llojeve të florës, faunës, ekosistemeve, gjeo-trashëgimisë dhe konstatimit të gjendjes së tyre, janë përqendruar kryesisht në zonat që janë identifikuar me vlera të veçanta natyrore të cilët janë propozuar si zona të para të mbrojtjes.

Objektivat e zonimit kanë qenë:

- Identifikimi i vlerave natyrore (gjeologjike, geomorfologjike, speleologjike, pedologjike, hidrologjike, hipsometrike, peizazhore, floristike, të vegjetacionit, faunës dhe karakteristikave tjera antro-p-gjeografike;
- Përcaktimi i 3 zonave të mbrojtjes (zona e parë - I, zona e dytë - II dhe zona e tretë - III) sipas regjimit të mbrojtjes dhe destinimit në territorin e PK “Bjeshkët e Nemuna”;
- Krijimi i databazës për vlerat natyrore të PK “Bjeshkët e Nemuna” për nevojat e hartimit të Planit Hapësinor, Planit Menaxhues dhe materialeve informative-promovuese dhe edukative-arsimore;
- Vlerësimi i gjendjes së vlerave natyrore në zonat e veçanta;
- Propozimi i masave për menaxhimin e qëndrueshëm (mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin) të vlerave natyrore të PK “Bjeshkët e Nemuna”
- Promovimi i vlerave natyrore në opinionin vendor dhe ndërkombëtar;

Në bazë të vlerave natyrore dhe destinimit janë propozuar zonat natyrore sipas shkallës së parë, të dytë dhe të tretë të mbrojtjes të cilët janë përshkruar në vijim.

Zona e parë e mbrojtjes (Zona I)

Si zona të para të mbrojtjes në territorin e PK “Bjeshkët e Nemuna” janë propozuar 15 zona me gjithsejtë 11,424.10 ha. Këto zona paraqesin vlera të veçanta natyrore të cilat karakterizohen me biodiversitet të pasur të florës, faunës, habitateve dhe të ekosistemeve.

Zona e regjimit të parë të mbrojtjes përfshinë pjesët e territorit të PK “Bjeshkët e Nemuna” me veçori natyrore të jashtëzakonshme, me lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër. Kjo zonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte.

Zona e dytë e mbrojtjes (Zona II)

Si zonë e dytë e mbrojtjes në territorin e PK “Bjeshkët e Nemuna” është propozuar sipërfaqja prej 47.288 ha që gjendet jashtë zonave të para dhe të treta të mbrojtjes Pjesë e konsiderueshme e cila i takon zonës së dytë mbulohet nga sipërfaqe me kullosa e cila paraqet hapësirë mjaft me rëndësi në të mirë të shfrytëzimit të qëndrueshëm të territorit të PK “Bjeshkët e Nemuna”. Zona e dytë është me sipërfaqe më të madhe në krahasim me dy zonat e tjera dhe karakterizohet me ekosisteme pyjore dhe barishtore. Në kuadër të

¹⁴ Raporti për zonimin e PK “Bjeshkët e Nemuna”, Nr. Prot. 777/14, 21.02.2014

kësaj zone gjenden pyjet e llojeve: ah (*Fagus moesiaca*), bredh (*Abies alba*) dhe hormoq (*Picea excelsa*) që kanë përhapje të gjerë në PK “Bjeshkët e Nemuna”. Ekosistemet barishtore, respektivisht kullosat janë të përhapura mbi vegjetacionin barishtor.

Në këtë zonë janë të pranishme llojet e rralla e të rrezikuara si dhe endemike të florës, faunës, por në krahasim me zonën e parë të mbrojtjes prania e tyre është më e kufizuar. Zona e dytë, përveç biodiversitetit të pasur natyror, posedon edhe vlera të rëndësishme biogeografike, gjeologjike, geomorfologjike, hidrologjike, pedologjike dhe peizazhore.

Kjo zonë kërkon menaxhim aktiv dhe përfshinë pjesët e territorit të PK “Bjeshkët e Nemuna” që karakterizohen me ekosisteme, vlera peizazhore dhe vlera tjera të natyrës ku mund të ushtrohen ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtarit që nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes.

Zona e tretë e mbrojtjes (Zona III)

Si zona të treta të zhvillimit në territorin e PK “Bjeshkët e Nemuna” janë propozuar gjithsejtë 61 zona me 4318.21 ha. Për zonat e treta të mbrojtjes të propozuara për zhvillimin e turizmit dhe ndërtimin e objekteve turistike duhet të behën Planet Rregullative me qëllim të shfrytëzimit të zonës në përputhje me funksionin e mbrojtjes së vlerave të natyrës. Ndërtimet duhet të janë të kufizuara dhe të përputhen me mjedisin natyror. Përparësi duhet të kanë objektet kapitale turistike (hotelet, motelet dhe sanatoriumet) pasi që mundësojnë shfrytëzimin maksimal të hapësirës me ndikime minimale negative në natyrë, ndërsa ndërtimi i objekteve të vogla turistike (vikend shtëpizave) duhet të kufizohet. Zonat e propozuara për skijim gjatë stinës verore mund të shfrytëzohen për kullojtë.

Si zonë e III e mbrojtjes janë propozuar zonat e sipërfaqeve barishtore që janë destinuar për zhvillimin e turizmit dhe ndërtimin e objekteve turistike. Këto zona, në krahasim me zonat e para dhe të dyta të mbrojtjes, janë me vlera më të ulëta natyrore dhe kanë kushte të volitshme gjeografike, relievore dhe klimatike për zhvillimin e turizmit.¹⁵

5.4. ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA

5.4.1. Ligatina e Hencit - Radeves

Ligatina e Hencit - Radeves shtrihet në pjesën qendrore të fushës së Kosovës, në afërsi të Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari” në mes të fshatrave, Henc – komuna e Fushë Kosovës, Vrellë – komuna e Lipjanit dhe Radevë – Komuna e Graçanicës në lartësi mbidetare rreth 545m dhe sipërfaqe të përgjithshme prej 109 ha 52 ari 35 m².

Kjo zonë është krijuar nga bashkimi i rrjedhave ujore të Magurës dhe Vrellës, të cilat janë degë e majtë e lumit Sitnica. Ligatina është krijuar në vitet e '60-ta më qëllim të kultivimit të llojit të peshkut Krap (*Cyprinus carpio*).

Ligatina e Hencit - Radeves duke pas parasysh se është i vetmi ekosistem i llojit të tillë në Kosovë, edhe pse i formuar në mënyrë artificiale, karakterizohet me vlera të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrogeologjike, botanike, peizazhore etj.

Në vitin 2013, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka përgatitë Arsyeshmërinë profesionale për shpalljen e Ligatinës së Hencit - Radevës zone e mbrojtur.

Për shkak të këtyre vlerave Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2014 ka nxjerrë Vendimin (Nr. 08/178, datë 18.03.2014) për shpalljen e Ligatinës së Hencit - Radeves Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve.

¹⁵ Raporti për zonimin e PK “Bjeshkët e Nemuna”, Nr. Prot. 777/14, 21.02.2014



Fig.6. Ligatina e Hencit

Qëllimet e synuara nga shpallja e kësaj zone të mbrojtur janë:

- Shfrytëzimi i qëndrueshëm,
- mbrojtja e ekosistemit,
- marrja e masave për sanimin e ekosistemeve të dëmtuara,
- shfrytëzimi racional i vlerave natyrore,
- rritja e mundësive për hulumtime shkencore, arsimore, kulturore, edukative dhe
- punëve të tjera profesionale në pajtim me konceptet bashkëkohore në zhvillimin e kësaj zone.

Në aspektin e florës, duke marrë parasysh pozitën gjeografike dhe kushtet klimatike, kjo zonë karakterizohet me një begati të madhe të pranishme të llojeve bimë. Sipas konstatimeve të bëra nga IKMN-ja në këtë zonë janë të pranishme mbi 50 lloje të bimëve vaskulare:

Ligatina e Hencit - Radeves është zone mjaftë e pasur edhe nga aspekti i zoodiversitetit. Sipas kërkimeve nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës në këtë zonë është konstatuar se jetojnë një numër i madh i llojeve të faunës së egër e prej tyre numrin më të madh e përfaqësojnë shpendët e egra për çka edhe shquhet kjo zonë. Numri i llojeve të shpendëve të konstatuara deri tash është 78, por mendohet se ky numër duhet të jetë shumë më i madh duke pasur parasysh se asnjëherë deri tani nuk është kryer ndonjë hulumtim sistematik dhe profesional në nivel të dëshiruar.

Habitatet natyrore të Ligatinës së Hencit- Radeves me rrethinë ofrojnë vendstrehim për shumë lloje të shpendëve, shumë prej tyre lloje të rralla dhe me status të pafavorshëm të ruajtjes tek ne dhe Evropë.



Foto 35. Peizazh nga Ligatina e Hencit - Radeves



Foto 36. *Adonis aestivalis*



Foto 37. *Equisetum palustre*




Foto 38. *Podiceps cristatus*



Foto 39. *Ardea cinerea*




Foto 40. *Himantopus himantopus*



Foto 41. *Acrocephalus scirpaceus*



Foto 42. *Ardea purpurea*



Foto 43. *Ixobrychus minutus*

Zona karakterizohet me veprimtaritë ekonomike si: peshkataria, bujqësia, blegtoria, gjuetia, etj. Basenet kryesisht përdoren për rritjen e peshkut ndërsa në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre zhvillohen aktivitete të prodhimtarisë bujqësore, kurse është i zhvilluar edhe turizmi rural dhe rekreacioni.

E gjithë zona e Ligatinës së Hencit- Radeves është pronë publike dhe menaxhohet nga Agjencioni Kosovar për Privatizim (AKP).

Gjendja

Meqenëse zona nuk është nën menaxhim të ndonjë institucioni profesional, pasojat e sajë vërehen çdo ditë e më tepër. Problem më i theksuar paraqitet tharja e baseneve dhe zonave tjera përreth për shkak të ndaljes së rrjedhjes së ujit në to. Sidomos kjo mungesë e ujit, e shpeshherë edhe tharja e këtyre ekosistemeve, vërehet gjatë sezonit të verës e cila shprehet me mungesë të llojeve të peshqve e çka është më e rëndësishme numri i llojeve të zogjve të pranishëm më herët në këto ekosisteme bie në mënyrë drastike.

Këtu duhet përmendet edhe ndikimi i madh që ka gjuetia ilegale dhe e pakontrolluar nga persona të pandërgjegjshëm në llojet e zogjve prezentë, e cila nëse vazhdon me trendin aktual, sigurisht që do të rrezikojë prezencën e një numri të madh llojesh si atyre vendore, ashtu edhe atyre shtegtare.

Vlen të përmendet gjithashtu se në kufi të kësaj zone gjendet edhe Aeroporti Civil i Prishtinës. Ka informacione se një numër i shpendëve janë duke u rrezikuar si pasojë e afërsisë së aeroportit përmes ndeshjes së aeroplanëve me zogj.

Mbetet që në të ardhmen të punohet bashkërisht edhe me stafin menaxhues të aeroportit në mënyrë që të rritet siguria e përgjithshme në aeroport dhe këto raste të zvogëlohen në minimum apo edhe të eliminohen tërësisht përmes përdorimit të mjeteve sa më bashkëkohore për largimin e zogjve nga zona e fluturimit.



Foto 44. Ekosisteme të thara dhe të djegura

5.5. MONUMENTET E NATYRËS

Në kuadër të Zonave të Mbrojtura, Monumentet e Natyrës për nga numri zënë vendin e parë me 99 sosh, ndërsa për nga sipërfaqja vendin e dytë me 5.971.95 ha. Prej tyre 2 Monumente janë të Rëndësisë së Veçantë, (Ujëvarat e Mirushës dhe Shpella e Gadimes), 66 të karakterit botanik, 17 hidrologjik, 7 gjeomorfologjik, 9 speologjik.

Monumentet e natyrës në të cilat ka pas ndikime më të mëdha gjatë këtyre tri viteve të fundit janë: Shpella e Gadimes, Ujëvarat e Mirushës, Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit, etj.

5.5.1. Shpella e Gadimes

Gjendet në afërsi të Lypjanit (pranë rrugës Prishtinë – Ferizaj), në fshatin Gadime e ulët. Shpella e Mermertë quhet ngase është e ndërtuar në shkëmbinj të mermerit dhe është një ndër shpellat më të bukura jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan e më gjerë. Në këtë shpellë paraqiten të gjitha llojet e stolive, stalagmite dhe stalaktite, në forma dhe madhësi të ndryshme, e posaçërisht tërheq vëmendjen stolia aragonite. Është zbuluar dhe është vënë nën mbrojtje në vitin 1969.



Foto 45. Kristalet aragonitet në Shpellën e Gadimes

Gjendja e shpellës 2010-2013

Gjatë viti 2009 me vendim të Qeverisë së Republikës të Kosovës është rimarrë nën mbrojtje Shpella e Gadimes si Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë. Gjithashtu gjatë këtij viti është bërë edhe ridefinimi i kufirit të Shpellës së Gadimes dhe është punuar harta e zonës së mbrojtur.



Foto 46. Kristalet në Shpellën e Gadimes

Në Shpellën e Gadimes edhe më tutje mbeten problemet e njëjta të cilat kanë filluar vite më parë. Veprimet nga jashtë dhe ndikimi i tyre në shpellë janë:

- Dukuria e gërryerjes së materialit shkëmbor nga rreshpet;
- Ndërtimi i objekteve në zonën e mbrojtur mbi shpellë dhe në afërsi të shpellës;
- Veprimi i guroreve në të cilat eksploatohet guri gëlqeror;
- Ndikimi i minimeve në destabilizimin e shpellës;
- Veprimet e ndryshme në shtratin e lumit Klysyrr përballë shpellës, etj.

Ndërsa në brendësi të Shpellës vërehen probleme serioze siç janë:

- Qarje të mëdha në hyrje dhe në fillim të kanalit të Galerisë të Lotëve;
- Rreziku i shembjes dhe rënies së copave të shkëmbinjve në korridoret që frekuentohen nga vizitorët;
- Ndryshime të dukshme hidrogeologjike, gjë që është manifestuar dukshëm në zvogëlimin e qarkullimit të ujërave nëntokësore;
- Paraqitja e myshqeve dhe kërpudhave si pasojë e ndryshimeve mikroklimatike, të kushtëzuara me mbylljen hermetike të hyrje-daljes si dhe ndriçimi afatgjatë dhe jo adekuat;
- Dëmtimet fizike (thyerje etj.) si dhe larje mekanike të stolive ;
- Mbishkrimet dhe grafitet nëpër korridoret e shpellës, dëmtojnë imazhin dhe origjinalitetin e shpellës;
- Ndriçimi dhe rrjeti elektrik joadekuat në shpellë është i dëmtuar dhe paraqet rrezik për vizitorët;
- Hulumtimet ilegale të korridoreve të tjera, pa konsultime me institucionet përgjegjëse;
- Menaxhimi joprofesional i shpellës, etj .

Në vitin 2013, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor merr vendim për mbylljen dhe ndalimin e përkohshëm të të gjitha aktiviteteve në monumentin e natyrës me rëndësi të veçantë “Shpella e Gadimës”. Vendimi merret si masë e përgjithshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e këtij monumeti nga veprimtaritë e palejuara të cilat po i rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij.




Foto 47, 48. Gjendja në brendësi të Shpellës (rrjeti i dëmtuar elektrik dhe zhvillimi i myshqeve) 2010 - 2013



Foto 49 dhe 50. Thyerja e kristaleve



Foto 51 dhe 52. Ndërtimi i rezervarit të ujit mbi shpellën e Gadimes dhe gurthyysi në afërsi të shpellës

Gjendja e shpellës 2014

Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në vitin 2013, ka vendosur të lirojë nga juridiksioni administrative i AKP-së, entitetin juridik “Shpella e Mermertë” dhe të njëjtën me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ia transferon nën administrimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. (vendimi Nr. 1692/AV)

Në vitin 2014, AMMK angazhon një staf më kontratë të përkohshëm deri në themelimin e Drejtorisë për menaxhimin dhe administrimin e monumentit të natyrës më rëndësi të veçantë “Shpella e Gadimes” duke përfshirë mbikëqyrësin, ciceronet, sigurimin dhe hapë shpellën për vizitorët në Maj 2014 dhe brenda tre muajve vizitohet nga mbi 20 mijë vizitorë nga vendi dhe te jashtëm.

Ambasada Franceze në Kosovë dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në vitin 2014 kanë ndarë një buxhet për vendosjen e ndriçimit të ri ku është ngritur siguria për vizitorët e shpellës.

Për Monumentin e natyrës me rëndësi të veçantë “Shpella e Gadimes” është përgatitur rregullorja më rendin e brendshëm si dhe çmimorja e biletave.



Foto 53. Gjendja e përmirësuar me 2014



Foto 54. Nga vizita e Ministrit dhe Ambasadores

5.5.2. Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë “Ujëvarat e Mirushës”

Ujëvarat e Mirushës janë shpallur Park Regional i Natyrës në vitin 1982/83 nga Komuna e Klinës dhe Rahovecit, tanimë e trashëguar nga Komuna e Malishevës me sipërfaqe prej 555.80.70 ha. Ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2012 nxjerr vendim për shpalljen e Ujëvarave të Mirushës Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë me sipërfaqe te përgjithshme prej 598.4 ha.

Kanioni i Mirushës është një ndër zonat më interesante të natyrës së Kosovës. Lumi Mirusha në pjesën e poshtme të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i lumit Mirushë. Në këtë pjesë të kanionit janë 16 ujëvara me liqene që e përbëjnë pjesën më atraktive të kanionit.

Gjendja

Në Monumentin e natyrës me rëndësi të veçantë “Ujëvarat e Mirushës” në distancë rreth 300 m, nga Liqenet e Kanionit Mirusha është ndërtuar një objekt hotelier me material të fortë i cili bie në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së natyrës. Investitori nuk posedon mendim profesional dhe leje ndërtimi nga organet përgjegjëse të MMPH-s.




Foto 55. Ujëvara e Mirushes



Foto 56 dhe 57. Ndërtimet ilegale në zonën e mbrojtur të Mirushës dhe rrëshqitjet e dheut

Në vitin 2010 është hapur rruga nga Kuvendi Komunal i Malishevës, pa respektimin e procedurave ligjore dhe profesionale, e cila ka ndikuar në rrëshqitjen e materialit shkëmborë dhe degradimin e peizazhit natyror rreth kanionit. Hapja e rrugës deri në afërsi të liqeneve, ka mundësuar fillimin e ndërtimeve ilegale, fluksin e madh të makinave si dhe ndotjen e lumit Mirusha. Numri i madh i makinave paraqet shqetësim serioz në degradimin dhe ndotjen e vlerave natyrore të zonës. Veprimet e tilla ndikojnë drejtpërsëdrejti në humbjen e vlerave të rralla të gjeodiversitetit, biodiversitetit si dhe ndikojnë në ndotjen e lumit Mirusha. Problem mbetet mos themelimi i organit menaxhues për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e Mirushës”, siç parashihet me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (neni 77).

Plani Hapësinor i MNRV “Mirusha”

Në Mars të vitit 2014 Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Planin Hapësinor për zonën e mbrojtur “Ujëvarat e Mirushes”, të hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor.

Qëllimi kryesor i Planit është të ndikojë në ndalimin e zhvillimeve të paplanifikuara që dëmtojnë zonën, të bëjë ridefinimin e vijës kufitare të zonës dhe të orientojë planifikimin e investimeve dhe zhvillimeve të ardhshme që duhet të realizohen sipas planit në këtë zonë të mbrojtur.

Ujëvarat e Mirushës veçohen për vlerat unike të trashëgimisë natyrore, kombëtare dhe kulturore, andaj përmes këtij dokumenti synohet që kjo zonë të mbrohet nga ndikimet e jashtme, të shfrytëzohet në mënyrë racionale si dhe të ketë zhvillim të turizmit të qëndrueshëm në dobi të komunitetit lokal dhe rajonal.

Sipas planit në periudhën e ardhshme 10 vjeçare, nga institucionet e vendit, donatorët dhe partneriteti publiko-privat, pritet që në këtë zonë të investohen rreth 30 milion euro. Dokumenti paraqet rezultatin e një pune të përbashkët të sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës, komunave, institucioneve relevante, profesionistëve të fushave të ndryshme, si dhe pjesëmarrësve nga shoqëria civile.

5.5.3. Gryka e Rugovës

Gryka e Rugovës, si Monument i Mbrojtur i Natyrës, është një ndër zonat me vlera më të veçanta gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, biodiversitet dhe vlera turistike dhe rekreative.



Foto 58. Gryka e Rugovës (foto F. Katallozi)

Është krijuar me punën e erozionit vertikal fluvial, kryesisht në gëlqeroret e triasikut, para dhe pas periudhës glaciale. Gryka e Rugovës, me 1985 është shpall monument i natyrës me rëndësi hidro-gjeomorfologjik, me sipërfaqe prej 4.302 ha. Përveç pasurive

në aspektin e florës dhe faunës (biodiversitetit), Gryka e Rugovës, prezanton bukuri të peizazhit, gjeodiversitetit si dhe karakteristika hidrologjike që rrallëkund mund të gjenden.

Gjendja

Gjatë monitorimit të vazhdueshme të gjendjes në terren në Monumentin e Natyrës “Gryka e Rugovës”, mund të konstatohet se në këtë monument ka pasur ndërhyrje të faktorit antropogjen sidomos në pjesën e mesme (afër tunelit) dhe të epërme të saj me ndërtimin e disa lokaleve afariste.

Gjithashtu duhet theksuar se me investimin e Kuvendit Komunal në disa pjesë të grykës janë vendosur ulëse për pushim të vizitorëve.



Foto 59 dhe 60. Ndërhyrjet në Grykën e Rugovës.

5.5.4. Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit

Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit janë vënë nën mbrojtje në vitin 1983, si monumente natyrore me sipërfaqe prej 89.94 ha. Shpella dhe Burimi i Drinit të Bardhë gjenden afër fshatit Radavc, rreth 11 km larg qytetit të Pejës, pranë rrugës (Pejë-Rozhajë). Këto dy bukuri të trashëgimisë natyror gjenden në pjesën verilindore të vargmaleve të Bjeshkëve të Nemuna. Shpella e Radavcit është shpellë tipike e burimeve. Formimi i saj është i lidhur me erozionin dhe punën kimike të ujërave nëntokësor të Drinit të Bardhë.

Gjendja

Bazuar në monitorimin e vazhdueshme të gjendjes në terren në Monumentin e Natyrës “Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit”, është konstatuar se në këtë monument ka pasur ndërhyrje të shumta të faktorit antropogjen. Ndërhyrjet kryesisht janë realizuar në Burimin e Drinit të Bardhë rreth Ujëvarës të cilat konsistojnë me ndërtimin e: shtigjeve për vizitor, shkallëve, vendosjen e kioskave, ndërhyrjet në rregullimin e rrjetit për nevojat e hidrocentralit dhe furnizimit të popullsisë me ujë të pijshëm dhe mbi shfrytëzimi i ujit nga ana e hidrocentralit i cili ndikon drejtpërdrejt në uljen drastike të sasisë së ujit në ujëvarë.



Foto 61. Burimi i Drinit të Bardhë

Të gjitha këto intervenime janë realizuar pa:

- hartim të projekteve paraprake,
- konsultime paraprake profesionale rreth aktiviteteve të realizuara dhe
- mendime profesional për aktivitetet që kryhen në këtë zone.

Në të ardhmen të gjitha investimet përreth Monumentin e Natyrës “Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit” duhet të jenë në harmoni me ligjin për Mbrojtjes e Natyrës (nr: 03 /L-233) dhe të merret mendimi profesional nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës për të gjitha aktivitetet që kryhen në këtë zone.

5.5.5. Muzeu i Kristaleve

Miniera e “Trepçës” në Stantërg është e njohur edhe ndoshta e vetmja në botë e cila shquhet me bukuri mahnitëse të kristaleve e mineraleve të llojeve të ndryshme.

Duke pasur parasysh këtë fakt në vitin 1964 themelohet Muzeu i kristaleve të mineraleve në të cilin janë të vendosura mbi 1300 eksponate të llojeve të ndryshme të kristaleve duke e shndërruar Muzeun në një objekt me rendësi të madhe kombëtare për Kosovën si në aspekt të vlerave po ashtu edhe në aspekt turistik. Përveç kristaleve në Muze janë të ekspozuara edhe mjete të vjetra pune me të cilat janë shërbyer xehetarët në fillimet e punimeve në minierë.

Në vitin 1970 Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës i vënë në mbrojtje 512 kristale të ekspozuara në muze duke e rritur edhe më shumë rendësin e muzeut. Që nga themelimi, Muzeu ishte i vendosur në një objekt i cili për shkak të vjetërsisë nuk i plotësonte kushtet për ekspozimin dhe ruajtjen e kristaleve.



Foto 62. dhe 63. Muzeu i kristaleve

Në vitin 2012 me fonde të Qeverisë së Republikës së Kosovë, përkatësisht, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe ndërmarrjes është ndërtuar objekti modern i muzeut të kristaleve. Vlera e investimit për ndërtimin e këtij muzeu është rreth 560 mijë euro (prej të cilave Ministria e Mjedisit kishte ndarë rreth 300.000 euro) dhe janë ekspozuar afro 1,500 ekspozate të kristaleve dhe mineraleve të zgjedhura”.

Përveç kristaleve nga miniera “Trepça”, në Muze janë të ekspozuara edhe mbi 100 lloje të kristaleve nga vendet të ndryshme të botës si : Gjermania, Italia, Franca, Spanja, Brazili, të cilat Muzeu i ka marrë në këmbim me kristalet nga miniera e “Trepçës”.

5.6. PEIZAZHET E MBROJTURA

Peizazhi i mbrojtur është zonë natyrore ose artificiale me vlerë të madhe peizazhore dhe larmi biologjike ose me vlerë kulturo-historike, ose peizazh me veçori të ruajtura unike karakteristike për zonën e caktuar i dedikuar për pushim dhe rekreacion (LMN 03/L-233).

5.6.1. Parku i Shkugzës

“Parku i Shkugzës”, gjendet në pjesën jugore të qytetit të Gjakovës i shtrirë mes dy kodrave të ndara nga lumi i vogël Shlepica, në lartësi mbidetare prej 410-460 m.

Ky Park shquhet me vlera të veçanta të biodiversitetit dhe peizazhit. Me propozim të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në vitin 2011 Komuna e Gjakovës ka shpallur të mbrojtur “Parkun e Shkugzës” në kategorinë e Zonë të Peizazhit të Mbrojtur, në sipërfaqe prej 70 ha.

Komuna e Gjakovës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes një projekti të UNDP-së në bashkëpunim edhe me Fakultetin e Biologjisë të Universitetit të Prishtinës kanë realizuar një studim të shkurtër këshillues lidhur me vlerësimin e kushteve për mbrojtje të kësaj zone të mbrojtur.

Studimi bazë është projektuar me të dhënat e mbledhura nga puna në terren e studentëve të Universitetit të Prishtinës, Departamenti i Biologjisë.¹⁶

16 Bank, P, Bemmerlein-Lux, F., Hajdari, A., Hajredini, E., Ibrahim, H., Mustafa, B. (2012) PROJEKTI “SHKUKZA” GJAKOVË, Plani i peizazhit për “Parkun e Shkugzës, UNDP



Fig. 7. Harta e Shkugzës



Foto 64. Pamje nga Parku i Shkugzës

“Parku i Shkugzës” ka një rëndësi të konsiderueshme për qytetin e Gjakovës ndër tjerash edhe për aktivitetet rekreative. Një pjesë e kësaj zone është në pronësi publike dhe rreth 1/3 e territorit të saj është tokë private. Në tokën publike janë ndërtuar restorante private me parkingje dhe kështu zona është bërë një lokalitet tërheqës për aktivitete të ndryshme rekreacioni.

Flora dhe vegjetacioni

Në vitin 1960, Shkugza ishte pyllëzuar me Pishë të Zezë (*Pinus nigra*). Një vlerësim i përafërt fillestar i shumëllojshmërisë bimore rezulton në rreth 280 lloje. Prej tyre mund të hasen: *Festuca ovina* agg. (bishtpelëza e deleve), *Agrostis capillaris*, *Poa pratensis*, *Bromus sterilis* (barthekeu), *Achillea millefolium* (bari mijëfletësh), *Trifolium* sp. (tërfilli), *Euphorbia cyparissias* (qumështorja), *Plantago lanceolata* (gjethe heshtorja), *Teucrium chamaedrys*, *Thymus spec.* (lisra), *Stachys spec* (sarusha), *Hieracium pilosella* (kamashna), *Hypochoeris radicata* dhe të tjera. Bimët kacavjerrëse si *Humulus lupulus* (sumbullaria) dhe *Clematis vitalja* (kulpra e egër) e bëjnë të vështirë qasjen në pyll.

Juniperus communis (dëllinja e zezë), *Rosa canina* (kaça) dhe *Prunus spinosa* (kulumria), sidomos në shpatet e lumit Shlepica, tregojnë se në këto pjesë ka pasur kullotje intensive në të kaluarën dhe tani këto shkurre nuk riprodhohen më për shkak të hijes së formuar.

Drunjtë dominues, në varësi të vendeve të veçanta, janë *Pinus nigra* (pisha e zezë), *Carpinus orientalis* (shkoza e zezë), *Acer campestre* (panja), *Ulmus speculim.*, *Fraxinus ornus* (frashëri), *Coryllus avellana* (lajthia), *Crataegus monogyna* (murrizi njëbërthamësh), *Cornus mas* (thana) dhe lisi (*quercus cerris* (qarri), *Quercus pubescens* (bungëbuti) dhe *Quercus frainetto* (shpardhi). Pishat e Zeza nuk janë pjesë e vegjetacionit fillestarë dhe ato nuk riprodhohen në mënyrë të natyrshme në këtë zone.

Fauna

Pylli korije (zabeli) shquhet me vegjetacionin më të larmishëm në “Parkun e Shkugzës” dhe është një habitat i rëndësishëm për lloje të ndryshme të fluturave (*Lepidoptera*), brumbullin e rrezikuar *Lucanus cervus* (kaçadremi), hardhucën e mureve (*Lacerta muralis*), breshkën (*Testudo hermanni*) etj.

Biodiversiteti i shtratit të lumit Shlepica është i kufizuar për shkak të ndotjes. Janë regjistruar llojet si tritoni (*Triturus vulgaris*), bretkoca barkverdhë (*Bombina variegata*), *Rana esculenta* agg., gjarpri i ujërave (*Natrix natrix*) etj. Në sasi të mëdha gjendet specia ujore *Micropterna lateralis* (nga rendi Trichoptera), e rrezikuar në disa vende evropiane dhe e regjistruar për herë të parë në Kosovë si dhe popullatat e pilivesave.

Nga llojet e zogjve më të pranishmet janë *Picus viridis* (qukapiku i gjelbër), *Lyscinia meganchynchos* (bilbili) dhe disa lloje tjera.



Foto 65. Brumbulli i rrezikuar (*Lucanus cervus*) Foto 66. Breshka (*Testudo hermanni*)



Foto 67. *Lacerta muralis* (Hardhuca e mureve)

Foto 68. *Bombina variegata* (Bretkoca barkverdhë)




Foto 69. Restorant dhe objektet përcjellëse shërbyese

Foto 70. Menaxhimi jo adekuat i mbeturinave

Gjendja

Kohëve të fundit brenda zonës së Parkut janë ndërtuar restorante pa pasur një miratim paraprak nga organet kompetente edhe atë 3 restorante (të ndërtuara nga druri) me tarraca, kënde lojërash dhe vend parkime janë të vendosura në mes të drunjve të pishës së zezë. Problem tjetër është edhe menaxhimi me mbeturina si dhe rreziku nga zjarret të cilat janë evidente në disa pjesë të Parkut. Mbeturinat e hedhura shpeshherë digjen dhe në të njëjtën kohë paraqesin rrezik permanent për përhapjen e zjarrit edhe në pjesët tjera të pyllit.

Prerjet ilegale, shkarkimi i ujërave të zeza, aktivitete të pakontrolluara pikniku, menaxhimi i pamjaftueshëm i mbeturinave (pronarët e restoranteve, publiku i cili viziton zonën, banorët lokal të fermave në rrethinë) janë disa nga problemet tjera shqetësuese për zonën që pritet të zgjidhen në të ardhmen me aprovimin e Planit Rregullues për këtë zone.

5.6.2. Parku Regjional Gërmia

Shtrihet në verilindje të Prishtinës dhe përfshinë një sipërfaqe prej 1.126 ha. Relievi i Gërmisë përbëhet prej kodrave me lartësi dhe pjerrësi të ndryshme, të ndara mes tyre me hapësira të luginave, të përroshave dhe lumenjve. Këtu posaçërisht veçohet lugina e lumit Vellusha që buron në pjesën perëndimore të kodrës së Butovcit, e cila edhe përfaqëson relievin më karakteristik me lartësi mbidetare 1000 m dhe gjatësi prej afro 8 km.

Në sajë të pozitës gjeografike, pedologjike, kushteve klimatike, masivi malor i Gërmisë është mjaft i pasur si në pikëpamje floristike, vegjetative dhe faunistike. Nga hulumtimet e deritashme janë të evidencuara 610 lloje të florës vaskulare të grumbulluara në 82 familje dhe 83 lloje kërpudhash duke mos llogaritur taksonet e barërave të këqija, atyre ruderales dhe bimëve tjera të ulëta. Prej tyre 5 lloje janë endemike dhe 12 lloje mjekësore.

Kompleksiteti i biotopeve natyrore të Gërmisë siguron kushte për jetesën e një sërë llojesh shtazore. Sipas hulumtimeve të bëra deri më sot dhe sipas shënimeve të literaturës në regionin e Gërmisë janë regjistruar: 5 lloje ujëtoksorësh, 7 lloje të rrëshqitësve, 19 lloje të gjitarëve dhe 30 lloje të shpendëve. Po ashtu, jetojnë edhe një numër i madh i insekteve që përbëjnë grupin më të madh të shtazëve në këtë masiv.



Foto 71. Pamje nga zona rekreative



Foto 72. Picërraku (*Salamandra salamandra*)

Për shkak të bukurive të posaçme natyrore, vlerave burimore dhe estetike natyrore, të cilat janë me rëndësi kulturore – arsimore, shkencore dhe turistike – rekreative, në vitin 1987, Kuvendi Komunal i Prishtinës ka marr nën mbrojtje Kompleksin “Gërmia”, në kategori të Parkut Regjional të Natyrës, me sipërfaqe 1.126 ha.

Gjendja

Edhe përkundër mirëmbajtjes së mirë të zonës rekreative nga organizata menaxhuese Hortikultura, janë evidentuar disa probleme rreth ruajtjes së vlerave në hapësirën e mbrojtur të Parkut të Gërmisë.

Dëmtime janë shkaktuar në ekosistemet pyjore nga faktori antropogjen, ndikimi i insekteve, zjarreve etj. Po ashtu pa respektim të mendimin paraprak të IKMN-së janë evidentuar edhe ndërhyrje si:

- ndërtime të objekteve private në pjesë të ndryshme të parkut;
- vendosja e antenave të telefonisë mobile;
- vendosja e kablllos së rrjetit elektrik;
- ndërtimi i objekteve të pushimores për fëmijë afër fushës së tenisit.

Problem mbetet ende:

- mungesa e Planit Menaxhues dhe Rregullues,
- shenjëzimi i parkut,
- prania e zonave të minuara,
- prezenca e drurëve të thatë dhe të rrëzuar,
- mbeturinat në pjesët e thella të parkut etj.

Gjatë viti 2013 Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me Komisionin Evropian ka filluar së zbatuari projektin “Drejt zhvillimit të qëndrueshëm të Parkut të Gërmisë”. Me këtë projekt përveç tjerash është paraparë rregullimi i shtigjeve brenda parkut, vendosja në funksion e trenit ekologjik, hartimi i një studimi për vlerat floristike dhe faunistike të zonës, hartimi i një Plani Rregullues për parkun etj.

Deri më tani Komuna e Prishtinës përmes këtij projekti ka realizuar një pjesë të aktiviteteve të parapara siç është ajo e meremetimit të shtigjeve për këmbësorë të cilat shtrihen në pjesën e zonës rekreative dhe zonës së dytë të regjimit të mbrojtjes. Sipas konstatimeve të para të IKMN-së rregullimi i këtyre shtigjeve është duke u bërë nga material jo ekologjik – beton, e i cili bie në kundërshtim me parimet e mbrojtës së natyrës dhe rekomandimeve të dhëna nga ana e IKMN-së.




Foto 73 dhe 74. Pamjen e shtigjeve të rregulluara në Park

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 të GZRK Nr. 85/9 nëntor 2010 kategoria e Parkut Regional Natyror nuk ekziston më në ligj, andaj është paraparë që Parku Regional Natyror “Gërmia” të ri-kategorizohet në kategori të re sipas ligjit në fuqi.

Për këtë qëllim AMMK-ja me Vendim Nr. 1317/14 të datës 18.03 2014 ka formuar Grupin Punues për përgatitjen e arsyesmerisë profesionale të Parkut Regjional Natyror “Gërmia”.

Në të njëjtën kohë nga ana e Komunës së Prishtinës, konkretisht projektit të Komisionit Evropian për Gërmiminë gjatë vitit 2014 është angazhuar një ekip i ekspertëve nga Universiteti i Prishtinës të cilët kanë hartuar një studim për vlerat natyrore në zonën e Gërmisë.

Në bazë të Vendimit paraprak dhe rezultateve të studimit, grupi punues ka hartuar një propozim profesional për zgjerimin e sipërfaqes së zonës së mbrojtur e cila do të përfshihet në kufijtë e ri të Peizazhit të Mbrojtur “Gërmia” dhe i njëjti i është dorëzuar Komunës së Prishtinës për miratim. Meqenëse ky masivi malor ngërthen në vete vlera natyrore, peizazhore, të biodiversitetit etj. gati të ngjashme me pjesën tjetër të mbrojtur të Parkut të Gërmisë si i tillë duhet të merret nën mbrojtje një sipërfaqe edhe më e madhe (edhe 1.176 ha) e cila përfshinë territoret përreth kufijve ekzistues deri tek Liqeni i Badovcit me mundësi reale të shfrytëzimit të qëndrueshëm veçmas për zhvillimin e ekoturizmit.

5.7. NDËRHRYJET NË ZONAT E MBROJTURA 2010-2014

Tabela 4. Ndërhryjet në zonat e mbrojtura

Nr.	Zona e mbrojtur	Komuna	Lloji i aktiviteteve	Kategoria
1.	Sharri	Prizren, Shtërpce, Kaçanik	- Kampit veror në Prevallë - Antena të telefonisë mobile - Objekte hoteliere dhe tjera - Prerje të drunjve dhe mbledhje ilegale të Produkteve pyjore jodrusore (PPJD-ve) - Gurëthyes	Park Kombëtar
2.	Bjeshkët e Nemuna	Pejë, Deçan, Junik, Istog	- Prerje ilegale të drunjve dhe mbledhje të PPJD-ve - Ndërhryje në shtratin e Lumëbardhit të Deçanit - Gurëthyes - Objekte hoteliere	Park Kombëtar
3.	Rusenica	Therandë	Gurëthyes	Rezervat natyror
4.	Shpella e Gadimes	Lipjan	- Objekt hotelier - Intervenime në brendësi të shpellës - Rezervari i ujit mbi shpellë - Gurëthyes në afërsi të shpellës	Monument Natyre me Rëndësi të Veçantë
5.	Bifurkacioni i lumit Nerodime	Ferizaj	- Objekt hotelier - Rregullimi i një pjese të shtratit të lumit	Rezervat natyror
6.	Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit	Pejë	- Objekt hotelier - Mbi shfrytëzimi i ujit në Burimin e Drinit të Bardhë nga ana e Hidrocentralit	Monument natyror
7.	Burimi termomineral	Istog	Ndërhryje në vendburim dhe kaptimi i burimit	Monument natyror

8.	Gërmia	Prishtinë	• Objekt hotelier • Antenë e telefonisë mobile • Terrene sportive për fëmijë • Vendorsja e rrjetit elektrik	Park Regjional
9.	Gryka e Rugovës	Pejë	• Objekte hoteliere	Monument natyror
10.	Ujëvarat e Mirushes	Malishevë Klinë	• Objekt hotelier • Hapja e rrugës deri te Ujëvarat	Monument Natyre me Rëndësi të Veçantë
11.	Kanioni i Drinit të Bardhë "Ura e Fshajt"	Rahovec, Gjakovë	• Objekt hotelier	Monument natyror
12	Burimi i ujit mineral në Sallabajë	Podujevë	• Ndërhyrje në burimit	Monument natyror
13	Burimi i ujit mineral në Shakovicë	Podujevë	• Ndërhyrje në burimit • Objekt hotelier	Monument natyror
14	Burimi i ujit termo-mineral në Banjë	Istog	• Ndërhyrje në burimit	Monument natyror

Burimi: Inspektorati i MMPH-së dhe IKMN

6 ZONAT TJERA TË MBROJTURA

6.1. ZONAT E NATURA 2000

“Natura 2000” është një sistem integral i zonave të mbrojtura në kuadër të Bashkimit Evropian. Ajo përfshinë zonat e mbrojtura sipas Direktivës së Habitaveve (Direktivës 92/43/EEC), si dhe zonat e mbrojtura sipas Direktivës së Shpendëve (**Direktivës 79/409/EEC**). Zonat e “Natura 2000” janë me rëndësi të përbashkët për Bashkimin Evropian (EU) dhe propozohen nga vendet anëtare të saj. Direktiva e Habitaveve dhe ajo e Zogjve për Bashkimin Evropian (EU) dhe vendet anëtare të saj paraqesin një instrument mjaft të rëndësishëm ligjor për ruajtjen e llojeve dhe vendbanimeve të tyre si dhe shërbejnë për realizimin e detyrave të Konventës së Biodiversitetit (CBD Rio 1992) për ruajtjen e diversitetit biologjik të llojeve dhe biotopeve të tyre. Kriteret baze për identifikimin e zonave për rrjetin “Natura 2000” dalin nga Neni 3. Paragrafi 1 i Direktivës 92/43 mbi Ruajtjen e Habitaveve:

Kjo Direktivë ka themeluar konceptin e rrjetit “Natura 2000”, i cili duhet të përbëhet nga Zonat Speciale të Mbrojtura - SPA (që rrjedhin nga Direktiva e Habitaveve) dhe Zonat Speciale të Konservuara-SAC (që rrjedhe nga Direktiva e Zogjve).

Rrjeti Evropian NATURA 2000 është themeluar prej dy lloje të zonave:

- Zonë e Veçantë e Mbrojtur - ZVM – zona të shpallura sipas Direktivës së BE-së për zogjtë e egër, zonat më të përshtatshme për kah madhësia dhe numri për ruajtjen e llojeve të listuara në Aneksin I dhe për llojet që rregullisht migrojnë¹⁷;
- Zonë e Veçantë e Ruajtur - ZVR – zona të rëndësishme për Komunitetin e shpallur përmes masave ligjore, administrative dhe/ose aktit të kontratës kur masat e ruajtjes së domosdoshme janë zbatuar për mirëmbajtjen ose restaurimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimit natyror dhe/ose popullacionit të llojit për të cilin zona është shpallur¹⁸.

Secili shtet anëtar duhet të identifikojë zonat kryesore për ruajtjen e llojeve të rralla ose të rrezikuara, të llojeve të vendbanimeve natyrore të komunitetit të pranishëm në territorin e vetë dhe integrimin e tyre në rrjetin NATURA 2000. Pas përcaktimit të tyre, këto zona duhet të menaxhohen për të garantuar mbijetesën afatgjatë të vendbanimeve natyrore dhe llojeve të tyre.




Fig. 7. Skema e funksionimit të Rrjetit ekologjik

Në të gjithë botën ekziston një rënie dramatike e popullacioneve të shumë llojeve kryesisht për shkak të përkeqësimit të gjendjes së vendbanimeve natyrore të nevojshme për mbijetesën e tyre. Në dekadat e fundit, intensifikimi i shumë aktiviteteve të njeriut

17 Ligji Nr. 03/L-233, Neni 7 paragrafi 1.62

18 Ligji Nr. 03/L-233, Neni 7 paragrafi 1.63

si ato industriale, energjetika, transporti, bujqësia, pylltaria, turizmi, etj. – kanë çuar në humbjen apo fragmentimin e vendbanimeve natyrore, duke lënë shumë pak hapësirë për florën dhe faunën e egër¹⁹.

Për nxitjen e menaxhimit më të mirë të trashëgimisë natyrore të Evropës, Komuniteti bënë zbatimin gradual të politikave të mbrojtjes së natyrës në territorin e saj. Në mënyrë të veçantë, në vitin 1979 dhe 1992 Bashkimi Evropian (BE) miratoi legjislacionin i cili kishte për qëllim mbrojtjen e vendbanimeve natyrore më të rrezikuara dhe llojet në të gjithë Evropën. Ky legjislacion është i njohur si Direktiva për Zogjtë e egër dhe Direktiva për Vendbanimet Natyrore. Në qendër të këtyre Direktivave është krijimi i një rrjeti të zonave të mbrojtura të quajtur NATURA 2000. Aspekt shumë i rëndësishëm i NATURA 2000 është se ajo është në përputhje të plotë me objektivat e Konventës së Bernës dhe Konventës së OKB-së për Biodiversitetin.

Direktiva për Vendbanimet Natyrore dhe Direktiva për Zogjtë e egër janë detyruese për të gjitha vendet anëtare të BE. Vendet që aspirojnë për t'u bërë anëtare të BE-së janë të detyruara të zbatojnë këto direktiva nga data e pranimit e tutje. Prandaj është e rëndësishme që këto vende të planifikojnë me kohë zhvillimin e politikave dhe strategjive të nevojshme.

Procesi i përcaktimit të Rrjetit të zonave NATURA 2000 në Kosovë nuk ka filluar ende, Megjithatë një platformë ligjore dhe politikat të cilat mbështesin krijimin e tij është krijuar. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011 - 2020 ka identifikuar nevojën për një inventarizim të zonave të mbrojtura në pajtim me kërkesat e NATURA 2000.

Për të filluar këtë proces, Projekti Menaxhimi Qëndrueshëm i Pyjeve ka ndërmarrë identifikimin paraprak të zonave potenciale NATURA 2000. Draft Lista e Zonave për Konsolidimin e Ardhsheëm është përgatitur me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe konsultimet me aktorët kryesor.

Po ashtu, në rrjetin Natura 2000, duhet të përfshihen edhe: Zonat Aktuale të Mbrojtura që i plotësojnë kriteret, Lokacionet CORINE, Zonat e Rëndësishme të Zogjve (IBA).

Kosova nuk është anëtare e Bashkimit Evropian (BE) dhe nuk është e obliguar të bëjë paraqitjen e zonave për rrjetin ekologjik "Natura 2000". Mirëpo përgatitja për hyrje në BE kërkon kohë dhe krahas përmbushjes së standardeve të tjera, mbrojtja e mjedisit dhe natyrës zënë një vend të rëndësishëm. Prandaj, duke e ditur se përmbushja e këtyre kriterëve kërkon një kohë të gjatë, fillimi i identifikimit të këtyre zonave duhet të jetë me prioritet

Projekti për identifikimin e zonave potenciale që i plotësojnë kriteret për të hyrë në rrjetin ekologjik "Natura 2000" në kuadër të "Projekti i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve" (PMQP/SFMP) është implementuar nga "Project Management Group në konsorcium me Green Belt dhe Project Management International Services Grup SRL" dhe në financim të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye janë formuar grupet punuese nga një spektër i gjerë i ekspertëve nga Universiteti i Prishtinës, Institucioneve Qeveritare dhe Joqeveritare.

Është duke u përgatitur projekt Plani i punës për përzgjedhjen e zonave NATURA 2000 me tregues për të dhënat e nevojshme, përgjegjësitë, afatet kohore dhe buxhetin që paraqet një bazë të mirë në përmbushjen e detyrimeve kundruall rrugëtimit të Republikës së Kosovës drejt Integritimit në Bashkimin Evropian.

Ky projekt plan është edhe një reflektim i institucioneve të Republikës së Kosovës (MMPH) ndaj "Raportit monitorues për zbatimin e kriterëve afatshkurta" Prill 2013, i cili raport konfirmoj që Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret afatshkurta për nisjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit - MSA.

19 Projekt Plani për NATURA 2000

6.2. REZERVATET E GJUETISË ME RËNDËSI TË VEÇANTË

Vendgjuetitë me rëndësi të veçantë janë një shtyllë e rëndësishme e kultivimit të kafshëve të egra sepse ato mund të kontribuojnë në arritjen e bilancit ekologjik duke ndihmuar në shtimin e llojit dhe numrit të kafshëve të egra të vendgjuetive private dhe atyre të përbashkëta.

Deri më tani ne kuadër të MBPZHR-s janë të themeluara dy vend gjueti me rëndësi të veçantë, “Blinaja” në Komunën e Lipjanit dhe “Duboçaku” në komunën e Skenderajt, Mitrovicës dhe Zubin Potokut.

6.2.1. Vendgjuetia me Rëndësi të Veçantë “Blinaja”

Kjo njësi menaxhimi shtrihet në pjesën perëndimore të ultësirës së Kosovës, në jug-perëndim të Prishtinës në largësi prej 32 km dhe ngrihet në lartësitë 600 - 850 m mbi nivelin e detit, në një rajon kodrinor të vend-gjuetive. Sipas destinimit, është zonë gjuetie me rëndësi të veçantë, e themeluar në vitin 1955 dhe rithemeluar në shkurt të vitit 2009 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2.794 ha.

Bota e gjallë bimore e kësaj njësie menaxhimi përfaqësohet nga një numër i madh llojesh autoktone, si dhe nga fauna e egër. Vegjetacioni është i begatshëm dhe i llojllojshëm si rezultat i proceseve historike evolutive dhe kushteve mjaft të përshtatshme gjeografike, orografike, klimatike, gjeologjike dhe pedologjike. Karakterizohet me një terren të brezit kodrinor me thyerje mesatare dhe pa pjerrësi të theksuara. Hidrografia përbëhet nga përroska të vogla që gjatë verës thahen tërësisht. Janë të ndërtuara 30 penda ujëmbledhëse me qëllim të furnizimit me ujë gjatë gjithë kohës.



Foto 76 dhe 77. Peizazhe nga Blinaja

Pjesa dërrmuese e sipërfaqes pyjore (mbi 90%) janë pyje cungishte, ndërsa pjesa e mbetur e sipërfaqes janë pyje të lartë, livadhe, kullota, sipërfaqe ujore etj.

Pjesëmarrja e llojeve në vëllimin e përgjithshëm në nivel të njësisë menaxhuese dominohet kryesisht nga dushqet, ku qarri ka pjesëmarrjen më të madhe 49%, bunga 33% e më pak shparthi me 6%, po ashtu lloje të tjera fletorësh si ahui, bliri etj., zënë rreth 11% dhe pjesën e mbetur e zë pisha e zezë.

Llojet më reprezentativë që kultivohen në njësinë menaxhuese të Blinaja-s, janë kaprolli (*Capreolus capreolus*), derri i egër (*Sus scrofa*), dreri bri lopatë (*Dama dama*), derri i rëndomtë (*Cervus elaphus*) etj. Përveç llojeve të kultivuara në këtë njësi menaxhimi mund të hasim

lloje karnivore si ujku (*Canis lupus*), dhelpra (*Canis vulpes*), vjedulla (*Meles meles*), macja e egër (*Felis silvestris*), shpendët si shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*), thëllëza e gurëve (*Alectoris graeca*), petriti i pulave (*Acipiter gentilis*), etj. Brenda vitit, gjatë stinëve të ndryshme, kohë pas kohe ndalojnë edhe shumë shpezë të tjera shtegtare.

Tabela 5. Llojet e faunës në Blinajë

Emërtimi	Numri i krerëve sipas regjistrimit të vitit 2007	Numri i krerëve sipas regjistrimit të vitit 2013
Dreri	131	148
Dreri lopatar	88	97
Muflloni	0	0
Derri i egër	346	504
Kaproll	48	65
Gjithsej	613	814

Burimi: AKP




Foto 78 dhe 79. Kaprojtë në Blinajë (Foto APK)

Kushtet natyrore mundësojnë kultivimin e kafshëve dhe shpezëve të egra për gjueti, që e bëjnë këtë njësi menaxhimi një lokacion të mirë për gjueti rekreative. Blinaja përfaqëson një lloj të mbyllur të vendgjuetisë, çka do thotë se nuk ka lëvizje të lirë të faunës së kultivuar dhe grabitqarëve natyror. Mungesa e grabitqarëve e bën gjuetinë si mjetin kryesor për të kontrolluar numrin e kafshëve apo ruajtjen e ekuilibrit biologjik, duke mos lejuar shtimin e numrit të madh të kafshëve mbi ekuilibrin biologjik dhe mbi kushtet apo mundësitë premtuese për ushqim dhe me këtë ruajtjen e këtij ekosistemi.

6.2.2. Vendgjuetia me Rëndësi të Veçantë “Duboçaku”

Kjo zonë në vitin 2009 me Vendimin e Ministrit të MBPZHR-së është shpallur Vendgjueti me Rëndësi të Veçantë. Ky rezervat gjuetie shtrihet në një lartësi nga 320 m deri në 1050 m mbi nivelin e detit. Sipërfaqja e përgjithshme e saj është 6805.05 ha, nga të cilat 2470 ha menaxhohen dhe administrohen nga APK ndërsa pjesa tjetër e pyjeve janë prona private që menaxhohen dhe administrohet nga pronarët e tyre. Prej llojeve të drunjve mbizotërojnë: bungeni, qarri, ahu, shkoza, panja, bredhi i kuq, bredhi i bardhë etj.

Duke pasur një pozitë të shumë të mirë gjeografike në këtë Njësi menaxhuese ka shtrirje

dhe zhvillim të shkallës së mirë të florës dhe faunës. Kjo njësi është e pasur me lumenj që e përshkojnë territorin e saj. Brenda saj ekzistojnë një mori e madhe e bimëve mjekësore si: sherbela mjekësore (*Salvia officinalis*), dëllinja e zezë (*Juniperus communis L.*), aguliçja (*Primula veris L.*), shtogu (*Sambucus negra*), kantarioni (*Hypericum perforatum L.*) etj. Gjithashtu edhe ekzistimi i frutave të ndryshme malore rritë njëkohësisht vlerën e kësaj njësie ku ekzistojnë : mjedra (*Rubus ideus*), luleshtrydhja (*Fragaria vesca*), thanat (*Cornus mas*) lajthia (*Corylus avelana*), kërpudhat si: Vrganji (*Boletus edulis*) dhe dhelprusha (*Cantharellus cibarius*), etj.

Duke u mbështetur në pozicionin gjeografik, kushteve gjeologjike, pedologjike, hidrologjike dhe karakteristikave të relievit dhe të klimës Dubočaku ofron kushte mjaft të përshtatshme për kultivimin edhe të botës së egër shtazore, kryesisht të gjitarëve që kanë rëndësi të madhe për gjueti rekreative.

Llojet më përhapura të gjitarëve në njësinë menaxhuese të Dubocak, janë; kaprolli (*Capreolus capreolus*), derri i egër (*Sus strofa*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), dreri i rëndomtë (*Cervus elaphus*), ujku (*Canis lupus*), dhelpra (*Canis vulpes*), vjedulla (*Meles meles*), macja e egër (*Felis sylvestris*), lepuri (*Lepus europeus*), mandej shpend[t si: shqiponja minjengrënëse (*Buteo buteo*), thëllëza (*Alectoris greca*), korbi (*Corvus corax*), qukapiku (*Dendrocopus major*), petriti i pulave (*Accipiter gentilis*) etj. Brenda vitit gjatë stinëve të ndryshme kohë pas kohe ndalojnë edhe shumë shpesh të tjera shtegtare.



Foto 80. Peizazh nga Dubočaku

Kushtet natyrore mundësojnë kultivimin e kafshëve dhe shpezëve të egra për gjueti që e bëjnë këtë njësi menaxhuese një lokacion të mirë për gjueti rekreative.

Kjo vendgjueti ka të gjitha parakushtet për orientim në zhvillimin e ekoturizmit, kultivimit, dhe zhvillimit të sektorit të gjuetisë. Shumëllojshmëria e bimëve, shtazëve dhe drunjve, prezenca e dy lumenjve, peizazhet e bukura etj. do të krijonte kushte ideale për zhvillimin e këtyre sektorëve profitabil.

Për arritjen e këtyre qëllimeve është e nevojshme investim në infrastrukturën rrugore si parakusht elementarë për krijimin e kushteve elementare për vizitore.



BIODIVERSITETI

7 BIODIVERSITETI

Gjendja e Biodiversitetit

Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor.

7.2.1. Gjendja e florës dhe vegjetacionit

Kosova edhe pse është një shtet me sipërfaqe të vogël (10.908 km²) është mjaftë e pasur në aspektin e shumëllojshmërisë bimore. Florën e Kosovës e përbëjnë algat, likenet, kërpudhat, fiernat, farëzhveshurat dhe farëveshurat të cilat janë bazë e jetës, formojnë mbështjellësin e gjelbër të tokës që ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e organizmave shtazor dhe njeriut. Pa mohuar rëndësinë e asnjë grupi bimor që kanë për jetën në planetin tonë, e në kuadër të kësaj edhe për jetën në Kosovë; bimët vaskulare, në veçanti bimët me farë (farëzhveshurat dhe farëveshurat) kanë rolin kryesor në vegjetacionin e Kosovës.

Edhe pse janë bërë hulumtime të florës dhe vegjetacionit të Kosovës nga autor të ndryshëm vendor dhe nga shtetet e ndryshme të Evropës ende nuk është bërë një inventarizim i florës dhe nuk dihet numri i saktë i taksonëve bimore në Kosovë. Sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm mendohet se në Kosovë janë prezent afro 2.800-3.000 lloje të florës vaskulare.²⁰



Foto 81. *Lilium albanicum*



Foto 82. *Plantago gentianoides*



Foto 83. *Polygala doerfleri*

Prerja e pyjeve pa kriter, degradimi i habitateve, ndryshimet klimatike globale janë faktor që po ndikojnë direkt që lloje të ndryshme bimore dhe shtazore të përballen me rrezik të zhdukjes. Habitata të rëndësishme janë duke u dëmtuar e degraduar dhe ekosistemet po destabilizohen si pasojë e ndërhyrjes së njeriut në veçanti në ekosistemet afër vendbanimeve. Në vitet e fundit si pasojë e prerjes së pyjeve pa kriter dhe përfshirjes nga zjarret e sipërfaqeve të mëdha të pyjeve, lloje të ndryshme rrezikohen të humbin habitatin e tyre dhe ardhjes në shprehje të llojeve invazive të cilat shpesh arrijnë të ndryshojnë strukturën floristike të ekosistemeve.

Në aspektin e shumëllojshmërisë floristike e në veçanti me lloje bimore endemike, relikte

²⁰ Libri i Kuq i Flores vaskulare te Republikës të Kosovës

dhe endemorelikte veçohen Malet e Sharrit, Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Namuna), Koritniku dhe Pashtriku pa lënë anash edhe Kosovën Veriore dhe Qendrore që gjithashtu janë të pasura me lloje endemike dhe relikte.²¹

Edhe pse fitodiversiteti i Kosovës është shfrytëzuar me shekuj, brengosë fakti që kohëve të fundit ky shfrytëzim është jo shumë racional dhe pa planifikim, gjë që në të ardhmen mund të rezultojë me pasoja të paparashikueshme. Dëme të mëdha po i shkaktohen bimëve mjekuese, aromatike dhe industriale nga grumbullimi pa kriter i tyre.



Foto 84. Shfrytëzimi pa kriter i florës shkaktonte dëme të mëdha

7.2.2. Gjendja e faunës

Në aspektin faunistik Kosova karakterizohet me një llojshmëri të madhe të llojeve edhe pse hulumtimet në këtë drejtim nuk kanë përfunduar. Hapësirat më të begatshme faunistike në Kosovë janë të gjitha masivet malore të Kosovës, por vlen të veçohen: Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna.

Gjendja e përgjithshme e faunës është e përkeqësuar si pasojë e rritjes së pranisë njerëzore në vendbanimet e tyre dhe rrezikut të vazhdueshëm nga gjuetia ilegale që paraqitet kohë pas kohe, në veçanti gjatë vikendit në hapësirat e zonave të mbrojtura.

²¹ Po aty



Foto 85. *Lacerta viridis* (Hardhuca e gjelbër)



Foto 86. *Vipera ammodytes* (Nëpërka)



Foto 87. *Picus viridis* (Pikthi i gjelbër)



Foto 88. *Vulpes vulpes* (Dhëlpër)

Nga gjuetia ilegale më të rrezikuar janë koprojtë dhe dhitë e egra, ndërsa zhvillim të mirë kanë ariu i murrmë dhe ujku. Rrezikun më të madh për zvogëlimin deri në zhdukje të rrëqebullit paraqet shfrytëzimi i gurit në rezervatin strikt të natyrës “Rusenica” i cili paraqet vendbanimin kryesor të këtij lloji të rrallë në PK “Sharri”. Të rrezikuara janë gjithashtu edhe llojet e shpendëve grabitqar.



Foto 89 dhe 90. Vendosja e barit dhe kripës për bimëngrënësit në PK “Sharri”

Llogaritet se në Kosovë jetojnë rreth 250 lloje të kurrizorëve, 200 lloje të fluturave dhe mbi 500 taksone të makrozoobentosit të ujërave. Numri i saktë i llojeve të faunës duhet të përcaktohet në bazë të inventarizimit që planifikohet të zbatohet në të ardhmen si gjatë hartimit të Librit të Kuq për faunën ashtu edhe në kuadër të projekteve tjera.



Foto 91. *Buteo buteo* (Petriti minjngrënës)



Foto 92. *Merops apiaster* (Babilja)

Monitorimi i llojeve të rrezikuara të gjitarëve në Parkun Kombëtar “Sharri”

Në kuadër të aktiviteteve për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit në zonat e mbrojtura të natyrës, gjatë vitit 2014 AMMK përkatësisht Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”, kanë filluar vendosjen e pajisjeve monitoruese në pjesë të ndryshme të PK “Sharri”.

Vendosja e kamerave kurth është kryer në disa pjesë të Parkut ku besohet se janë zona të mundshme e lëvizjes së kafshëve të egra, me theks të veçantë rrëqebullit (*Lynx lynx*).

Kamerat-kurth janë aparate me shkrepje automatike, të pajisura me një sensor i cili detekton lëvizjen e kafshëve me gjak të ngrohtë dhe i fotografon ato në momentin që kalojnë përpara pajisjes. Këto pajisje montohen në drunj apo kunja të posaçëm. Kjo metodë është jo-intenzive për studimin e faunës, pasi gjeneron informacion në lidhje me praninë dhe numrin e llojeve të ndryshme, pa i shqetësuar ato.

Ky aktivitet njëherësh është edhe pjesë e projektit për rimëkëmbjen e rrëqebullit (*Lynx lynx*) në Ballkan, financuar dhe implementuar nga organizatat ndërkombëtare EURONATURE dhe KORA bashkë me partnerët e saj lokal në Kosovë. Në kuadër të këtij projekti parashihet përcjellja e gjendjes së rrëqebullit ballkanik në territorin e Parqeve Kombëtare “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”. Pjesë e këtyre aktiviteteve është edhe Instituti për Mbrojtjen e Natyrës në bashkëpunim edhe me Universitetin Amerikan në Kosovë.

Nga ana e këtij Universiteti së shpejti pritet vendosja e rreth 15 kamera tjera e që si tërësi pritet të mbulohet një pjesë e konsiderueshme e territorit të Parkut Kombëtar “Sharri” me këto lloje të kamerave të cilat do të sigurojnë të dhëna të mjaftueshme për konstatimin e gjendjes së faunës në këtë zonë të mbrojtur.



Foto 93. Vendosja e kamerave kurth ne PK "Sharri"



Foto 94. Rrëqebulli i fotografuar ne Shqipëri

7.1. LLOJET INVAZIVE DHE ALIENE

Lloje *aliene* i referohen llojeve, nënlojeve apo një taksoni më të ulët, të introduktuar jashtë përhapjes natyrore të tanishme apo te kaluar; përfshirë çdo pjesë, gamet, farë, vezë apo propagulë të këtyre llojeve që mund të mbijetojnë dhe më pas të riprodhohen.

Lloj alien invaziv nënkupton një specie aliene, introduktimi dhe/ose përhapja e së cilës kërcënon diversitetin biologjik.

Llojet invazive janë introduktuar edhe tek ne me qëllim apo pa dashje për shekuj me radhë. Në kohët e fundit ky proces është nxitur nga zhvillimi i transportit, tregtisë, udhëtimit, turizmit si dhe nga përdorimi i llojeve invazive në akuakulturë, peshkim, bujqësi, pylltari, hortikulturë, turizëm si dhe nga globalizimi i tregjeve. Këto aktivitete shërbejnë si vektorë dhe rrugë hyrjeje për organizmat e gjalla bimore, shtazore apo materialeve biologjike përmes barrierave biogeografike, që duhej të pengonin përhapjen e tyre.

Në përgjithësi, vetëm disa lloje të introduktuara mund të mbijetojnë në mjedisin e ri dhe rrjedhimisht të natyralizohen në të pa krijuar probleme. Shumica e llojeve të introduktuara nuk shkaktojnë ndryshime të mëdha ekologjike ose dëme në mjedis sepse ato jetojnë kryesisht në habitate që janë tashmë objekte të ndërhyrjes së njeriut; lloje të tilla nuk konsiderohen invazive.

Llojet invazive tashmë renditen si shkaku i dytë më i rëndësishëm i humbjes së biodiversitetit global, pas shkatërrimit të drejtpërdrejtë të habitatit. Ato kanë ndikime të dëmshme në mjedis, në fushën ekonomike dhe atë sociale duke filluar që nga komunitetet lokale e deri në nivel global.

Llojet invazive i përkasin të gjitha grupeve taksonomike kryesore; duke përfshirë viruset, kërpudhat, algat, myshqet, fiernat, bimët e larta, pakurizorët, peshqit, amfibet, zvarranikët, shpendët dhe gjitarët. Edhe pse vetëm një përqindje e ulët e llojeve që lëvizin përtej kufijve bëhen invazive, këto kanë një ndikim shumë të gjerë.

Vitet e fundit, problemi i llojeve aliene invazive ka marrë një rëndësi të veçantë në politikat e ndërkombëtare me pikësypnim kërkesat për një kordinim më të mirë ndërsektorial ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe gjithë të interesuarve në të gjitha nivelet. Për këtë qëllim ne vitin 2010 me përkrahjen e Agjencionit Evropian për Mjedis është themeluar edhe Rrjeti i Evropës Juglindore për Llojet Aliene dhe Invazive

(ESENIAS) në të cilën është e përfaqësuar edhe Kosova.

Kosova ende nuk ka një listë zyrtare të llojeve aliene invazive. Bazuar në referencat e literaturës aktuale numri i llojeve të huaja invazive të njohura deri më tani është gjashtë edhe pse ky numër duhet të jetë shumë më i madh nga ajo që është në realitet.

Në lidhje me evidentimin e llojeve aliene invazive aktualisht ekziston një projekt i vazhdueshëm nga ana e stafit të Universitetit të Prishtinës për verifikimin e pranisë dhe shpërndarjes së llojit *Harmonia axyridis* në Kosovë. Ky projekt ka për qëllim përcaktimin e modelit të shpërndarjes së këtyre llojeve të insekteve të huaja në Kosovë dhe ndikimin e tyre në llojet autoktone të familjes Coccinellidae.

Tabela 6. Lista preliminare e llojeve aliene invazive në Kosovë²²

Taksoni	Familja
Llojet e bimëve	
Ambrosia artemisiifolia L.	Asteraceae
Datura stramonium L.	Solanaceae
Robinia pseudoacacia L.	Fabaceae
Amorpha fruticosa	Fabaceae
Fallopia japonica	Polygonaceae
Helianthus tuberosus	Asteraceae
Llojet e peshqve	
Oncorhynchus mykiss (Walbaum, 1792)	Salmonidae
Carassius gibelio (Bloch, 1782)	Cyprinidae
Pseudorasbora parva (Temminck & Schlegel, 1842)	Cyprinidae
Ctenopharyngodon idella (Valenciennes, 1844)	Cyprinidae
Lepomis gibbosus (Linnaeus, 1758)	Centrarchidae

Parandalimi i lëvizjes ndërkombëtare të llojeve aliene kërkon bashkëpunimin midis qeverive, sektorëve ekonomike, organizatave jo-qeveritare dhe organizatave të traktatave ndërkombëtare.

Aktualisht, në lidhje me përhapjen e llojeve aliene invazive në Kosovë, nuk ekzistojnë të dhëna e që përfaqëson një mungesë të madhe edhe për kontrollin e tyre. Studime të mëtejshme mbi ngritjen e kapaciteteve në lidhje me biologjinë dhe kontrollin e tyre dhe problemeve të biosigurisë duhet ti jepet në një të ardhme të afërt një kujdes i veçantë dhe përparësi.

22 Q. Maxhuni, H. Ibrahim: Overview of the invasive alien species in Kosovo, country report (<http://www.esenias.org/>)



Foto 95. *Ambrosia artemisiifolia*



Foto 96. *Pseudorasbora parva*

7.2. EKSPONATET E NATYRËS NË MUZEUN E KOSOVËS

I themeluar në vitin 1952, Sektori i Natyrës i Muzeut të Kosovës në vitin 2001 qe shkatërruar, duke e shndërruar atë në muzeun e tanishëm etnografik. Në mungesë të hapësirës ekspонатet që i ka poseduar ky muze tani kanë zënë hapësirën e bodrumit të Muzeut të Kosovës.



Foto 97. Ekspонатet e vendosura ne bodrumin e Muzeut të Kosovës

Ekspонатet asokohe janë vendosur në bodrum dhe hapësira joadekuate për ruajtjen e tyre dhe sot janë në gjendje të mjerueshme meqë pos që nuk janë mbrojtur nga bakteret, insektet e brejtësit, ata i janë ekspozuar edhe dëmtimeve mekanike, lagështisë dhe pluhurit.


Ky muze ka pasur gjithsej 1.812 ekspонат pas luftës së fundit në Kosovë, pasi që një pjesë e tyre janë marrë nga serbët gjatë luftës. Të gjitha këto dikur kanë qenë të ekspozuara mirë në një ekspozitë të përhershme, në të cilën qe investuar për më shumë

se pesëdhjetë vjet me radhë. Ekspонатet e lëna tani në bodrum janë në kushte shumë të papërshtatshme dhe në mungesë të hapësirës adekuate. Lagështia dhe mos spërkatja janë dy faktorët që më së shumti po i dëmtojnë këto ekspонат. Koleksionet muzeore të prezantuara në këtë sektor paraqesin një material shumë të vlefshëm, sepse dokumentojnë shumëllojshmërinë e formave jetësore nga botanika dhe zoologjia në aspektin ekologjik dhe biogeografik të këtyre hapësirave.

Shumë nga koleksionet e shpendëve dhe kafshëve që i ka poseduar ky muze e që tash janë në rrezik shkatërrimi, janë shumë të rralla jo vetëm për Ballkanin por edhe për Evropën.²³

8 PYJET E KOSOVES

8.1. GJENDJA E EKOSISTEMEVE PYJORE



Sipërfaqja pyjore në Kosovë është rreth 481.000 ha (44.7% e sipërfaqes totale).

Rreth 38 % e sipërfaqes pyjore është në pronësi private, ndërsa 62% janë pyje publike. Pyjet cungishte dominojnë sipërfaqet pyjore me 84%. Pyjet e pastra fletore mbulojnë pothuajse 83% të sipërfaqes pyjore.

Pyjet e Kosovës janë me specie druri të pasura 132.000 ha (27.5%) e sipërfaqes pyjore është e përbërë me katër ose më shumë specie. Pothuajse të gjithë sipërfaqet pyjore (99%) tregojnë një lloj të ndikimit njerëzor.

Foto 98. Pejzash pyjor- PK “Bjeshkët e Nemuna”

Më shumë se 90 % të vëllimit në këmbë të pyjeve në Parqet Kombëtare “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna” janë halore dhe pyje të përziera halorë/fletorë.




Foto 99. Pyjet halore në Malet e Sharrit

8.2. INVENTARIZIMI I PYJEVE

Qëllimi kryesor i Inventarizimit Nacional të Pyjeve (INP) të Kosovës, është që të promovojë një menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve duke vlerësuar resurset totale të pyjeve dhe lartësinë e prerjeve vjetore të qëndrueshme. Inventarizimi i pyjeve i pari në nivel vendi është kryer në vitet 2002-2003 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimi dhe Bujqësi (FAO), dhe implementuar nga Norwegian Forestry Group (NFG). Inventarizimi i dytë Nacional i Pyjeve (INP) të Kosovës, është kryer në 2012/2013, dhjetë vjet pas të parit. Duke përdorur metodën të quajtur inventarizimi sistematik i sipërfaqeve provë dhe kombinuar me teknologjinë e *remote sensing* dhe vlerësimit tradicional në terren, 12 pylltar kanë vizituar dhe vlerësuar 1.860 sipërfaqe prove në të gjithë territorin gjatë periudhës prej gjashtë muajsh. Për herë të parë gjithë sipërfaqet pyjore janë vlerësuar. Qëllimi i INP është që të ofrojë informacione për qeverinë për të ndihmuar zhvillimin e sektorit pyjor, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e menaxhimit të pyjeve dhe për të përmbushur detyrimet e mundshme ndërkombëtare të raportimit në shfrytëzimin e tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe sektorët e pylltarisë.

Tabela 7. Vëllimi në këmbë në pyje specie druri kryesore ($dbh \geq 7cm$) ($1000 m^3$)²⁴

Specie druri	2002	2012
<i>Quercus cerris</i>	5 170	4 282
<i>Quercus petraea</i>	4 276	3 669
Lloje tjera të Gj. Quercus	129	1 292
<i>Fagus sp.</i>	15 963	18 524
Fletorë tjerë	3 704	6 750
Fletorë të padefinuar	5 983	0
<i>Abies alba</i>	1 577	1 573
<i>Picea abies</i>	1 402	1 840
<i>Pinus sp.</i>	2 018	2 502
Halorë tjerë	233	77
Totali	40 445	40 508

Sipërfaqja pyjore në Kosovë është mjaft e qëndrueshme me rreth 481.000 ha (44.7 % e sipërfaqes totale).

Objektivat kryesore të Inventarizimit Nacional të Pyjeve të dytë për Kosovën janë:

- Sigurimi i statistikave të vlefshme për pyjet në shfrytëzimin e tokës dhe ndryshimin e përdorimit të tokës;-
- Nxjerrja e statistikave të vlefshme për pyjet mbi gjendjen dhe ndryshimin e vëllimit në këmbë, rritjes së drurit, dhe stoku i karbonit për planifikimin nacional dhe raportimin ndërkombëtar;
- Ruajtja dhe forcimi i vlerësimit të njohurive për pyjet.

Sipërfaqja pyjore e Kosovës është rritur për 5% (20.200 ha), në periudhën 2002-2012. Në të njëjtën periudhë sipërfaqja bujqësore ka tendencë të zvogëlimit e cila mund të shpjegohet me rritjen e sipërfaqes pyjore (konvertimi i tokës bujqësore në atë pyjore).

24 MBPZHR (2012) Inventarizimi Nacional i Pyjeve Kosovë

8.3. SIPËRFAQET E PYLLËZUARA

Në Kosovë, 0.5% për qind e pyjeve janë të rigjeneruara me pyllëzime ose farim natyral. Përafërsisht 85% e sipërfaqes pyjore është rigjeneruar me prejardhje vegjetative përmes cungjeve filizave/bisqeve.




Fig. 8. Sipërfaqet e pyllëzuara 2005-2012

8.4. ZJARRET

Raportet nga Njësitë Komunale e të verifikuara edhe nga stafi i Drejtorive Koordinuese, Regjionale flasin se gjatë vitit 2012 në disa rajone të Kosovës ka pasur vatra të zjarreve me intensitet të ulët ku janë përfshirë sipërfaqe të konsiderueshme të pyjeve.

Dukuria e shfaqjes së zjarreve ka ardhur duke u intensifikuar sidomos gjatë muajit Gusht ku janë përfshirë sipërfaqe më të mëdha por edhe më kualitative të pyjeve me kulturë halorë.

Zjarre ka pasur në të gjitha Regjionet e Kosovës por Dragashi dhe Deçani kanë pasur pyje më kualitative (ekonomike) të cilat janë përfshirë nga zjarret.

Sipas raporteve për zjarret në periudhën Janar-Gusht 2012 janë përfshirë 2,907.34/ha në sektorin shtetëror 580.40/ha në sektorin privat kurse në total janë përfshirë 3,487.74/ha prej të cilave nuk janë vetëm pyje por ka toka pyjore dhe kulloso. Regjionet me pyje kualitative të pyjeve si Deçani sipas raporteve të përafërta janë rreth 200/ha me pyje të larta halorë të cilat janë përfshirë nga zjarret.

Llojet e zjarreve kanë qenë nga ato sipërfaqësore, të ulëta, të larta por edhe lloje të kombinuara të zjarreve, i ulët, sipërfaqësor dhe i lartë. Burimet e zjarreve sipas raporteve ende të pa detajizuara dhe të pa verifikuara kanë qenë të panjohura. Zjarret sipas opinionëve (dyshimeve) mund të jenë aksidentale të pa qëllimshme si pasojë e pa kujdesisë hedhjes së cigareve të pa shuara. Nga dukuria e djegies së hamullorëve të cilat pastaj nuk mund të kontrollohen dhe përhapen në pjesë tjera, nga djegia në deponitë e mbeturinave por nuk përjashtohen edhe mundësitë e zjarr vënieve të qëllimshme nga persona të pa ndërgjegjshëm. Sipërfaqja e përfshirë nga zjarret e cila ka prek pyjet e ulëta e deri te ato më kualitative nuk ka shkatërruar të gjithë masën drunore pra nuk kemi pyje të shkretuara por me mundësi të regjenerimit natyror pasi kemi sipërfaqe të brendshme dhe drunj të së ardhmes (farorë) të cilat kanë shpëtuar nga zjarret.



Foto 100. Zjarr në pyjet e Sharrit

Institucionet relevante kanë shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e veta për t'iu dal në ndihmë Komunave në shuarjen e zjarreve duke bashkërenduar aktivitetet dhe kërkimet e ndihmës edhe nga institucione të tjera qendrore si Agjencionin për Menaxhimin e Emergjencave, Forca e Sigurisë së Kosovës, etj.

Tabela 8. Zjarret Pyjore për periudhën 2010 - 2014²⁵

Nr.	Viti	Sipërfaqet e djegur ha
1	2010	191.06
2	2011	2324.63
3	2012	5604.53
4	2013	365.48
5	2014	393.81
Gjithsej		8879.51

Siç shihet nga tabela dhe grafiku, periudha me kritike e shkaktimit të zjarreve ka qene viti 2011 dhe 2012, qe njihen si vitet me përudhë të madhe të thatësisë dhe temperaturave të larta gjatë gjithë vitit.

²⁵ Burimi: APK



Foto 101. Vullnetarë gjatë shuarjes së zjarrit




Fig. 9 Sipërfaqet e djegura ndër vite për periudhën 2003-2014²⁶

²⁶ Agjencioni i Pyjeve të Kosovës

9 EKOTURIZMI

9.1. EKOTURIZMI I ZONAVE TË MBROJTURA

Turizmi, sot është një nga industritë me të fuqishme në bote dhe si e tillë, ka një ndikim të madh në zhvillimin ekonomik e social të mjaft vendeve, sidomos atyre në zhvillim ku shihet si një nga burimet me të rëndësishme të të ardhurave, të mundësive të punësimit, të mbrojtjes së mjedisit si dhe të promovimit të shkëmbimeve ndërkulturale. Në Kosovë, sidomos gjatë viteve të fundit, janë bërë investime në rregullimin e infrastrukturës si një prej elementeve kyçe në promovimin dhe zhvillimin e ekoturizmit me theks të veçantë në zona të mbrojtura.²⁷

Ekoturizmi është lloj i turizmit që ka për qëllim udhëtimet në vendet e paprekura natyrore, në zonat e mbrojtura ose atraksionet tjera natyrore dhe që zakonisht përpiqet të minimizojë ndikimin e faktorit njeri në mjedis. Ai ka për objektiv edhe të promovojë edukimin mjedisor, të sigurojë fonde për ruajtjen e natyrës, të ndihmojë zhvillimin ekonomik, fuqizimin e komuniteteve lokale, si dhe të nxis respektin për kulturat e ndryshme.

Për Kosovën ekoturizmi është një dukuri e re, por në shumë vende të botës ky lloj turizmi është shtyllë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Kosova shquhet për vlera të rralla të trashëgimisë natyrore. Pozita gjeografike, relievi, klima, burimet ujore, peizazhet, grykat e kanionet, bota e pasur bimore dhe shtazore janë parakushte ideale dhe potencial i lartë për zhvillimin e ekoturizmit. Kosova ka mundësi të mira të zhvillimit të ekoturizmit të shpellave, ekoturizmit malor, atij rekreativ-sportiv, veror, rural dhe atij edukativ.

Ekoturizmi i shpellave: Për opinionin e gjerë janë të njohura bukuritë natyrore të Shpellës së Gadimes, e cila njëherazi është edhe ndër atraksionet më të mëdha turistike në vend. Mirëpo, Kosova ka edhe disa shpella të tjera dhe përmirësimi i infrastrukturës së tyre do të ofronte kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit të shpellave. Të tilla janë për shembull Shpella Gryka e Madhe, Shpella e Panorcit, Shpella e Kishnarekës, Shpella e Radavcit, Shpella e Dushit etj.

Ekoturizmi malor dhe ecja në natyrë: Në zonat e thella malorë të Kosovës ekzistojnë shumë shtigje malore të cilat përdorën blegtorët për bagëtitë e tyre dhe të cilat paraqesin mundësi reale për zhvillimin e ecjes në natyrë, shëtitjeve malore me biçikleta, por edhe të ekspeditave dhe kampingjeve. Përveç Maleve të Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna, ky lloj i turizmit mund të zhvillohet edhe në Bjeshkët e Shalës së Bajgores, Vargmalet e Berishës, Malet e Jezercit etj.

Ekoturizmi veror dhe njëditorë: Klima e përshtatshme, livadhet e pasura me llojllojshmërinë e bimëve, burimet e shumta ujore, peizazhet piktoreske janë parakusht i mirë edhe për zhvillimin e turizmit veror dhe kampingut. Liqenit i Breznes, Liqeni i Batllavës, Kanioni i Mirushës, Gryka e Rugovës janë vetëm disa nga zonat që gjatë stinës së verës mund të jenë destinacion i përhershëm i shumë turistëve dhe adhuruesve të natyrës që dëshirojnë të kalojnë një ditë në natyrë.

Ekoturizmi rekreativ dhe sportiv: Në Malet e Sharrit, në Bjeshkët e Nemuna, por edhe në zona tjera malore të Kosovës, gjenden shumë terrene të përshtatshme për zhvillimin e skitarisë. Kapaciteti i terreneve të skijimit të këtyre qendrave mund të pranojnë me mijëra vizitorë gjatë sezonit të dimrit. Ndërsa, gjatë verës, në Malet e Sharrit dhe në Bjeshkët e Nemuna ka plotë maja të cilat janë shumë atraktive për zhvillimin e alpinizmit dhe bjeshkatarisë.

²⁷ Destinacionet Ekoturistike në Kosovë, A. Berisha 2010

Turizmi rural: Në shumë zona rurale të Kosovës, e sidomos në ato malore, ende ruhen shumë zakone, tradita, lojëra, këngë, veshje e ushqime tradicionale. Këto pasuri të jashtëzakonshme kulturore janë një mundësi e mirë e zhvillimit të turizmit rural dhe promovimit të këtyre vlerave. Në veçanti, për këto vlera shquhen fshatrat malore që shtrihen në Malet e Sharrit, e sidomos ato që i takojnë komunës së Dragashit.

Turizmi edukativ dhe shkencor: Ekosistemet e paprekura malore, prania e llojeve të rralla bimore e shtazore, shpellat e pa hulumtuara, kanionet, rrjedhat e shumta ujore dhe pasuritë nëntokësore të Kosovës kanë potencial edhe për zhvillimin e aktiviteteve edukative e kërkimore me nxënës, studentë dhe shkencëtarëve nga Kosova, por edhe për ekspedita të huaja hulumtuese.

Përkundër këtyre vlerave të jashtëzakonshme dhe mundësive ideale për zhvillimin e ekoturizmit, mungesa e infrastrukturës, mungesa e investimeve, mungesa e planeve dhe projekteve konkrete ka penguar zhvillimin e kapaciteteve ekoturistike. Problem i veçantë është qasja që institucionet qeveritare dhe shoqëria kosovare ka ndaj shfrytëzimit të qëndrueshëm të këtij potenciali. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, dëmtimi i ekosistemeve, gjuetia ilegale, zgjerimi i vendbanimeve janë kërcënim i vazhdueshëm për këto vlera. Me një promovim më profesional të zonave ekoturistike, me rritjen e investimeve dhe me përgatitjen e një strategjie kombëtare për zhvillimin e ekoturizmit, Kosova mundet të jetë një vend shumë atraktiv ekoturistik.



Foto 102. Ekoturizmi në PK "Sharri"



Foto 103. Ekoturizmi në PK "Bjeshkët e Nemuna"

10 RAPORTIMI NË EIONET DHE BASHKËPUNIMI ME AGJENCIONIN EVROPIAN TE MJEDISIT

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në kuadër të bashkëpunimit me Agjencionin Evropian të Mjedisit - EEA dhe procesit të Raportimit në Rrjetin Evropian të Mjedisit-EEA dhe në Rrjetin Evropian të Sistemit të Informimit dhe Mbikqyerjes - EIONET, prej vitit 2011 ka raportuar në këto institucione.

Në kuadër të aktiviteteve dhe angazhimeve në procesin e raportimit për gjendjen e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetin IKMN për katër vite me radhë (2011-2014) ka raportuar në EIONET për indikatorin Common Database on Designated Areas (CDDA).

Vlen të theksohet se për katër vite me radhë ky raport është vlerësuar me notë maksimale nga ana e zyrtarëve të EIONET-it.




Fig. 10. dhe 11. Performanca e përgjithshme e shteteve (Maj 2013-Prill 2014)

11 MASAT E NDERMARRA PER MBROJTJEN E NATYRES

11.1. PROJEKTET NACIONALE DHE ATO TË FINANCUARA NGA DONATORËT

Tabela 9. Lista e projekteve nacionale dhe ato të financuara nga donatorët

Nr.	Titulli i projektit	Donatori
1	Parqet e Harkut Dinarik	Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme dhe Fondacioni MAVA
2	Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës	GTZ dhe MMPH
3	Ngritja e strehimores "PYLLI I ARINJVE" në Badovc	Fondacioni për mbrojtjen e kafshëve VIER PFOTEN Internacional
4	Drejt menaxhimit të qëndrueshëm të Parkut Gërmia	Komisioni Evropian dhe Komuna e Prishtinës
5	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës dhe Konservimi i Biodiversitetit në Komunën e Dragashit	Qeveria Finlandeze dhe UNDP
6	Inventarizimi Nacional i Pyjeve	Qeveria Norvegjeze dhe MBPZHR
7	Zonimi i PK Bjeshkët e Nemuna	UNDP dhe MMPH
8	ECRAN- Rrjeti Regjional për qasje në mjedis dhe ndryshime klimatike	Komisioni Evropian
9	Studimi i fizibilitetit në themelimin e zonave të mbrojtura ndërkufitare "Sharr - Korab - Deshat"	ENVSEC - Environment & Security - UNEP
10	Projekti RENA (2010-2012) - ngritje e kapaciteteve për Grupet Punuese për bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëveshjet mjedisore shumë palëshe në nëngrupin për sektorin e natyrës;	
11	Rregullimi i rrjetit elektrik në brendi të shpellës.	Ambasada franceze dhe AMMK-së

11.1.1. Libri i Kuq i florës vaskulare

Me përkrahjen e GIZ-t gjerman dhe MMPH-se gjatë vitit 2013 është hartuar Libri i Kuq i florës vaskulare të Kosovës. Hartimi i këtij libri ka qenë në plan të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, që nga themelimi i MMPH-së, për faktin se ka qenë nevojë e domosdoshme për të ditur gjendjen dhe kërcënueshmërinë e një pjese të florës së Kosovës të cilat konsiderohet të rëndësishë së veçantë. Me finalizimin e këtij libri, është krijuar një pasqyrë reale për gjendjen e llojeve të rëndësishme të florës vaskulare të Kosovës, nivelin e rrezikshmërisë së tyre, faktorët dhe shkaqet kryesore që kanë ndikuar në rrezikshmërinë e tyre. Ky Libër do të shërbejë si një udhërrëfyes jo vetëm për MMPH, por edhe për të gjitha institucionet tjera shkencore, OJQ dhe hulumtuesit në



përgjithësi që të punojnë për parandalimin e ndikimeve negative dhe kërcënimeve tjera nga të cilat rrezikohen sot nga zhdukja llojet e florës së Kosovës. Libri i Kuq paraqet bazën për zhvillim të mëtutjeshëm për mbrojtjen e florës së Kosovës.

Lista e kuqe e florës vaskulare të Republikës së Kosovës është e rëndësishme sepse ajo e përqendron vëmendjen e të gjithëve që merren me natyrën në drejtim të rëndësisë që ka kërcënimi i biodiversitetit, ajo zbulon ato lloje të cilat kanë nevojë për masa mbrojtëse dhe vë bazat e informacionit për monitorim të mëtejshëm. Libri i kuq ka rëndësi të madhe sepse siguron informacionet të cilat ndihmojnë në përpilimin e prioriteteve mbrojtëse në nivelin lokal dhe mundëson një bashkëpunim më të mirëfilltë me organizata ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e mjedisit, siç është Konventa mbi diversitetin biologjik dhe Konventa për tregti ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër.




Fig.12. Paraqitja grafike e numrit të ll. bimore të cilat iu takojnë kategorive të ndryshme të kërcnueshmërisë

Më poshtë janë disa prej llojeve të rrezikuara në mënyrë kritike në Librin e Kuq të Kosovës:



Foto 104. *Achillea alexandri-regis*



Foto 105. *Dianthus barbatus*



Foto 106. *Helleborus purpurascens*



Foto 107. *Leontopodium alpinum*



Foto 108. *Micromeria cristata*



Foto 109. *Linaria alpine*



Foto 110. *Adonis microcarpa*



Foto 111. *Fritillaria graeca*



Foto 112. *Laburnum alpinum*

11.1.2. Pylli i arinjve

Pylli i Arinjve Prishtina është një projekt i Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve VIER PFOTEN Kosova në bashkëpunim me MMPH-në, Komunën e Prishtinës dhe me përkrahje të Fondacionit për mirëqenien e kafshëve VIER PFOTEN International me seli në Vjenë të Austrisë.

Idea e këtij projekti ka qenë mbledhja e të gjithë 13 arinjve të murrmë të mbajtur në restorante në nëpër mini-kopshtet zoologjike nëpër restorante të ndryshme anë e kënd Kosovës në kushte shumë të vështira dhe mbajtja e tyre në një vend i cili ofron kushte sa më natyrore.

Faza e parë e projektit është përfunduar dhe që nga fundi i muajit maj 2013, të gjithë arinjtë janë sjellë në park dhe vazhdojnë të bëjnë pjesën tjetër të jetës së tyre në kushte shumë më të mira se sa më parë.

Gjatë vitit 2014 nga ana e kësaj organizate janë marrë nën përkujdesje edhe tre arinj këlysh nga rrethina e Pejës të cilët po mbaheshin ilegalisht. Pasi është bërë i ditur rasti nga zyrtarët e PK "Bjeshkët e Nemuna", bashkë me Policinë e Kosovës është bërë konfiskimi i tyre dhe bashkë me ekspertët e kësaj organizate janë transferuar në strehimore ku nga stafi i kësaj organizate janë kujdesur që këta tre arinj të kenë kujdesin e duhur.



Fig. 113 dhe 114. Pjesë e parkut dhe vizitës edukativo-arsimore të një grupi nxënësish

Të gjithë arinjtë aktualisht janë të vendosur në 7 sektorë me sipërfaqe të përgjithshme prej afër 2 hektarë dhe me objekt për menaxhim të arinjve me të gjitha kushtet dhe mundësitë për një jetesë normale të tyre. Vendosja e arinjve në këta sektorë është e përkohshme dhe në momentin kur të ndërtohen sektorë më të mëdhenj arinjtë do të shpërndahen në to.

Gjendja e përgjithshme e arinjve në momentin e ardhjes së tyre në park ka qenë shumë e vështirë. Ata kanë qenë shumë të stresuar dhe kanë pasur shumë vështirësi të mësohen të shfrytëzojnë lirinë dhe kushtet të cilat u janë ofruar.



Foto 115 dhe 116. Çaste nga promovimi i strehimores së arinjëve

Tani situata e tyre e përgjithshme është përmirësuar dukshëm për arsye se:

- Kanë më shumë sipërfaqe në shfrytëzim,
- Kanë ushqim të rregullt dhe të kontrolluar nga ekspert,
- U janë krijuar kushte për strehim, shpella, mundësi për lojëra, basene uji për freskim, uji i pastër për pije,
- Pastrim i sektorëve nga fekalet dhe i ujit në basene,
- Janë trajnuar nga ekspert dhe stafi i punësuar për tu menaxhuar më lehtë në park dhe për ti evituar sadopak problemet psikike me të cilat këta arinj ballafaqohen,
- Kanë kujdes profesional shëndetësor.

Një prej qëllimeve kryesore të Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve VIER PFOTEN Kosova

është që përmes aktiviteteve të ndryshme në PYLLIN E ARINJVE Prishtina në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe me organizata rinore të zhvilloj një program të edukimit për nxënës dhe të rinj në fushën e mbrojtës së mjedisit dhe sidomos të kafshëve të egra si një hallkë mjaft e rëndësishme e ekosistemit tonë.

Bashkëpunimi me shkolla tanimë ka filluar dhe në vizita të organizuara kanë ardhur në park nxënës nga shkolla të ndryshme të Komunës së Prishtinës.

Gjithashtu aktiv është edhe grupi i Vullnetarëve i cili ka ndihmuar në përgatitjen e parkut për pranimin e arinjve të parë. Ky grup përbëhet nga të rinj e të reja nga etnitete të ndryshme, nga disa pjesë të Kosovës si dhe disa vullnetarë ndërkombëtarë.

11.1.3. Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës dhe Konservimi i Biodiversitetit në Komunën e Dragashit

Gjatë periudhës sa ka zgjatur ky projekt ka arritur rezultate të lakmueshme në fushën e konservimit të biodiversitetit dhe mbrojtjes së mjedisit në komunën e Dragashit. Gjatë hartimit të këtij projekti janë hartuar plane zhvillimore dhe menaxhuese, strategji, përkrahje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, bujqve dhe krijim të vendeve të punës.

Disa nga te arriturat kryesore janë:

- Hartimi i Planit Menaxhues për Parkun Kombëtar “Sharri” – në procedurë,
- Hartimi i një pjesë të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”,
- Hartimi i Planit Financiar dhe Planit të Biznesit për Parkun Kombëtar,
- Vlerësimi Ekonomik i Ekosistemeve të Komunës së Dragashit,
- Hulumtimi i biodiversitetit të zonës së Dragashit,
- Zgjerimi i territorit të Parkut Kombëtar Sharri edhe në territorin e Dragashit,
- Vetëdijësimin e popullatës dhe komunitetit lokal për ruajtjen e biodiversitetit dhe rëndësinë e zonave të mbrojtura përmes publikimeve dhe fushatave si dhe thellimi i bashkëpunimit në mes të Parkut Kombëtar Sharri, Komunës së Dragashit, OJQ-ve, komunitetit lokal, bizneseve etj.

Projekti “Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i përdorimit të qëndrueshëm të tokës në Dragash” ka pasur për synim që përmes ruajtjes së biodiversitetit, planifikimit hapësinor dhe mjedisor, zhvillimit lokal ekonomik, strategjisë së qëndrueshme të energjisë dhe ngritjes së kapaciteteve të arrijë kornizat e nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm lokal.

11.1.4. Projekti i Gërmisë

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2013 ka filluar implementimin e projektit “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Parkut të Gërmisë”.

Komisioni Evropian ka ndarë 360 mijë euro donacion kurse komuna e Prishtinës ka marrë pjesë në projekt me 150 mijë euro.

Përveç tjerash ky projekti parasheh rregullimin e shtigjeve për këmbësorë, shtigjeve për çiklistë, vendpushimeve për qytetarë, vendosja e trenit ekologjik dhe ndriçimit publik në tërë pjesën rekreative të zonës.

Deri më tani është përfunduar rregullimi i shtegut të epërm dhe është në përfundim rregullimi edhe i pjesës më të madhe të shtegut të poshtëm bashke me ndriçimin, shportat e mbeturinave dhe vendpushimeve për qytetarë. Në ndërkohë është sjellë edhe treni “ekologjik” i cili ende është në fazën testuese dhe ka për qëllim zëvendësimin e makinave që deri më tani kanë qarkulluar në këtë zonë.



Foto 117 dhe 118. Treni "ekologjik" që mendohet të vendoset në park dhe shtegu i poshtëm për këmbësorë

Parkun e Gërmisë e menaxhon Komuna e Prishtinës përmes ndërmarrjes "Hortikultura", ndërsa mbikëqyrjen profesionale e bën Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës i cili vepron në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

11.2. PROJEKTET REGIONALE DHE NDËRKUFITARE

11.2.1. Parqet e Harkut Dinarik

Harku Dinarik është një rajon i Evropës jug-lindore i cili mbulon rreth 100,000 km² dhe më shumë se 6.000 km vijë bregdetare, që shtrihet në zonën e orientuar në drejtim të detit Adriatik, nga Trieste (Itali) në Tiranë (Shqipëri).



WWF ka filluar projektin e Parqeve të Harkut Dinarik në fillim të vitit 2012, me qëllim për të krijuar një shoqatë të Parqeve Kombëtare dhe atyre Natyrore në territorin e vendeve përbërëse të Harkut Dinarik; aleancë Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi dhe Slloveni. Ky projekt tre-vjeçar është financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme dhe Fondacioni MAVA.

Rrjeti rajonal i zonave të mbrojtura

Objekti i parë dhe kryesor i këtij projekti është që të krijojë një rrjet të zonave të mbrojtura duke lidhur të gjitha parqet në rajonin e Harkut Dinarik. Një konferencë e planifikuar pesë-ditore për parqet, që do të mbahet në fund të çdo viti të projektit, do të ndihmojë menaxherët dhe stafin e parqeve për t'u njohur me kolegët e tyre në rajon, shkëmbimin e planeve menaxhuese dhe shembuj të praktikave të mira, si dhe të planifikojnë bashkëpunim të mundshëm ndërmjet zonave të mbrojtura.

Plani përfshin gjithashtu vizita studimore nga një vend i rajonit në një tjetër, duke ndihmuar stafin e parqeve të kuptojnë më mirë situatën e parqeve të tjera në rajon.

Vlerat më të rëndësishme të parqeve dhe zonave të mbrojtura brenda rrjetit do të evidentohen përmes materialeve promovuese dhe në faqen e internetit të ndërtuar për të përmirësuar promovimin e parqeve të Harkut Dinarik.




Foto 119. Pjesë nga faqja e internetit te projektit ku janë prezantuar Parqet e Kosovës

Ngritja e kapaciteteve për rrjetin e parqeve

Parqet Kombëtare dhe natyrore në të gjitha vendet e Harkut Dinarik janë kryesisht ose tërësisht të varur nga financimet e shtetit. Kjo është arsyeja e mbajtjes së një seri seminaresh për ndërtimin e kapaciteteve në kuadër të këtij projekti.

Të gjitha vendet pjesëmarrëse në këtë projekt, nëse nuk janë aktualisht anëtare, tashmë janë afër për t'u bërë anëtare të Bashkimit Evropian (BE), ndaj do të organizohet një seri me seminare dhe vizita studimore rreth *Natura 2000* dhe rolin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në BE.

Bukuria, kultura, pozita gjeografike dhe diversiteti biologjik i vendeve të Harkut Dinarik janë tashmë një atraksion turistik. Megjithatë, pritet që parqet e Harkut Dinarik do të jenë një "magnet" për operatorët turistikë. Do të punohet në drejtimin që punonjësit e zonave të mbrojtura të përfshihen në *Kartën Evropiane për Turizmin e Qëndrueshëm të Federatës EUROPARC*, si dhe për zbatimin e saj praktik në rajon.

Me vlerat natyrore dhe kulturore që mbart, Harku Dinarik qëndron përkrah Karpateve, Alpeve apo ndonjë eko-rajonit tjetër të njohur në botë.

Nëpërmjet faqes së internetit, broshurave, mjeteve të ndryshme të komunikimit dhe një fushate të gjerë reklamuese, do të zhvillohen parqet e Harkut Dinarik si një markë që do të njihet në rajon dhe më gjerë deri në vitin 2015. Kjo është edhe arsyeja pse u krijua marka PARQET DINARIKE, me sloganian "BOTË E PA ZBULUAR"



Foto 120 dhe 121. Pamje nga aktivitetet në kuadër të realizimit të projektit

11.2.2. Projekti i zonës së pyjeve të ahut

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përkatësisht Agjencioni i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit ka filluar bashkëpunimin me Ministrinë Federale Gjermane për Mjedisin, Konservimin e Natyrës, Ndërtimin dhe Sigurinë Nukleare – BMUB dhe Agjencionin Federal Gjerman për Konservimin e Natyrës – BfN, si dhe Qendrën për Menaxhimin e Ekosistemeve – CEEM në Universitetin e Eberswaldit për Zhvillimin e Qëndrueshëm – HNEE, në lidhje me Projektin: “Pyjet e ahut – Trashëgimi Natyrore e Përbashkët e Evropës”.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është prezantimi i vlerave të pasura natyrore të vendit tonë, posaçërisht pjesa e vegetacionit të pyjeve të vjetra të ahut që gjenden brenda Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Bashkëpunimi në lidhje me këtë projekt ka filluar në vitin 2013 për të vazhduar me pjesëmarrje në punëtoritë dhe takimet e organizuara e parapara. Projekti do të vazhdoj deri në vitin 2017 dhe synimi kryesor është angazhimi i vazhdueshëm në mënyrë që zonat e lartpërmendura të marrin epërsinë e emërimit dhe sa më shpejt që të jetë e mundur të diskutohet në nivelin kombëtar.




Foto 122. Vizitë në rajonin e Bjeshkëve të Nemuna



Foto. 123. Takim i GP të projektit

11.2.3. Zonat e Mbrojtura Ndërkufitare

Me qëllim të fuqizimit të mbrojtjes së natyrës në nivelin rajonal Kosova ka qenë pjesë aktive e disa iniciativave, projekteve dhe hulumtimeve në regjionin e Ballkanit Perëndimorë, apo edhe pjesë e iniciativave ndërkufitare me vendet fqinje Maqedoninë, Shqipërinë, Serbinë dhe Malin e zi. Mbrojtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i zonave të mbrojtura, janë disa prej këtyre aktiviteteve.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve regjionale janë hartuar edhe dy studime për shpalljen e dy zonave të mbrojtura ndërkufitare:

Krijimi i Zonës së mbrojtur ndërkufitare “Bjeshkët e Nemuna” – Zona e propozuar për mbrojtje pritet të përfshijë Shqipërinë, Kosovën, Malin e Zi dhe Serbinë.

Bjeshkët e Nemuna përfshijnë Malet dhe peizazhet unike dhe janë një nga rajonet më të rëndësishme për mbrojtjen e biodiversitetit në Ballkan dhe në gjithë Evropën. Ky rajon, konsiderohet të jetë ndër zonat malore me botë të egër ndër më ta rrallat jo vetëm në Gadishullin Ballkani por edhe në Evropë²⁸.

Krijimi i Ndërkufitare Sipërfaqe e mbrojtur “Sharr - Korabit - Deshatit” – Kjo zonë e mbrojtur është e është e vendosur në zonat kufitare të Shqipërisë, Kosovës dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe përfshinë peizazhe unike natyrore. Ky rajon trepalësh kufitar përfshin një numër të konsiderueshëm të habitateve natyrore dhe endemike dhe relikte të florës dhe faunës të rralla dhe të kërcënuara përfshirë specie të rëndësishme të përbashkët evropiane, si të ariut të murrme dhe rrëqebullit të Ballkanit.²⁹

11.2.4. Themelimi i Shoqatës së Brezit të Gjellbër Evropian

Nën organizimin e EURONATURE dhe BUND - organizata për mbrojtjen e natyrës dhe mbështetjen e Agjensionit Federal për Mbrojtjen e Natyrës së Gjermanisë (BfN) prej datës 23 - 26 Shtator 2014 në Slavonice të Republikës Çeke u mbajt Konferencën e 8-të Pan-Evropiane e Brezit të Gjellbër – Green Belt.



Foto 124. Harta e Brezit të Gjellbër Evropian



Foto 125. Pjesëmarrësit e Konferencës

28 http://www.unep.at/documents_unep/Balkan_Feasibility_Studies/Prokletije_25-10-2010.pdf

29 http://www.unep.at/documents_unep/Balkan_Feasibility_Studies/Sharr_25-10-2010.pdf

Kjo Konferencë e cila mbledhi më shumë se 100 pjesëmarrës nga 23 vende të Evropës shënon një moment historik për bashkëpunim në të ardhmen e këtyre shteteve që për vite i ka ndare perdia e hekurt. Brezi i Gjellbër Evropian, përveç 16 vende të BE-së lidhë, edhe shtetet si: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Turqia, Rusia dhe Norvegjia. Rreth 150 organizata qeveritare dhe jo-qeveritare nga këto vende janë bashkuar në Nismën e Brezit të Gjellbër Evropian e cila është iniciuar në vitin 2003 fillimisht si iniciativa të ndryshme ekzistuese rajonale për t'u shkrirë në një iniciative evropiane.

Duke qene se Kosova është pjesë e kësaj Nisme qysh prej vitesh, edhe kësaj radhe u ftua në cilësinë e anëtarit të këtij brezi për rajonin e Ballkanit.

Një moment historik i kësaj Konference ishte **themelimi i Shoqatës së Brezit të Gjellbër Evropian** nga 23 organizata qeveritare dhe joqeveritare nga 14 vende. Para themelimit të kësaj Shoqate, bashkëpunimi ka qenë një rrjet i lirshëm ndërsa tani është një organ juridik i themeluar në mënyrë institucionale e i cili përfaqëson iniciativën dhe siguron një koordinimin si dhe shkëmbim të informacioneve në mesin e komunitetit Evropian të Brezit të Gjellbër.

Kosova tani e tutje do të përfaqësohet në këtë Shoqatë përmes Institutit për Mbrojtjen e Natyrës e cila me nënshkrimin e marrëveshjes tani e tutje është anëtare në këtë organizëm të rëndësishëm për ruajtjen e natyrës me theks të veçantë asaj ndërkufitare.

11.3. PROMOVIMI I SHENJËS SË MBROJTJES SË NATYRËS NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË BIODIVERSITETIT 22 MAJ 2013



Me manifestime të ndryshme në Kosovë është shënuar 22 maji Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit. Aktiviteti qendror që ka pasur për organizatorë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është mbajtur në Rezervatin e Gjuetisë me rëndësi të veçantë në Blinajë të Lipjanit.

Përfaqësues të MMPH-së dhe MBPZHR-së kanë folur për angazhimet e ministrive përkatëse në ruajtjen e biodiversitetit në veçanti por edhe për mbrojtjen e pyjeve dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura. Motoja ndërkombëtare e kësaj dite ishte Uji dhe Biodiversiteti.

Po ashtu në këtë ditë u bë edhe promovimi i shenjës së mbrojtjes së natyrës e cila është përzgjedhur me konkurs të hapur dhe me datën 20 Maj 2013 Ministri i MMPH-së ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2013 për Shenjën e Mbrojtjes së Natyrës. Qëllimi i nxjerrjes së shenjës për mbrojtjen e natyrës është promovimi i mbrojtjes së natyrës dhe identifikimi i personave zyrtar në procedurën e mbikëqyrjes dhe ndërmarrjes së masave për mbrojtjen e natyrës.

11.4. SHPALLJA E LLOJEVE TË MBROJTURA

Gjatë vitit 2014, në kuadër të aktiviteteve për mbrojtjen e natyrës me iniciativën e Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, mes tjerash janë marrë nën mbrojtje ligjore dy llojeve autoktone të zbutura të faunës: Raca e Qenit Deltari Ilir dhe Raca e Gjelit Kosovar Këndimgjatë.

Qëllimi kryesor i nxjerrjes së këtyre vendimeve ka qenë mbrojtja e këtyre llojeve sipas ligjit dhe përcaktimi i kushteve të mbajtjes.

Gjithashtu përmes këtyre vendimeve synohet që të këto lloje të mbrohen nga rreziku për përzierje gjenetike me racat e huaja dhe nga rreziku për nxjerrje jashtë vendit të këtyre racave me qëllim të kryqëzimit me racat tjera.

Sipas këtyre vendimeve të dy këto lloje autoktone janë të regjistruara në regjistrin e vlerave të mbrojtura të natyrës që mirëmbahet nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Vendimi përmban edhe arsyeshmërinë për marrjen në mbrojtje të këtyre llojeve si dhe përshkrimin e karakteristikave themelore të tyre.

Hartimi i arsyeshmerisë për racën autoktone të Deltarit Ilir është bërë në bashkëpunim me Shoqatën Kinologjike të Kosovës, kurse për racën e Gjelit Këndimgjatë në bashkëpunim me Shoqatën për Mbrojtjen dhe Kultivimin e Pulave.



Foto 126 Deltari Ilir




Foto 127 Gjeli Këndimgjatë.

12 KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

Gjendja e trashëgimisë natyrore në Kosovë është pjesërisht e kënaqshme e kushtëzuar nga faktorët biotik (njeriu, insektet, sëmundjet) dhe abiotik (zjarret, fatkeqësit natyrore: era, bora etj.). Shkaqet për një gjendje jo të kënaqshme janë edhe:

- Implementimi jo i kënaqshëm i ligjeve ekzistuese;
- Mungesa e institucioneve të mjaftueshme për mbrojtjen e natyrës;
- Mungesa e organeve menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- Mungesa e planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- Shfrytëzim i pa pakontrolluar i resurseve natyrore në zonat e mbrojtura;
- Mungesa e hulumtimeve shkencore për biodiversitetin;
- Mungesa e inventarit të plotë për florën, faunën dhe habitatet;
- Fondet e pamjaftueshme për mbrojtjen natyrën;

Rekomandimet:

Për përmirësimin e gjendjes së natyrës në Kosovë nevojitet ndërmarrja e masave të shumta, ndër të cilët veçohen:

- Hulumtimi dhe inventarizimi i llojeve, habitateve dhe gjeotrashëgimisë;
- Hartimi i Listës së Kuqe të faunës së Kosovës;
- Realizimi i projekteve ndërkufitare për mbrojtjen e natyrës;
- Hartimi i Planit Hapsinore dhe Menaxhues për Parkun Kombëtar “Bjeshket e Nemuna”;
- Aprovimi i Planit Menaxhues për Parkun Kombëtar “Sharri”;
- Ndërmarrja e masave për parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve në zona të mbrojtura;
- Vendosja nën menaxhimin e MMPH-së (DAPK-së) të territorit të PK “Sharri” në komunën e Shtërpçës dhe shuarja e drejtorisë ilegale;
- Ndalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore në zonat e mbrojtura;
- Aplikimi i masave sanitare për sanimin e pyjeve të dëmtuara nga faktorët biotik dhe abiotik të paraqitura në planet përkatëse;
- Hartimi i programeve dhe projekteve për ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimit për mbrojtjen e natyrës;
- Themelimi i zyrës koordinuese për identifikimin, ratifikimin dhe implementimin e konventave dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës;
- Themelimi i drejtorive për menaxhimin e monumenteve me rendësi të veçantë (Shpella e Gadimes dhe Ujëvarat e Mirushës) dhe ZVM (Ligatina e Hencit – Radeves);
- Ngritja e kapaciteteve të punonjësve në zonat e mbrojtura;
- Shenjëzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyrës;
- Harmonizimi dhe kategorizimi i zonave të mbrojtura sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës;
- Rritja e stafit dhe sigurimi i lokaleve për nevojat e IKMN-së;
- Thellimi i bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së natyrës;
- Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës kërkon që në të ardhmen për të gjitha intervenimet në zona të mbrojtura të merret mendimi profesional nga IKMN dhe pëlqimi nga organi menaxhues përkatës;
- të inspektohen vazhdimisht zonat e mbrojtura nga inspektorati i MMPH-së;

13 REFERENCAT

1. AMMK/IKMN, (2008) Raporti i natyrës 2006-2007, Prishtine.
2. AMMK/IKMN, (2010) Raporti i natyrës 2008-2009, Prishtine.
3. AMMK-IKMN (2013) Propozimi profesional për shpalljen e Ligatinës së Hencit - Radeves Zonë e Veçantë e Mbrojtur, Prishtinë.
4. AMMK/ MMPH. Raporti i Komisionit nga incizimi i gjendjes faktike, fotografimi, evidentimi i objekteve të ndërtuara dhe verifikimi i lejeve të ndërtimit në territorin e PK "Bjeshkët e Nemuna", nr. i prot. 4583/14, datë 15.09.2014.
5. Arkivi i IKMN-së (2004): Raportet, dokumentet dhe aktvendimet për zonat e mbrojtura.
6. B. Berisha, F. Millaku, F. Rexhepi, Xh. Malaj (2012) Atlasi i bimëve te Kosovës, K.K. Suhareke
7. B. Durmishaj, S. Hyseni, F. Shala (2011) Atlasi i Mineraleve të Trepçes, Mitrovicë.
8. Bajraktari F., Behrami S., Zonat e Mbrojtura në Kosovë (2013) kërkime gjeografike, nr: 15 Fakulteti i Shkencave Matematikore - Natyrore, Departamenti i Gjeografisë, Prishtinë.
9. Bajraktari F., Behrami S., Abazi Sh., (2010) Gjeomonumentet e mbrojtura dhe të propozuara për mbrojtje në Kosovë 2005-2009, 1st International GEO-CONSERVATION symposium and Southeastern Europe Countries ProGEO Grup Meeting, Firat University, Stetember 15-19, ELAZIG/TURKEY.
10. Bajraktari F., Behrami S., Zogaj N., (2009), Trashëgimia hidrike në pellgun e lumit Mirusha, Konferencë shkencore ndërkombëtare, organizuar nga UT.& UGJ. Gjirokastër 20-22 nëntor, Studime Albanologjike, IV, Gjeografia, 2009/4, Viti XIV.
11. Bajraktari F., Dollma M., Behrami S., Krasniqi E., Monuments of Nature of Mirusha River Basin, (2012) Buletini i Shkencave Gjeologjike, (numër special), viti 31(48) i botimit, Konferenca Jubilarë "90 vjet Gjeologjia Shqiptare", Tirane, Shqipëri, 26-28, tetor, Abstracts Volume.
12. Bajraktari F., Sherifi Y., Berisha A., Behrami S., Maxhuni Q., (2010), Monumentet hidrike të mbrojtura dhe të propozuara në Kosovë 2002-2008, "Bolwois", Ohër.
13. Bajraktari, F., Behrami S., Katalozi F. (2010): Shpellat e Kosovës, Prishtinë
14. Bank, P, Bemmerlein-Lux, F., Hajdari, A., Hajredini, E., Ibrahim, H., Mustafa, B. (2012) PROJEKTI "SHKUKZA" GJAKOVË, Plani i peizazhit për "Parkun e Shkukzës, UNDP
15. Draft Plani Menaxhues për Parkun Kombëtar "Sharri" (në procedurë për miratim).
16. EKMN (1975): *Natyra e Kosovës, publikim për Bjeshkët e Nemuna*, Enti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës, Prishtinë.
17. EKMN-Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (1975-1986): *Natyra e Kosovës*. EKMN. Prishtinë.
18. Grupi i autorëve (2009): Raport për zonimin e Parkut Nacional "Mali Sharr". MMPH, Prishtinë.
19. <http://banka-ideve.com/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=4002>.
20. <http://www.discoverdinarides.com/sq>.
21. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Malishevës*.
22. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Gjakovës*.
23. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Skenderajt*.


24. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Gjilanit.*
25. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Rahovecit.*
26. IKMN (2003): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Klinës.*
27. IKMN (2003): *Studimi për shpalljen B. të Nemuna Park Kombëtar. MMPH-IKMN. Prishtinë.*
28. IKMN (2003): *Vlerat e natyrës së Kosovës. MMPH-IKMN. Prishtinë.*
29. IKMN (2004): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Drenasit.*
30. IKMN (2004): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Istogut.*
31. IKMN (2004): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Podujevës .*
32. IKMN (2004): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Mitrovicës.*
33. IKMN (2005): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Vitisë.*
34. IKMN (2005): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Obiliqit.*
35. IKMN (2005): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Vushtrrisë.*
36. IKMN (2005): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Istogut.*
37. IKMN (2005): *Vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës. MMPH-IKMN. Prishtinë.*
38. IKMN (2006): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën e Lipjanit.*
39. IKMN (2006): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në Komunën Fushë Kosovë.*
40. IKMN (2006): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Podujevës.*
41. IKMN (2006): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Obiliqit.*
42. IKMN (2006): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Klinës.,*
43. IKMN (2006): *Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Skenderajt.*
44. IKMN (2007): *Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Shtimes.*
45. Kadriu, K. (2014): "Blinaja" Ekosistemi i bashkëjetesës së florës e faunës, rezervati më i madh shqiptar i gjahut, artikull në Revistën Mjedis Sot, 30.05.2014.
46. Krasniqi, F., Ruci, B., Vangjeli, J., Susuri, L., Mullaj, A., Pajazitaj, Q. (2003): *Fjalor i emrave të bimëve (Latinisht, Shqip, Anglisht, Gjermanisht, Frëngjisht), ASHSH-Instituti kërkimeve Biologjike (Tiranë), ASHAK-Seksioni i Shkencave të Natyrës (Prishtinë).*
47. Ligji Nr. 02/L-122-për Bujqësi organike, (08 Janar 20008).
48. Ligji Nr. 02/L-53 për Gjuetinë, (11 Gusht 2006).
49. Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë, (10 Tetor 2006).
50. Ligji Nr. 02/L-95 për Mbrojtjen e Bimëve,(31 Janar 2007).
51. Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, (23 Shtator 2010).
52. Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, (30 Shtator 2010).

53. Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, (31 Korrik 2013).
54. Ligji Nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës me ndryshimet dhe plotësime 2004/29.
55. Ligji për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut (“GZK” 39/88).
56. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025. Kuvendi i Kosovës. Prishtinë. GZK (2009).
57. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233. Kuvendi i Kosovës. Prishtinë. GZK (2010).
58. Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” nr. 04/L-086. Kuvendi i Kosovës. Prishtinë. GZK (2013).
59. Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri” GZK. 11/86, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë.
60. Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri” nr. 04/L-087, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, GZK (2013).
61. Ligji për Themelimin e Entit Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës (“GZK”. 15/81).
62. Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit (“GZK”nr. 38/89).
63. Maxhuni, Q. (2009): *Some aspects of birds fauna in Kosovo*, International Wader Study Group Conference, 18 – 21 September 2009, Texel, Netherland.
64. Maxhuni, Q. (2009): *Uticaj ekoloških faktora na dinamiku populacija riba rijeke Drenice*, magistrski rad, US – PME, Sarajevo.
65. Maxhuni, Q. (2010): *The influence of ecological factors on fish population dynamics in river Drenica*, The Fourth International Scientific Conference BALWOIS 2010, Ohrid, Republic of Macedonia.
66. Maxhuni, Q., Dana, H, Bislimi, K., Ferizi, Rr., Hashani, Z. (2013): *National Park “SHARRI”, The 2nd Dinaric Arc Parks International Conference, 2 Decembar 2013, Budva, Montenegro.*
67. Maxhuni, Q., Ibrahim, H. (2013): Overview of the invasive alien species in Kosovo, country report.
68. Maxhuni, Q., Morina, I., Morina, R., Ferizi, Rr., Hashani, Z. (2013) Biodiversity and protected areas in Kosovo, *The 3rd International Conference of Ecosystems (ICE 2013), Tirana, Albania, May 31-June 05, 2013.*
69. MBPZHR (2012) Inventarizimi Nacional i Pyjeve Kosovë, 2012.
70. MMPH (2013): Libri i Kuq i florës vaskulare të Republikës së Kosovës. Prishtinë.
71. MMPH/ AMMK (2013): Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2011-2012, Prishtinë.
72. Mustafa B, Georgev K, Hajdari A, Hajredini E. (2009): Identifikimi Paraprak i Zonave të Natura 2000 në Kosovë, Pikat kyqe të biodiversitetit. Sustainable Forest Management. European Union. Prishtinë.
73. Plani Hapësinor Nr. 04-V- 795 për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e Mirushes”,
74. Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, (në procedurë të hartimit),
75. Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”,
76. Projekt plani i punës për përzgjedhjen e zonave Natura 2000 me tregues për të dhënat e nevojshme, përgjegjësitë, afatet kohore dhe buxhetin (në procedurë për miratim).
77. Raporti për zonimin e PK “Bjeshkët e Nemuna”, Nr. Prot. 777/14, 21.02.2014.
78. Rexhepi, F. (1986): Flora e maleve të larta të Kosovës. ETMMK. Prishtinë.

79. Rexhepi, F. (1994): *Vegjetacioni i Kosovës* (1), UP, FSHMN, Prishtinë.
80. Rreg. Nr. 2001/19 dhe 2002/5 për formimin e MMPH-se.
81. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011 - 2020, miratuar nga Kuvendi i Kosovës, dt. 07. Tetor. 2011.
82. Strategjia e Mbrojtjes së Klimës në Sektorin e Pylltarisë në Kosovë (Dhjetor 2012);
83. Strategjia e Pyjeve 2010-2020.
84. Strategjia kombëtare për sektorin e produkteve pyjore jo drunore (PPJ) 2014-2020.
85. Udhëzuesi për Planet e Menaxhimit të Parqeve Kombëtare në Kosovë, (02. Maj. 2012).
86. UNDP, Projekti "Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës në Dragash" TM3-2012 Raporti i progresit pjesa I-II.
87. UNEP (2010): Feasibility Study on establishing a transboundary protected area Prokletije/Bjeshkët e Nemuna Mountains. UNEP Vienna-Interim Secretariat of the Carpathian Convention (ISCC). Vienna.
88. UNEP Vienna ISCC, 2010, Feasibility Study on establishing a transboundary protected area Prokletije/Bjeshkët e Nemuna Mountains.
89. UNEP Vienna ISCC, 2010, Feasibility Study on establishing a transboundary protected area Sharr/Šar Planina – Korab – Dešat.
90. Vendimi i Ministrit Nr. 03/2013 mbi themelimin e Drejtorisë për administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri" me seli në Prizren.
91. Vendimi i Ministrit Nr. 04/2013 mbi themelimin e Drejtorisë për administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" me seli në Pejë.
92. Vendimi i Ministrit Nr. 32/2013 për dhënien e lejes për mbajtjen e arinjve të murrmë në internim në strehimoren "Pylli i Arinjve".
93. Vendimi i Qeverisë Nr. 04/57 për vënien nën mbrojtje të Monumentit të Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes", Gadime e ultë KK Lypjan.
94. Vendimi i Qeverisë Nr. 06/75 për Shpalljen e Monumentit të Natyrës me rëndësi të veçantë "Ujëvarat e Mirushes".
95. Vendimin nr. 011 (2011) për mbrojtjen e përkohshme të zonës potenciale për shpalljen e saj Zonë e Rëndësishme e Zogjve (Important Bird Area), MMPH.
96. Veselaj, Z. (2010): Bjeshkët e Nemuna- perla natyrore e Kosovë. REC & KFOS. Prishtinë.

14 SHTOJCA I

Harta e Zonave të Mbrojtura



15 SHTOJCA II

Tabela e Zonave të Mbrojtura 2014

Kodi	Emërtimi i Zonës/ objektit	Komuna	Sip./ ha	Kat. sipas IUCN	Viti i mbrojt.	Përshkrimi i shkurtër i vlerave
REZERVAT STRIKT I NATYRES (847 ha)						
RN_001	Gazimestani	Prishtinë	12	Ib	1953	Rezervat bimor i Bozhures (Paeonia decora Anders)
RN_002	Maja e Ropsit	Deçan	20	Ia	1955	Rezervat bimor i llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut
RN_003	Kozhnjeri	Deçan	150	Ia	1955	Rezervat shtazor i llojit dhia e egër (Rupicapra rupicapra L.)
RN_004	Rusenica	Suharekë	300	Ia	1955	Rezervat shtazor i rrëqebullit (Lynx lynx L.)
RN_005	Gubavci	Pejë	38	Ia	1959	Rezervat bimor i llojit endemorelikt boshtra (Forsythia europaea)
RN_006	Maja e Arnenit	Prizren	30	Ia	1960	Rezervat bimor me përbërje të pastër të munikes- arnenit (Pinus heldreichii)
RN_007	Oshlaku	Prizren	20	Ia	1960	Rezervat natyror i arnenit (Pinus heldreichii), dhe i disa bimëve endemike
RN_008	Pisha e Madhe	Prizren	35	Ia	1960	Rezervat bimori i llojit të molikës dhe i disa shpendëve këngëtarë
RN_009	Malet e Prilepit	Deqan	1	Ia	1963	Rezervat bimor me përbërje të pastër të panjës malore (Acer heildreichii)
RN_010	Bifurkacioni i Lumit Nerodime	Ferizaj	13	Ib	1979	Rezervat special natyror. Fenomen unikat në Evropë dhe i dyti në botë me rëndësi arsimore, shkencore e turistike.
RN_011	Kamilja	Leposaviq	228	Ib	1988	Kamilja është Rezervat i veçantë natyror me veçori paleontologjike.
PARK KOMBETAR (115.957 ha)						
PK_001	Parku Kombëtar "Sharri"	Prizren Suharekë Kaçanik Shtërpçë, Dragash	53.469	II	(1986), 2012	Karakterizohet me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Me vlera të trashëgimisë gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, speleologjike, kulturore, edukativo-arsimore dhe turistike.

PK_002	Parku Kombëtar "Bjeshkët Nemuna"	Pejë, Deçan, Istog, Junik, Gjakovë	62.488	II	2012	Karakterizohet me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegetacionit dhe faunës. Me vlera gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, speleologjike, kulturore, edukativo-arsimore dhe turistike.
MONUMENTE NATYRORE (5972 ha)						
MN_001	Mani Sham (Morus sp.)	Pejë	0.03	III	1957	Monument natyror me karakter botanik
MN_002	Rrapi (Platanus orientalis) në Marash	Prizren	0.05	III	1959	Monument natyror me karakter botanik
MN_003	Plepi (Populus tremula) në Bajçinë	Podujevë	0.05	III	1959	Monument natyror me karakter botanik
MN_004	Bliri (Tilia argentea) në Isniq	Deçan	0.02	III	1968	Monument natyror me karakter botanik
MN_005	Trungjet e Blirit (Tilia argentea) në Isniq	Deçan	0.05	III	1968	Monument natyror me karakter botanik
MN_006	Shpella e Gadimes	Lypjan	39	III	1969	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_007	Mineralet – Kristalet	Mitrovicë	0.05	III	1970	Monument natyror me karakter gjeologjik dhe gjeomorfologjik
MN_008	Rrjedha e lumit Mirusha	Suharekë Klinë Malishevë	12	III	1983	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_009	Gryka e lumit Bistrica	Prizren	200	III	1976	Monument natyror me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik
MN_010	Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit	Pejë	90	III	1983	Monument natyror me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik
MN_011	Gryka e Rugovës	Pejë	4301	III	1985	Monument natyror me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik
MN_012	Burimi i ujit mineral në Dresnik	Klinë	0.07	III	1985	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_013	Gryka e lumit Klina	Klinë	205	III	1985	Monument natyror me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik

MN_014	Trungjet e bungut (Quercus sp.) në Lozice	Malishevë	0.05	III	1985	Monument natyror me karakter botanik
MN_015	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Zllakuçan	Klinë	0.05	III	1985	Monument natyror me karakter botanik
MN_016	Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë	Gjakovë Rahovec	198	III	1986	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik
MN_017	Shpella e Baicës	Drenas	0.11	III	1987	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_018	Shpella e Gllanassellës	Drenas	0.5	III	1987	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_019	Burimi termomineral në Vuqë	Leposaviq	16.6	III	1988	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_020	Burimi i ujit mineral në Sallabajë	Podujevë	0.31	III	1988	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_021	Burimi i ujit në Shajkovc	Podujevë	1.41	III	1988	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_022	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Pollatë	Podujevë	0.44	III	1988	Monument natyror me karakter botanik
MN_023	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Dobratin	Podujevë	0.07	III	1988	Monument natyror me karakter botanik
MN_024	Trungjet e rrënjës (Quercus robër) në Nekovc	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_025	Kompleksi i trungjeve të rrënjës (Quercus robur) në Negroc	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_026	Trungjet e shpërdhit në Negroc	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_027	Shpella e Kishnarekës	Drenas	2	III	2006	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_028	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Krajkovë	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_029	Guri i Gradinës në Llapushnik	Drenas	2	III	2006	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik

MN_030	Burimi i ujit mineral në Poklek	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_031	Trungjet e dushkut - Gjashtë lisat (Quercus sp.) në Likoshan	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_032	Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Tërstenik	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_033	Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Likoshan	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_034	Guri i plakës në Dobroshec	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik
MN_035	Trungu i bungëbutës (Quercus pubescens Willd.) në Aqarevë	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_036	Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Polac	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_037	Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Likoc	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_038	Burimi i ujit termal në Banjë	Skenderaj	0.1	III	2007	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_039	Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Prellov	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_040	Kompleksi i trungjeve të dushkut (Quercus sp.) në Rrezallë	Skenderaj	0.02	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_041	Kompleksi i trungjeve të bungbutës (Quercus pubescens Willd.) në Klladernicë	Skenderaj	0.1	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_042	Trungu i qarrit (Quercus cerris L.) në Kotorr	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik

MN_043	Trungu i qarrit (Quercus cerris L.) në Padalishtë	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_044	Trungu i bungëbutës (Quercus pubescens Willd.) në Çitak	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_045	Trungu i qarrit (Quercus cerris L.) në Runik	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_046	Burimi i ujit të njelmët në Leqinë	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_047	Trungu i bungut (Quercus sp.) në Lubovec	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_048	Trungu i rrënjës (Quercus robur) në Deiq	Klinë	0.03	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_049	Kompleksi i trungjeve të rrënjës (Quercus robur) në Gllarevë	Klinë	0.28	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_050	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Nagllavkë	Klinë	0.12	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_051	Burimi i ujit mineral në Rudicë	Klinë	0.07	III	2007	Monument natyror me karakter Hidrologjik
MN_052	Trungu i bungut (Quercus pubescens) në Ujëmir	Klinë	0.2	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_053	Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Breshanc	Suharekë	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_054	Kompleksi i trungjeve të dushkut (Quercus sp.) në Savrovë	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_055	Trungu i pishes (Pinus sp.) në Delloc	Suharekë	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_056	Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Grejkoc	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter botanik

MN_057	Trungu i plepit (Populus sp.) në Reçan	Suharekë	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_058	Burimi i ujit mineral në Reçan	Suharekë	0.1	III	2007	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_059	Kompleksi i trungjeve të dushkut (Quercus sp.) në Muhlan	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_060	Trungu i vodhes (Sorbus domestica L.) në Budakovë	Suharekë	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_061	Kompleksi i trungjeve të dushkut (Quercus sp.) në Papaz	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_062	Dy trungjet e bungut (Quercus sp.) në Bllacë	Suharekë	0.1	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_063	Trungu i qarrit (Quercus sp.) Vraniq	Suharekë	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_064	Lokaliteti i bujgerit (Quercus trojana) në Biraqë	Suharekë	0.1	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_065	Kompleksi i trungjeve të bungut (Quercus sp.) në Luzhnicë	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_066	Guri i Xhamisë në Luzhnicë	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik
MN_067	Dy trungjet e manit të zi (Morus nigra L.) në Cerrcë	Istog	0.11	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_068	Trungu i blirit të argjendtë (Tilia tomentosa Moench) në Lubozhdë	Istog	0.1	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_069	Trungu i blirit të kuq (Tilia sp.) në Istog të Poshtëm	Istog	0.05	III	2008	Monument natyror me karakter botanik

MN_070	Trungjet e bungbutës (Quercus pubescens Willd) në Sinaj	Istog	0.17	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_071	Trungu i blirit të argjendtë (Tilia tomentosa Moench.) në Shushicë të Epërme	Istog	0.05	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_072	Burimi i ujit natyral në Istog	Istog	3.88	III	2008	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_073	Trugu i vodhës (Sorbus domestica L.) në Uçë	Istog	0.07	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_074	Trungu i blirit të argjendtë (Tilia tomentosa Moench) në Kaliqan	Istog	0.05	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_075	Burimi i ujit termal në Banjë	Istog	0.85	III	2008	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_076	Trungu i blirit të kuq (Tilia sp.) në Lubovë	Istog	0.07	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_077	Trungu rrënjës (Quercus robur L.) në Zallq - Zabllaq	Istog	0.11	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_078	Trungu rrënjës (Quercus robur L.) në Trubuhovc	Istog	0.07	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_079	Trungu rrënjës (Quercus robur L.) në Saradran	Istog	0.05	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_080	Trungu i qarrit (Quercus robur) në Gurrakoc	Istog	0.01	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_081	Burimi i ujit në Vrellë	Istog	0.26	III	2008	Monument natyror me karakter hidrologjik
NN_082	Mirusha	Malishevë Klinë Rahovec	598.4	III	2012	Kanioni me ujëvara e njëpasnjëshme dhe peizazhet specifike, paraqet fenomen të rrallë që ka rëndësi natyrore, shkencore dhe turistike
NM_083	Trungu i Qarrit (Quercus ceris L.) në Lladrovç	Malishevë	0.08	III	2014	Monument natyror me karakter botanik

NM_84	Shpella e Temeqinës	Malishevë	0.69	III	2014	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
NM_85	Trungu i Qarrit (Quercus ceris L.) në Carravranë	Malishevë	0.08	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
NM_86	Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens Willd) në LLozicë	Malishevë	0.08	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
NM_87	Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens Willd) në LLozicë	Malishevë	0.07	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
NM_88	Shpella e Bozhurit në Damanek	Malishevë	2 ha	III	2014	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
NM_89	Shpella e Lladroviqit	Malishevë	2ha	III	2014	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
NM_90	Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens Willd)	Malishevë	0.05	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
NM_91	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) ne Drenovc	Malishevë	1.25	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
NM_92	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) ne Bubël	Malishevë	0.8	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
NM_93	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) ne Bubël	Malishevë	0.8	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
NM_94	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) ne Bellanicë	Malishevë	0.8	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
NM_95	Trungu i frashrit gjethengushtë (Fraxinus angustifolia Vahl) në Javiq	Malishevë	0.8	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
NM_96	Vakëfi i Vermicës	Malishevë	0.7	III	2014	Monument natyror me karakter botani
NM_97	Zabeli dhe vrella ne Javiq	Malishevë	0.51	III	2014	Monument natyror me karakter botani dhe hidrologjik
NM_98	Burimi i ujit ne Carravranë	Malishevë	9.76	III	2014	Monument natyror me karakter hidrologjik
NM_99	Shpella e Ponorcit	Malishevë	279	III	2014	Monument natyror me karakter speleologjik

ZONË E VEÇANTË E MBROJTUR E ZOGJËVE (109 ha)						
ZVM_001	Ligatina e Hencit-Radeves	F. Kosove, Graçanice, Lipjan	109	V	2014	Zone me vlera dhe karakteristika të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrogeologjike, botanike dhe peizazhore.
PARK REGIONAL I NATYRES (1126 ha)						
PN_001	Gërmia	Prishtinë	1126	V	1987	Park më rendësi shkencore, edukative, kulturore dhe turistike
PEIZAZH I MBROJTUR (85 ha)						
PM_001	Shkugza	Gjakovë	70	V	2011	Lokalitet me vlera floristike, edukativo-arsimore dhe turistike
PM_002	Pishat e Deçanit	Deçan	15	V	1969	Lokalitet me vlera floristike, edukativo-arsimore dhe turistike

GJENDJA E NATYRËS

RAPORT

2010- 2014

Botues:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencioni për Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Raporti, Gjendja e Natyrës 2010-2014

Është përgatitur nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Përgatitja e Raportit është realizuar nga ekspertët e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në bashkëpunim me ekspertët e Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit të MMPH-së dhe institucionet tjera relevante.

Grupi punues:

MSc. Fadil Bajraktari, drejtor i IKMN/AMMK

Mr. sc. Qenan Maxhuni, zyrtar për biodiversitet – IKMN/AMMK

Dr.sc. Sami Behrami, zyrtar për zona të mbrojtura – IKMN/AMMK

MSc. Afrimi Berisha, udhëheqës i Sektorit për Raportim Mjedisor – DMVRM/AMMK

MSc. Valmira Gashi, zyrtare e lartë për shfrytëzimin e qëndrueshëm të vlerave natyrore në DMM/MMPH

Mr. sc. Nail Kryeziu, udhëheqës i Sektorit për pylltari - PK "Sharri"/AMMK

Ndriçim Mustafa, zyrtar për projekte dhe bashkëpunim – DMVRM/AMMK

Foto e ballinës: Copyright Fatos Katallozi

® Ndalohej shumëzimi dhe ribotimi i paautorizuar

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

504.06(496.51) "2010/2014"

Raport për gjendjen e natyrës në Republikën e Kosovës
: 2010-2014 / Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të
Kosovës, 2015. – Prishtinë : Agjencia për Mbrojtjen e
Mjedisit të Kosovës : Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e
Natyrës. – 121 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm.

ISBN 978-9951-638-06-7



ISBN 978-9951-638-06-7



9 789951 638067